656-23-11571-2-1-1	2	1	1	93	20.09.2023	20.10.2023	27.12.2023	27.12.2023	27.12.2023 26.12.2026	Ne realizim	250,000.00	87,953.00					0	INTER GRAF LLC.	1	23	1	0	1	1
656-23-12844-5-2-1	5	2	1	45	23.10.2023	16.11.2023	21.12.2023	22.12.2023	26.12.2023 25.12.2026	Ne realizim	130,000.00	129,591.50					0	Rahovka Commerce SH.P.K.	1	17	1	0	1	1
656-23-13333-5-2-1	5	2	1	45	26.09.2023	27.11.2023	28.12.2023	28.12.2023	02.01.2024 01.01.2027	Ne realizim	300,000.00	352,450.00					0	Compania Esivatori Sh.p.k.	1	17	1	0	1	1
656-23-12852-5-2-1	5	2	1	45	27.09.2023	16.11.2023	28.12.2023	28.12.2023	02.01.2024 01.01.2027	Ne realizim	170,000.00	160,842.25					0	Rahovka Commerce SH.P.K.	1	18	2	0	1	1



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E PERSONELIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Në Zyrën e Personelit gjatë periudhës 1 vjeçare Janar – Dhjetor 2023 janë kryer këto punë dhe detyra:

- Zyra e Personelit ka realizuar përmbushjen e detyrave gjatë këtij viti dhe ka ofruar mbështetjen dhe konsultat e panumërta, për të punësuarit në administratën komunale;
- Është përkushtuar dhe angazhuar vazhdimisht rreth mbikqyrjes dhe zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil – publik në institucionet e administratës komunale, veçanërisht rreth procesit të klasifikimit;
- Gjatë muajit Janar 2023, Zyra e Personelit është marr me procesin e pranimit të formularëve të vlerësimit të shërbyesve civil nga ana e Drejtorëve të Drejtorive dhe udhëheqësve të sektoreve;
- Zyra e Personelit gjatë vitit 2023 në vazhdimësi ka mbajtur kontaktet me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik si dhe është marr me kërkesat e të punësuarve rreth procesit të kategorizimit në klasa të vendeve të punës, bazuar në ligjet në fuqi;
- Janë përgatitur përgjigje për zyrtarët e punësuar rreth kërkesave të adresuara në Zyrën e Personelit;
- Janë mbajtur kontaktet me Këshillin e Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil, ku janë përgatitur dhe përcjellë materialet e kërkuara nga KPMSHCK-së konform kërkesave të adresuara (të gjitha brenda afateve ligjore);
- Janë përgatitur kërkesa për korrigjimin e titujve të punës gjegjësisht për ndryshimin e koeficienteve të pagave për shërbyes civil dhe janë përcjellur në Ministrinë e Punëve të Brendshme - DMZP;

- Me kërkesë të ish të punësuarve janë fotokopjuar dokumente të ndryshme nga dosjet pasive të zyrtarëve që nuk janë më në marrëdhënie pune;
- Janë lëshuar vërtetime siç janë përvoja e punës, referenca etj.
- Në sistem janë miratuar apo refuzuar kërkesat e pushimit për shërbyesit civil;
- Janë larguar 15 punëtorë nga lista e pagave ku kemi pasur 1 rast të vdekjes, 2 dorëheqje dhe 12 punëtorë janë pensionuar gjatë vitit 2023 dhe të njëjtëve iu është lëshuar vendimi;
- Gjatë vitit 2023 janë përgatitur 3 vendime për pushim të lehonisë;
- Janë plotësuar formularët si më poshtë:
 - Plani vjetor për trajnime;
 - Regjistri i shërbyesve civil të cilët pensionohen në vitin 2023;
 - Plani i Personelit për vitin 2023 (përmes SIMBNJ);
 - Janë ndjekur trajnime rreth legjislacionit të ri për shërbyesit civil dhe publik si dhe rreth përdorimit të SIMBNJ (versionit të ri të sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore);
- Për çdo muaj janë plotësuar formularë të ndryshëm për pagat si:
 - Formularët për punonjësit e ri,
 - Formularët e Largimeve,
 - Formularë të ndryshimeve si: ndryshimi i përvojës së punës, ndryshimet për lehonat, ndalesa në pagë, transfere bankare, etj.
 - Formularët retroaktiv për shtesa si dhe
 - Regjistrat Elektronik për Pagesat e Anëtarëve të Asamblesë Komunale dhe Komiteteve Obligative, Pagesa e Kujdestarisë për Qendrën Rezidenciale si dhe Kujdestaritë për Zjarrfikësit, ku të gjitha këto dokumente të plotësuara dhe të skanuara janë dërguar në formë elektronike në MFT.
- Është plotësuar raporti statistikor për vitin 2023;
- Janë skanuar dhe janë vendosur në dosje dokumente shtesë të punëtorëve që kanë sjellë në Zyrën e Personelit. Këto janë bërë në përputhje me rregulloren për dosje;
- Janë nxjerrë vërtetime të ndryshme sipas kërkesave të të punësuarve;
- Janë përgatitur vendime për përvojën e punës për punëtorët që kanë sjellë dëshmi shtesë të përvojës;

- Janë nxjerrë nga sistemi regjistrat e pagave për punëtorët e administratës komunale, punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë për vitin 2023 (për çdo muaj);
- Janë zhvilluar 20 procedura të rekrutimit të jashtëm prej tyre 6 procedura të jashtme në grupe përmes sistemit elektronik dhe 14 lëvizje brenda kategorisë po ashtu përmes sistemit elektronik;
- 20 rekrutime – 6 të jashtëm dhe 14 të brendshëm;
- Për të gjithë këto rekrutime janë krijuar dosjet e punonjësve të ri.

Zyra e Personelit gjatë muajit Dhjetor përpos punëve të përditshme është marr me konsultime të ndryshme me nëpunësit civil lidhur me të drejtat e tyre edhe me procesin e vlerësimit të shërbyesve civil përkatësisht janë udhëzuar për këtë proces.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Zyra e Informimit dhe Komunikimit me Publikun e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Ferizajt, shënoi suksese duke përmbushur rolin e saj në fushën e informimit publik për aktivitetin e Komunës. Kjo për faktin se gjatë vitit 2023 kjo zyrë ka arritur të bëjë shpërndarjen e informacioneve që kanë të bëjnë me aktivitetet e realizuara nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe drejtoritë komunale.

Pasqyrimi i drejtë dhe i paanshëm i ngjarjeve që ndodhin për dhe nga Komuna është përmbushur si mision i Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun. Kjo duke përcjellë e publikuar gjithë aktivitetin e mekanizmave kyç të organeve të administratës komunale, veprimtarisë së pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në Komunën e Ferizajt.

Sfida kryesore që ka të bëjë me fushën e informimit publik është mungesa e garancisë për ruajtjen e të dhënave, dokumenteve të publikuara në ueb faqen e Komunës nga ana e kontraktorit të MAPL-së për mirëmbajtjen e ueb faqeve të komunave. Kjo sfidë është adresuar me kohë tek kompetentët.

Në planin e dokumenteve strategjike, ZIK ka përmbushur të gjitha detyrimet e kërkesat e nivelit qendror, përkatësisht MAPL-së sa i përket miratimit të dokumenteve në funksion të rritjes së transparencës komunale.

Raportet e bashkëpunimit mes Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun me shoqërinë civile, mediat dhe qytetarët edhe gjatë vitit 2023 kanë mbetur mirë të strukturuar dhe korrekte. Kjo falë krijimit të një tradite bashkëpunimi dhe infrastrukture të qëndrueshme të komunikimit të dyanshëm.

Gjatë vitit 2023, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun ka bërë edhe organizimin e konsultimeve publike, takimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore.

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur këto konsultime publike:

- Konsultimi publik për Hartën Zonale 2023-2031;
- Konsultimi publik i organizuar nga KPF-ja për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026;
- Konsultimi publik për Planin Komunal të Veprimit për Shërbimet Sociale për vitin 2024-2026;
- Konsultimi publik me qytetarët për Projekt-Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Ferizajt për periudhën kohore 2024-2034;
- Konsultimi publik për projektin e Tregut të Gjellbër në Ferizaj dhe transformimin funksional të tij;
- Konsultimi publik për Planin e Integritetit 2023-2027;
- Konsultimi publik për Projekt-Programin trevjeçar të banimit 2023– 2025;
- Konsultimi publik me qytetarët për Projekt-Planin e Komunës për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027;
- Konsultimi publik për Planin Komunal për Ri-Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Ferizajt 2023 – 2025;
- Konsultimi publik për Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Konsultimi publik për logot e institucioneve kulturore, dekoratave, medaljeve, dhurata dhe çmimeve.

Janë mbajtur 9 dëgjime publike për përgatitjen e Buxhetit të Komunës për vitin 2024, ndërsa dëgjimet janë mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës me këto grupe të interesit:

- OJQ-të, të rinjtë, sportistët dhe mediat;
- Dëgjimi buxhetor me grupet e interesit (biznese, fermerë);
- Drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Ferizajt;
- Dëgjimi buxhetor me grupe të cënueshme (pensionistët, personat me aftësi të kufizuara etj.);
- Personeli shëndetësorë - QKMF, QMF të Komunës së Ferizajt;
- Takim me komunitetin pakicë;
- Takim me gratë.

- Janë mbajtur edhe dy takime publike me qytetarë, në këto takime Kryetari i Komunës, Agim Aliu ka raportuar për punën 6 mujore, si dhe ka prezantuar edhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026, si dhe ka raportuar punën një (1) vjeçare.

- Po ashtu një takim ka mbajtur edhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit për projektin për rregullimin e Zonës Turistike në Neredime dhe Jezerc.

Mbledhjet e Kuvendit, diskutimet publike për aktet juridike që nxori Komuna e Ferizajt gjatë vitit 2023, diskutimet me qytetarë për hartimin e projektbuxhetit dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore, vendimet e Kryetarit të Komunës dhe drejtorive komunale, procesverbalet e Kuvendit, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, marrëveshjet me institucione të ndryshme, raportet financiare, shpenzimet e buxhetit të vitit 2023, planet e raportet e mekanizmave të tjerë

relevant të Komunës, konkurset, njoftimet, ankandet publike, lista e përfituesve të subvencioneve, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen janë dokumentacione e materiale të qasshme në ueb faqen e Komunës së Ferizajt.

Gjatë vitit 2023, kemi pasur 80 kërkesa për qasje në dokumente publike ku të gjitha kërkesat janë miratuar, duke ia dërguar parashtruesve të kërkesave, përveç vendimit për lejimin e qasjes në dokumente publike edhe materialin përkatës për të cilën është parashtruar kërkesa për qasje në dokumente publike.

Synim për vitin 2024, Zyra e Informimit dhe Komunikimit me Publikun ka krijimin e lehtësirave teknologjike për qasjen në informacione e dokumente zyrtare, përmes platformave digjitale, rritja e dukshmërisë dhe qarkullueshmërisë përmes promovimit të ueb faqes zyrtare të Komunës, rritja e kapacitetit njerëzor e operativ në kryerjen e detyrave të informimit publik dhe përdorimi i zgjeruar i kanaleve alternative e të drejtpërdrejta të komunikimit me publikun.

Vlen të ceket se gjatë vitit 2024, do të bëhet plotësim-ndryshimi i Rregullores së Transparencës por edhe Planit të Veprimit të Transparencës Komunale , për shkak të ndryshimit të udhëzimit administrativ.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

INSPEKTORATI I KOMUNËS

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Gjatë vitit 2023, Inspektorati i Komunës së Ferizajt, ka zhvilluar procesin e punës sipas objektivave dhe planit të punës të parashikuar për periudhën një vjeçare.

Të dhënat e përfshira në raport e në veçanti të arriturat janë rezultat i punës së të gjithë zyrtarëve të Sektorit për Inspektime.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2023

- Organizimi dhe planifikimi i punëve të brendshme të sektorit;
- Inspektimi i subjekteve afariste dhe pajisja e tyre me pëlqim të kushteve minimale teknike;
- Inspektimi dhe monitorimi i deponive ilegale të mbeturinave në kuadër të Komunës së Ferizajt;
- Inspektimi i subjekteve për pajisje me LMK (Leje Mjedisore Komunale);
- Zbatimi i Udhëzimit Administrativ për shqiptimin e Gjobave Mandatore;
- Inspektimi dhe monitorimi i shitësve ambulant;
- Monitorimi i rrugëve të qytetit;
- Aksione me Policinë e Kosovës – Njësi Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;

- Monitorimi i subjekteve të cilat janë mbyllur për shkak të zhvillimit të veprimtarive devijante;
- Monitorimi dhe kontrollimi i objekteve me ose pa leje;
- Lirimi i hapësirave publike në vend punishte;
- Lirimi i trotuareve nga pengesat e ndryshme, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Kompaninë “Pastërtia”;

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Sektori i Tregut:

Në kuadër të Sektorit të Inspeksionit funksionon edhe Njësia e Inspektoratit të Tregut.

Gjatë kësaj periudhe:

- Janë kryer 245 kontrollime të rregullta me procesverbale të hartuar dhe një mori kontrollimesh vizuale.
- Janë lëshuar 149 Vendime për dhënien e Pëlqimit për plotësimin e kushteve teknike për ushtrimin e veprimtarisë biznesore për subjektet afariste.
- Janë konfiskuar mallra të ndryshme në 2 raste.
- Është proceduar një fletëparaqitje për Kundërvajtje në Gjykatën Themelore për Kundërvajtje në Ferizaj.
- Është proceduar një kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Ferizaj.
- Janë shqiptuar 47 gjoba ndaj subjekteve afariste për shkelje të ligjeve që janë në kompetenca të Inspektoratit të Tregut.
- Janë aprovuar 11 kërkesa për zgjatjen e orarit të punës.
- Janë shqyrtuar 34 ankesa të palëve të ardhura nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe nga persona fizik.
- 2 njoftime për Policinë e Kosovës, Njësitin Kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit.

Sektori i Ndërtimit:

Inspektorati i Ndërtimtarisë gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2023 ka realizuar një varg inspektimesh të rregullta dhe të jashtëzakonshme në territorin e Komunës të Ferizajt. Të gjitha këto veprime, Inspektorati i Ndërtimtarisë i ndërmori duke u bazuar në Ligjin e Ndërtimit 04/L-110, Ligjin e Inspektoratit të Ndërtimit 04/L-175 dhe udhëzimeve administrative në fuqi. Bazuar në ligjet dhe aktet e lartcekura, si dhe inspektimet e kryera, janë ndërmarrë këto veprime.

- Janë pranuar gjithsej 29 lëndë nga arkiva.
- Nga lëndët e pranua janë 21 ankesa, të cilat janë zgjidhur.
- Kërkesa kanë qenë 6, të gjitha janë zgjidhur.
- Janë realizuar 280 inspektime.
- Janë hartuar 104 procesverbale.
- Janë marr 33 vendime për ndërprerje të punimeve.
- Janë bërë 33 mbyllje të punishteve (vendosje të shiritit dhe shenjës).
- Janë shqiptuar 23 gjoba mandatore.
- Janë bërë 7 kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse.
- Janë proceduar 3 kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Ferizaj.
- Janë marr 4 vendime për rrënim.
- Janë bërë 20 shkresa për (dhe nga) organe dhe institucione tjera.
- Përveç punëve të lartcekura, janë realizuar edhe punë në bashkëpunim me inspektorët tjerë.

Sektori i Ambientit:

Gjatë periudhës kohore dymbëdhjetë mujore janë inspektuar numër i madh i bizneseve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale. Numri më i madh i këtyre bizneseve merren me përgatitje të ushqimeve të shpejta, përgatitje të bukës dhe pjekurinave të tjera nga mielli, mishtore, përpunues të drurit (mobilerive) etj. Të gjitha këto inspektime janë bërë në bazë të nenit 15 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, ku saktësisht precizohet se cilat aktivitete i nënshtrohen LMK-s. Nga këto subjekte afariste është kërkuar që t'i

plotësojnë kushtet për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Një numër i këtyre subjekteve afariste janë pajisur me LMK, ndërsa tjerat janë në procedurë të pajisjes me LMK.

Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe mbajtjes pastër të qytetit. Janë realizuar disa takime me K.R.M "Pastërtia", N.P.L."Ambienti" SH.A. dhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave për bashkëpunimin lidhur me mbajtjen sa më të pastër të qytetit.

- Janë shqiptuar 122 gjoba mandatore duke filluar nga 50 deri në 500 euro, gjoba këto për hedhje të mbeturinave, vajrave në hapësira të ndaluara, shpërndarje të broshurave (fletushkave) promocionale, ndotje të rrugëve etj., që kanë rënë ndesh me LIGJIN NR. 08/L-071 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.04/L-060 PËR MBETURINA - NENI 49.
- Të gjitha gjobat e pa paguara përcillen tek përmbaruesi për ekzekutim të mjeteve monetare.
- Përveç gjobave janë dhënë edhe shumë vërejtje të mos hedhen mbeturina në hapësira të cilat është e ndaluar hedhja e tyre. Po ashtu, përmes njoftimeve të protokolluara i kemi njoftuar qytetarët për orarin e hedhjes së mbeturinave në çdo pjesë të qytetit.
- Janë pranuar 39 ankesa me shkrim të cilave i jemi përgjigjur në afat të duhur por ka akoma të cilave do i përgjigjemi brenda afatit të paraparë për shqyrtimin e tyre.
- Janë pranuar po ashtu rreth 70 ankesa të pa protokoluara nga qytetarët të cilave i jemi përgjigjur menjëherë si dhe efekti ka qenë pozitiv.
- Gjithashtu gjatë inspektimit në terren janë hartuar 42 procesverbale për konstatim të gjendjes si dhe rekomandime për ecurinë e mëtutjeshme.
- Po ashtu janë realizuar 15 njoftime/rekomandime me shkrim për eliminim të deponive ilegale.
- Janë realizuar inspektime të kohëpaskohëshme së bashku me Inspektorët e MMPH-së lidhur me Planin Operativ “PARANDALIMI DHE NDALIMI I AKTIVITETEVE TË JASHTËLIGJSHME NË SEKTORIN MINERAR” (saktësisht jemi marrë me baza të asfaltit dhe gurthyes).

Sektori Komunal:

Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, inspektorët komunal janë angazhuar në zbatimin dhe implementimin e rregullores për rregullin dhe shërbimet komunale.

Të gjitha procedurat administrative, procesverbalet, aktvendimet si dhe kërkesat për kundërvajtje në gjykatë, janë të bazuara në ligjin për procedurë administrative, Kodin Penal dhe në rregulloren për shërbimet komunale të Komunës së Ferizajt.

Zbatimi i kësaj rregullore konsiston në mirëmbajtjen e rregullt të trotuareve, rrugëve, hapësirave publike, parqeve, tregjeve në mënyrë që të evitohet rrezikshmëria e qytetarëve, në mirëmbajtjen e infrastruktuës komunale etj.

Angazhimi i inspektorëve komunal ka qenë i orientuar në parandalimin e dukurive negative dhe eliminimin e tyre në hapësirat publike në qytet dhe zonat rurale, si dukuri më e theksuar edhe në këtë periudhë kanë qenë tregtarët ambulant me shtadet lëvizëse të vendosura në hapësira publike, verandat dhe mosrespektimi i skicave për shfrytëzimin e hapësirave publike, krijimi i deponive ilegale të mbeturinave në disa pjesë të qytetit, kanalizime të ndryshme, defekte në ujësjellës etj. Në këtë raport po paraqesim të dhënat në mënyrë kronologjike për zhvillimin e procedurave dhe kontrolleve të ndryshme:

- Ankesa dhe kërkesa të qytetarëve - 70
- Të përfunduara -69
- Në proces e sipër - 1
- Kontrolle vizuele - 156
- Procesverbale - 185
- Vendime dhe shkresa zyrtare - 22
- Kallëzime penale - 3
- Gjoha - 49
- Përgjigje në kërkesa të veçanta - 21
- Kërkesa për kundërvajtje – 2



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



ZYRA E NJËSISË SË AUDITORIT TË BRENDSHËM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Raporti i punës është përgatitur nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, i cili përmbledh punët dhe shërbimet e auditimit të brendshëm të kryera gjatë vitit kalendarik 2023.

Raporti pasqyron punën e kryer dhe rezultatet e arritura, krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara vjetore të vitit 2023. Auditimet e brendshme janë të mbështetura dhe të bazuara në Ligjin Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe ligjet dhe akteve nënligjore të tjera në fuqi.

Njësia e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 ka përgatitur Planin Strategjik 2023/2025 si dhe Planin Vjetor 2023 e që planifikimi i auditimit është bazuar në rrezikun dhe orientimin e identifikimit dhe përfshirjes për fushat me rrezik për organizatën buxhetore.

Pasi që nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgatitur Plani Strategjik dhe Plani Vjetor për vitin 2023, është përcjellë për miratim tek Kryetari i Komunës dhe tek Kryesuesi i Komitetit dhe gjithashtu është dorëzuar një kopje e miratuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Në Planin Strategjik 2023-2025 janë të përfshira të gjitha drejtoritë-njësitë buxhetore, duke u bazuar në nivelin e rrezikshmërisë me: rrezik të lartë, rrezik të mesëm dhe rrezik të ulët dhe gjithashtu është hartuar Plani Vjetor në të cilin janë paraparë ditët efektive për çdo auditim.

Për vitin 2023, sipas Planit Vjetor janë paraparë gjithsej shtatë (7) auditime të brendshme, që janë: katër (4) me rrezik të lartë dhe tre (3) me rrezik të mesëm. Për vitin 2023 janë kryer këto auditime:

- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve për mallra, shërbime, komunal, subvencione dhe shpenzimet e derivateve dhe mirëmbajtja e automjeteve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime kapitale në Drejtorinë e Infrastrukturës;

- Procedurat e menaxhimit të pasurive dhe inventarit në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme;
- Procedurat e menaxhimit të resurseve njerëzore në Drejtorinë e Arsimit;
- Procedurat e menaxhimit të prokurimit në Zyrën e Prokurimit;
- Grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë, taksat e bizneseve dhe qirave në Drejtorinë e Financave;
- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve për mallra, shërbime, subvencione dhe kapitale në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë.

Niveli i realizimit të Planit Vjetor

Gjatë vitit 2023, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej shtatë (7) auditime të brendshme nga shtatë të planifikuara.

Pra, gjatë vitit 2023, Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej gjithsej shtatë (7) auditime të brendshme dhe t'i hartoj raportet e t'i dorëzoj në drejtoritë e audituara, Kryetarit të Komunës si dhe Kryesuesit të Komitetit nga një kopje të raporteve finale.

Nga gjithsej shtatë (7) auditimet e kryera për të gjeturat e konstatuara kemi dhënë njëzet e tetë (28) rekomandime për përmirësim, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit gjatë kryerjeve të detyrave të punës nga ana e zyrtarëve të Komunës.

Për rekomandimet e dhëna, të gjitha drejtoritë janë përgjigjur, duke na përcjellë dhe përgatitë planin e veprimit dhe datën përfundimtare të zbatimit të rekomandimeve. Bazuar në planet e veprimit të drejtorive, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur oraret e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve të dhëna nga kjo zyrë.

Gjatë përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve nga gjithsej njëzet e tetë (28) rekomandimet e dhëna, kemi konstatuar këtë gjendje lidhur me zbatimin e tyre nga ana e drejtorive:

- Tërësisht të zbatuara - katër (4)
- Në proces - dhjetë (10)
- Të pazbatuara - katërbëdhjetë (14)

Dhjetë (10) rekomandime mbeten për përcjellje gjatë vitit 2024, sipas planit të veprimit të përgatitur për datën përfundimtare të implementimit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për çdo përcjellje të rekomandimeve ka hartuar raporte dhe ua ka dorëzuar drejtorive të audituara, Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Komitetit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për dy (2) gjashtëmuorët e vitit 2023 dhe përmbledhjen e vitit 2023 ka përgatitur raportet përmbledhëse dhe ua ka dorëzuar për njoftim me gjendjen e audituar në drejtoritë e audituara në Komunën e Ferizajt, Njesisë Qendrore Harmonizuese, Kryetarit të Komunës si dhe Kryesuesit të Komitetit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Zyra për Integritet Evropian funksionon në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Ferizajt. Kjo zyre ka rol të koordinimit, monitorimit dhe raportimit në institucionet gjegjëse të cilat merren me Integritet Evropian. Pra, linjat e komunikimit në mënyrë të vazhdueshme i mbajmë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Departamenti për Integritet Evropian.

Gjatë periudhës dymbëdhjetëmuajore, respektivisht Janar - Dhjetor 2023, ne kemi kryer në përpikmëri obligimet të cilat i kemi të përcaktuara sipas detyrës zyrtare, pra koordinimin, monitorimin dhe raportimin në institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilat merren me Integritet Evropian.

Zyrtari për Integritet Evropian ka qenë i përfshirë në ekipin e Kryetarit të Komunës së Ferizajt për aplikim në fondet e Bashkimit Evropian dhe ka mbajtur kontakte të rregullta me organizata të jashtme, ato të Këshillit të Evropës dhe të tjera të cilat operojnë në Republikën e Kosovës. Gjithashtu vazhdojnë këto ekupe të përbashkëta të jenë aktive edhe për thirrjet e reja të BE-së. Në vitin 2023 ka përfunduar implementimi i projektit “CBCEkoKid” në bashkëpunim me Komunën e Çairit të Maqedonisë së Veriut, në kuadër të projekteve për bashkëpunim ndërkufitar IPA II.

Gjithashtu gjatë periudhës njëvjeçare janë bërë edhe aplikime të tjera në Prospect – Faqen zyrtare të Komisionit Evropian. Gjithashtu vlen të theksohet që aplikimet e reja janë pamundësuar pas sanksioneve të Bashkimit Evropian për Republikën e Kosovës.

Kemi bërë raportimin e rregullt periodik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me Bashkëpunimin Ndërkomunal dhe Ndërkomunal Ndërkombëtar. Poashtu kemi kompletuar dokumentacionin dhe dosjet e punëve të kryera. Kemi kryer edhe punë të tjera të arsyeshme zyrtare në kuadër të zyrës.

Gjatë periudhës raportuese, Zyra për Integritet Evropian ka bërë raportimin e rregullt në MAPL lidhur me implementimin e Planit Individual të Veprimit për Komunën e Ferizajt, dalur nga Agjenda Evropiane për vitin 2023. Kemi plotësuar pyetësorët e ndryshëm të kërkuara nga MAPL dhe AKK. Janë ndërmarr të gjitha ato veprime me prioritet për integritet evropian, me të cilat synohet krijimi i një klime të volitshme për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetës së qytetarëve, sundimin e ligjit, mbrojtjen e pronës, lirinë e lëvizjes, shprehjen e mendimit, tolerancën dhe krijimin e mirëbesimit.

Në periudhën njëvjeçare Janar – Dhjetor 2023, kemi mbajtur kontaktet e përditshme dhe dërgimin e informatave të kërkuara me Departamentin për Koordinim, Zhvillim dhe Integritet Evropian të MAPL-së dhe ministritë e linjave. Në të gjitha takimet konsultative apo tryezat e punës, jemi përgjigjur pozitivisht thirrjeve të ministrive përkatëse, duke dhënë kontributin tonë për çështjet në fjalë.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Gjatë vitit 2023, ZKKK-ja në përmbushje të rolit të saj ka realizuar këto punë dhe aktivitete:

- Kemi takuar përfituesit e skemës për ndërtimin e shtëpive nga MSHMS;
- Kemi koordinuar bashkëpunimin me zyrtarët nga CDF lidhur me aftësimin e të rinjve për punë;
- Kemi vazhduar bashkëpunimin me OSBE-në në hartimin e Planit Lokal për Veprimet ku janë të përfshira përveç ZKKK-së edhe drejtoritë përkatëse komunale si dhe shoqëria civile;
- Zyrtarët nga ZKKK kanë informuar dhe asistuar aplikantët në plotësimin e dokumentacionit për aplikim për thirrjen publike të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për përmirësimin e kushteve të banimit për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë. Ndhimat e mbështetura nga Ministria ishin: rindërtimi i shtëpive, renovimi, material ndërtimor, teknikë të bardhë, mobilje dhe ushqim.
- Kemi vazhduar bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në punëtoritë e organizuara nga GIZ lidhur me shëndetin, pastërtinë dhe ushqimin.
- Me Fondacionin Jahjaga kemi zhvilluar takime e koordinime me qëllim të nxitjes së pjesëmarrjes në grave dhe vajzave të komunitetit për trajnime, aftësi profesionale dhe zhvillimin e saj.
- ZKKK ka mbështetur DSHMS-në e cila ka ndihmuar 30 familje me pako ushqimore dhe higjienike.
- Në bashkëpunim me DSHMS dhe QPS, kemi mundësuar shpërndarjen e ndihmave për 106 familje komunitare në nevojë.
- Morëm pjesë në trajnimin e USAID-it me qëllim vetëdijësimin për të drejtat pronësore;
- ZKKK ka kryer analizën përmes pyetësorit mbi gjendjen socio-ekonomike të familjeve rom, ashkali dhe egjiptian në Ferizaj;

- Mirëpritëm delegacionin nga Finlanda dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve që për synim ka integrimin socio-ekonomik dhe sigurimin e të drejtave të barabarta për gratë dhe vajzat e riatdhesuara dhe refugjatëve.
- Kemi zhvilluar biseda e kontakte edhe me kompani private për mundësitë e punësimit për të rinjtë e komunitetit;
- Dy familje komunitare ishin përfituese të Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e shtëpive, një në fshatin Dardani dhe tjetra në fshatin Zaskok.
- ZKKK ka zhvilluar edhe vizita në shkolla si në Gjimnazin “Dr. Shaban Hashani” dhe Shfmu “Tefik Çanga” për të identifikuar sfidat dhe adresuar ato për shkollarët nga radhët e komuniteteve.
- ZKKK ka mbajtur takime e ka zhvilluar nisma me Grupin Këshillues për Komunitete në Ferizaj implementuar nga organzjata Terre Dess Homemes mbështetur nga Medikor, me synimin zhvillimin e rrjetit të sigurt për mbrojtjen e fëmijëve;
- Për të drejtat e komuniteteve, ZKKK ka marr pjesë në trajnimin dyditor me Institutin e Kosovës për Administratë Publike;
- ZKKK ka ndërmarr fushatë informuese për prindërit dhe nxënësit për regjistrimin e nxënësve në shkollimin parafillor dhe në klasën e parë;
- ZKKK ka lehtësuar pjesëmarrjen e banorëve të lagjes Sallahane ku paraqitën kërkesat e tyre në procesin për hartimin e Buxhetit të Komunës;
- Kemi ndihmuar Drejtorinë e Bujqësisë në shpërndarjen e njoftimeve për projektin IWKA - përfshirja e grave në agrobiznesin e Kosovës.
- Ishim pjesëmarrës në tryeza të shumta diskutimi si ajo me temën “Diskutim për avancimin e llogaridhënies në planifikimin financiar komunal”.
- Bashkë me organizatën SHPRK kemi zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuere për banimin social dhe të drejtat pronësore në Kosovë, me theks të veçantë të drejtat pronësore e sfidat që ka komuniteti;
- Ishim pjesë e fushatës së organizuara nga Zyra e Kryeministrit për liberalizimin e vizave;
- Ishim pjesë e punësive ku është diskutuar për praktikat komunale në mbrojtje të dinjitetit, mos diskriminimit dhe barazisë gjinore, raportimet e brendshme dhe mekanizmat mbrojtës brenda komunave, trajnimin “Hyrje në antigjipizëm”, projekti “Drejtësia Sociale për Rom, Ashkanli dhe Egjiptas”;
- Mirëpritëm Institutin Gjerman “Bom International Centre for Conflict Studies Return+Belonging” - (BMZ) ku kemi zhvilluar kontakte mbi strehimin, trajnimin, punësimin dhe shërbimet shëndetësore për komunitetin.
- Me organizatën Vo Rae kemi diskutuar e nisur aktivitete të përbashkëta lidhur me problemet e pronësisë në lagjet Sallahane, “Halit Ibishi” dhe në fshatin Dubravë, ku pjesë e aktivitetit tonë ishte edhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit.

KTHIMI I QËNDRUESHËM – RIATDHESIMI

- Kemi pasur koordinim të aktiviteteve me të gjithë faktorët relevant për stabilizimin e komuniteteve, procesin e kthimit të qëndrueshëm dhe procesin e riatdhesimit dhe ri-integrimit me qëllim të krijimit të një klime të mirë për zhvillim të komuniteteve dhe ri-integrimin e tyre, lehtësimin e dialogut ndëretnik dhe ndërtimin e besimit ndërmjet personave të kthyer dhe komunitetit pranues;
- Koordinuam aktivitetin me zyrtarët për kthim të qëndrueshëm, zyrtarët për integrim të komuniteteve, me institucionet komunale, ministritë përkatëse si dhe bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e tjera lokale dhe ndërkombëtare të angazhuara në fushën e stabilizimit të komuniteteve, kthimit dhe ri-integrimit (shkëmbimi i informatave për personat e zhvendosur dhe personat e kthyer).

Riatdhesimi dhe Ri-integrimi

- Të riatdhesuar në vitin 2023 janë 16 persona.

Sipas përkatësisë etnike:

Shqiptarë – 9 persona (5 M dhe 4 F- 1 fëmijë)

Ashkali – 7 persona (3 M dhe 4 F - 2 fëmijë)

- Të regjistruar në SMR (Sistemi i Menaxhimit të Rasteve) nga ZKKK – ja 16 raste të vitit 2023 dhe 6 raste të viteve të tjera.
- Komisioni Komunal për Ri-integrim ka mbajtur 3 takime për shqyrtimin e 3 kërkesave. Të aprovuar janë 2 kërkesa për akomodim, një për vazhdimin e akomodimit edhe për 6 muaj dhe një akomodim për 12 muaj.
- Vizita 72 orësh për plotësimin e Pyetësorit për Vlerësimin e Nevojave të Personave të Riatdhesuar janë 10.
- Janë përgatitur 3 vendime për kërkesat nga familjet e riatdhesuara – 2 akomodim dhe një për barna, vendimet dhe të gjitha dokumentet tjera të palëve janë bashkangjitur në SMR dhe kopja fizike është dërguar tek Kordinatori Rajonal për Ri - integrim pranë MPB - ës.

- Nga Fondi për Ri – integrim, 2 familje janë furnizuar me pako ushqimore dhe higjienike dhe shpërndarja është bërë në koordinim me ZKKK - në.
- Nga akomodimi janë ndalur 2 familje pas periudhës 12 mujore, këto familje janë rekomanduar tek Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vazhdimin e akomodimit në bazë të kriterëve që ka kjo Drejtoria.
- Tek Zyra e Punësimit janë rekomanduar 8 persona të riatdhesuar, të cilët më pastaj janë rekomanduar në Qendrën për Aftësim Profesional – QAP.
- Thirrjes për aplikim nga UNDP përmes Zyrës së Punësimit për Plan Biznesi iu kanë përgjigjur 43 persona, 25 kërkesa janë aprovuar dhe ZKKK - ja ka ndihmuar palët për kompletimin e lëndëve për implementim ndërsa 18 kërkesa janë refuzuar (personat e riatdhesuar që një herë kanë qenë përfitues të plan bizneseve, që kanë pasur biznese aktive dhe ata që nuk e kanë kompletuar lëndën).
- Vizita studimore (4 ditore) në Lozanë të Zvicrës me temë kryesore: migrimi, refugjatët, riatdhesimi dhe ri-integrimi.
- Gjatë vitit 2023, personat e riatdhesuar janë përkrahur edhe nga organizatat URA 2, AWO, DIAKONIA, por ZKKK-ja nuk posedon informata për aktivitetet dhe ndihmat e ofruara.

Kthimi

Sa i përket kthimit gjatë kësaj periudhe janë 3 kërkesa për kthim (kërkesat e ardhura nga organizata AT, por që nuk janë të kompletuara dhe mbesin në proces për shqyrtim në Komisionin Komunal për Kthim).

- Të kthyerit nga Maqedonia e Veriut, janë asistuar nga UNHCR, të cilat janë përkrahur me akomodim njëvjeçar, pako ushqimore dhe jo ushqimore, pakot e orendive shtëpiake, pagesë mujore për një vit dhe projekt për qëndrueshmëri ekonomike. Por pas kësaj asistencë këto familje të kthyera vazhdojnë të mbesin pa zgjidhjen e problemit të banimit për shkak të mungesës së pronës dhe gjendjes jo të mirë ekonomike.
- Draft - Plani Komunal për Ri-integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Ferizajt 2023 - 2025 është aprovuar në Kuvendin e Komunës.
- Kemi qenë pjesë e aktiviteteve, trajnimeve dhe takimeve të punës me organizata të ndryshme dhe ministri – ngritja e kapaciteteve të ZKKK – ve, hartimi i Planit Komunal të Veprimt për Personat e Riatdhesuar, funksionimi i databazës dhe të tjera.

Të gjitha aktivitetet janë kryer në koordinim me Zyrtarët Komunal për Kthim të Qëndrueshëm.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Ky raport pasqyron përmblendhjen e punës së Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrtarit për Barazi Gjinore për periudhën Janar –Dhjetor 2023. Në raport janë prezantuar aktivitetet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara gjatë kësaj periudhe në fushat të cilat i trajton NJDNI dhe ZBGJ.

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Treguesit e suksesit- rezultatet	Afati kohor
Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë për të gjithë.	Monitorimi i rekrutimit në punësim në sektorin publik (pjesëmarrja në intervista).	NJKDNJ ZBGJ	Rritja e shkallës së zbatimit të legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi punën dhe punësimin. Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim.	Vazhdimësi
Ofrimi i shërbimeve më të mira shëndetësore.	Ofrimi i rekomandimeve për Rregulloren Komunale për lirin nga pagesa të kategorive të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësinë. Ofrimi i shërbimeve falas për kancerin e gjirit.	NJKDNJ DSHMS	Krijimi i lehtësirave për shërbime shëndetësore.	
Ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarë në administratën publike.	Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e shërbimeve më të mira për qytetarë.	ZBGJ	Ofrimi i shërbimeve dhe krijimi i lehtësirave në marrjen e dokumenteve identifikuese për qytetarë.	

Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.01/2023 për heqjen e taksave komunale për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve.	Ofrimi i udhëzimit në shërbim të qytetarëve.	DPGJK dhe NJDNJK/ZBGJ		Masë afirmative 1 vjeçare
Projekt-Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr.2002 masat për mbrojtjen e fëmijëve kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe atyre që dëmtojnë shëndetin e fëmijëve.	Konsultime paraprake			Vazhdimësi
Trafikimi me qenie njerëzore	Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës në Ferizaj, QPS, ZBGJ			
Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave dhe Plani i Veprimit 2022-2026.	Ministria e Drejtësisë	NJDNJK ZBGJ		
Buxheti i Përgjegjshëm Gjinator	Agjencia për Barazi Gjinore	ZBGJ	Asistenca teknike nga UN Women	
Buxheti i përgjegjshëm gjinator si mjet për avancimin e barazisë gjinore në nivel komunal të organizuar nga UN WOMEN në Kosovë.	UN WOMEN	Zyrtarja për Barazi Gjinore		
Marrëveshja mes Komunës dhe UN WOMEN.	Buxheti i përgjegjshëm gjinator		ZBGJ	
Punëtori nga UN Women	UN WOMEN ZBGJ	Paneliste në prezantimin e kornizës ligjore që rregullojnë çështjet gjinore në nivelin lokal së bashku me dokumentet strategjike.	ZBGJ	
Policia e Kosovës	Punëtori për përfshirjen e të rinjve brenda KLSP-ve si dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e integritetit gjinator dhe të rinjve.		ZBGJ	

Projekti Demos i zbatuar nga organizata HELVETAS	Përkrahja në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.			
Fondacioni Jahjaga	Përfshirja dhe fuqizimi ekonomik i grupeve të marginalizuara në Kosovë.	Fondacioni Jahjaga në koordinim me UNHCR dhe UNDC/UNKT takim virtual me gratë dhe vajzat nga komuniteti jo-shumicë që jetojnë në Komunën e Ferizajt.	ZBGJ	
Agjencia për Barazi Gjinore dhe ZBGJ	Hapja e fushatës globale 16 Ditë të aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore ndaj grave dhe vajzave.	ZBGJ	Hapja e fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit.	
ABGJ	Tryezë diskutimi në shënimin e 16 Ditëve të Aktivizimit.	ZBGJ	Paneliste për 16 Ditët e aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore ndaj grave dhe vajzave.	
Avokati i Popullit	Hetimi i përgjithshëm për shëndetin maternal, planifikimin familjar dhe abortin në Kosovë.	ZBGJ	Fokus-grupet për shëndetin riprodhues, është thirrja falas 080015555.	
Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	E drejta e qytetarëve për qasje në drejtësi dhe ndihmë juridike falas.	ZBGJ	Qasja e të gjithë qytetarëve për drejtësi.	
Komuna/USAID	ZBGJ	Si mund ta zvogëlojnë të drejtat pronësore rrezikun nga dhuna në baza gjinore?	Vazhdimësi	
Informimi dhe vetëdijësimi i femrave për eliminimin e stigmave që pengojnë avancimin e gruas	USAID	ZBGJ	Vazhdimësi	
Ofrimi i mundësive të barabarta për grua-burrë		ZBGJ		
		ZBGJ		

Parandalimi i strereotipeve dhe paragjykimeve për gruan		ZBGJ	Vazhdimësi	
Informimi dhe vetëdijësimi i femrave për eliminimin e stigmave që pengojnë avancimin e femrës e veçmas në trashëgimi		ZBGJ		
Identiteti gjinor		ZBGJ		
Përkatësia gjinore		ZBGJ		
Pozita e femrës në familje dhe vendimmarrje		ZBGJ		
Pozita e barabartë e vajzës dhe djalit në familje		ZBGJ		
Format e diskriminimit të gruas		ZBGJ		
Dhuna në familje		ZBGJ dhe mekanizmat tjerë institucional		
Ligji për Barazi Gjinore	Promovimi i të drejtave të grave dhe të vajzave Prezantimi i analizës në sektorin e arsimit.			
Takimet me organizatat ndërkombëtare OSCE, Këshilli i Evropës		ZBGJ		
Punëtori mbi rolin e grave dhe kontributin e tyre në siguri në bashkësi.		ZBGJ		
Rrjeti i Grave Profesionale në kuadër të organizatës “Leadership and Growth Council”, takim për të diskutuar mbi rolin e grave në qeverisje dhe perspektiva për pjesëmarrjen e grave.		OSCE-ZBGJ		
Performanca komunale DEMOS		ZBGJ		

MAPL - Tryeza e rrumbullakët me temën “Nëna, gruaja dhe dhuna”		ZBGJ		
Promovimi i të drejtave të komuniteteve.	Organizimi i takimeve të komunitetit pakicë për të drejtat e komuniteteve.	NJDNJ ZBGJ	Integrimi i komuniteteve në jetën institucionale e publike	
Promovimi i të drejtave të fëmijëve.	Organizimi i debateve publike me drejtues të shkollave, nxënës, qytetarë për të drejtat e fëmijëve.	NJDNJ DA	-Identifikimi i gjendjes aktuale - Zbatimi i infrastrukturës ligjore për fëmijë	
Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.	- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e kushteve për PAK-të. - Identifikimi dhe sigurimi i të dhënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.	NJDNJ	- Infrastruktura e rregulluar për PAK-të - Grumbullimi i të dhënave për fëmijët me AK	



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2023

Agnesa Hajredini
Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme

Përmbajtja

Hyrje.....	..
1. ZYRTARJA ADMINISTRATIVE (Asistentja Ekzekutive)	..
2. ZYRTARI FINANCIAR	..
3.SEKTORI I GJENDJES CIVILE	..
4. ZYRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE	..
5.SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA	..
6. NJËSIA E PËRKTHYESEVE.....	..
7. NJËSIA E ARKIVIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE	..

Hyrje

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për administratën komunale dhe për ofrimin e shërbimeve për qytetarë, bazuar në ligjet që janë në fuqi: Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji mbi Shërbimin Civil, Ligji për Gjendjen Civile, Statutin e Komunës, udhëzimet strategjike të Kryetarit të Komunës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet administrative.

DAP është garantuese e funksionimit demokratik të administratës komunale në aspektin e vendimmarrjes;

- E lirisë së shprehjes së mendimit;
- Trajtimin të drejtë të kërkesave e shqetësimeve të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të caktuara të interesit;
- Zbatimit rigoroz të ligjit në procedurat administrative dhe ekzekutive;
- Rritjes së partneritetit ndërmjet administratës në njërën anë dhe qytetarëve në anën tjetër;
- DAP do të vazhdojë t'i ruaj dhe kultivoj edhe më tej marrëdhëniet e mira me komunitetet pakicë, në respektim e të drejtave dhe lirive të tyre, sipas parimit ligjor dhe qytetar.

Synimet e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme gjatë vitit 2023 kanë qenë:

- Krijimi i një administrate profesionale, të përgjegjshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve;
- Infrastrukturë të avancuar profesionale;
- Ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me punët e legjislativit dhe të ekzekutivit.

DAP është angazhuar për të siguruar dhe garantuar:

- Respektim të ligjit (akteve ligjore, nënligjore dhe normative);
- Llogaridhënie;
- Profesionalizëm;
- Efikasitet;
- Barazi gjinore;
- Transparencë në vendimmarrje dhe procedura ekzekutive;
- Luftë kundër dukurisë së korrupsionit dhe dëmtimit të pasurisë së Komunës;
- Shërbime publike cilësore dhe të shpejta për qytetarët;
- Frymë të tolerancës për mendimin ndryshe dhe të bashkëpunimit e bashkëpjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në përmirësimin e shërbimeve të administratës komunale.

Angazhimi i vazhdueshëm i DAP për ndërtimin e një administrate funksionale dhe efikase mbi bazën e respektimit të ligjit.

- DAP gjatë vitit 2023 ka zhvilluar një aktivitet të gjithanshëm të bazuar në respektimin e ligjeve në fuqi

të Republikës së Kosovës, duke qenë në funksion dhe në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të Komunës tonë.

Gjithashtu gjatë viti 2023 ka organizuar zgjedhjet në bazë të nenit 12.2 pika c dhe nenit 34.4 të Ligjit nr.03./L-040 për Vetëqeverisjen lokale; Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

- DAP e organizuar në sektorët e lartshënuar ka arritur që me përkushtimin më të lartë t'i kryej me sukses të gjitha punët dhe detyrat që i kanë dalë përpara gjatë kësaj periudhe një vjeçare të punës, duke qenë vazhdimisht në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të Komunës tonë.

Më poshtë po përmendim vetëm disa nga aktivitetet më të rëndësishme të administratës komunale:

- Gjatë këtij viti kemi organizuar dhe mbikëqyrur regjistrimin vjetor të inventarit të gjithë sektorëve të administratës komunale duke përfshirë edhe institucionet arsimore, shëndetësore, bibliotekave si dhe institucioneve të tjera që janë nën menaxhimin e Komunës dhe pas këtij regjistrimi kemi bërë edhe tërheqjen e inventarit të demoluar, duke e grumbulluar në depo, kurse pjesën që kemi konstatuar se mund të përdoret e kemi riaftësuar dhe dhuruar shkollave që kanë pasur nevojë (sipas kërkesave të tyre).

- Këto veprime janë kryer duke formuar paraprakisht komisionet adekuate siç janë: Komisioni për vlerësim dhe regjistrim të inventarit;

- Janë marrë edhe një varg hapash e masash të tjera për funksionalizimin e mëtejshëm dhe bërjen më efikase të administratës komunale.

Në vazhdim do të paraqesim punën vjetore të sektorëve dhe njësive të DAP.

Administrata gjatë vitit 2023

DAP gjatë vitit 2023 ka zhvilluar aktivitetin e vet përmes këtyre njësive organizative:

1. Asistentja Ekzekutive
2. Zyrtari financiar
3. Sektorit të Gjendjes Civile;
4. Sektorit të Shërbimeve të Qytetarëve;
5. Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta;
6. Njësia Komunale për të Drejtat Komunale

1. ZYRTARJA ADMINISTRATIVE (Asistentja Ekzekutive)

Është përkujdesur për punët administrative në kuadër të Drejtorisë, përkatësisht ka pranuar të gjitha kërkesat e Drejtorisë për të cilat janë zhvilluar procedura, dhe të njëjtat i klasifikon dhe i ruan në Arkivin e Drejtorisë gjegjëse. Shtyp njoftime dhe shkresa të tjera të DAP-së, protokollon të gjitha shkresat që dalin nga DAP, përcjellë përmes postës elektronike shkresa dhe materiale të dedikuara për Ministri, përmes intranetit u jep përgjigje kërkesave që i dedikohen DAP-së si dhe përpilon raportet e Drejtorisë.

2. ZYRTARI FINANCIAR

Është përkujdesur për gjendjen financiare të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, përkatësisht i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për kompletimin e lëndëve për pagesën e të gjitha faturave të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës elektrike, ujit, faturat e pastërtisë, faturat për riparimin e mjeteve zyrtare si dhe faturat tjera që janë barrë e drejtorisë përkatëse.

3.SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Të dhënat për dokumentacionin e lëshuar dhe regjistrimet e bëra nga Sektori i Gjendjes Civile (SGJC), gjatë vitit 2023, po i paraqesim në formë tabelore:

Numri i dokumenteve të lëshuara

Nr.	Përshkrimi	Përdorim të brendshëm	Përdorim të jashtëm
1.	Ekstrakt nga RQGJC	36023	16840
2.	Certifikata të lindjes	3651	27059
3.	Certifikata të martesës	3205	10625
4.	Certifikata të vdekjes	2705	1664
5.	Certifikata të statusit martesor	2152	1055
6.	Certifikata të shtetësisë	181	559
7.	Certifikata familjare	5406	11854
8.	Certifikata të vendbanimit	4608	3361
9.	Vërtetim nga arkivi	829	1112
		58760	74129
Gjithsej dokumente të lëshuara		132889	

Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes Civile

1	LINDJE	2178
	1.1. Brenda vendit	1574
	1.2. Jashtë vendit	269
	1.3. Me vonesë	335
2	MARTESA	1333
	2.1. E rregullt	1102
	2.2. Jashtë vendit	231
3	VDEKJE	574
	3.1. Brenda vendit	418
	3.2. Jashtë vendit	37
	3.3. Me vonesë	119
Gjithsej regjistrime të bëra		4085

Numri i dokumenteve të lëshuara nga Platforma Elektronike E-Kosova

1	Certifikata të lindjes	12563
2	Ekstrakt nga RQGJ	13271
3	Certifikata të martesës	3670
4	Certifikata të vdekjes	440
Gjithsej		29944

Numri i dokumenteve - Shërbime me aktvendim

1	Aktvendime për regjistrime të mëvonshëm në RGJCL-Ri-regjistrim	52
2	Aktvendime për regjistrime të mëvonshëm në RGJCV	93
3	Aktvendime për ndërrim- korrigjim të emrit mbiemrit personal	441
4	Aktvendim për refuzim të regji. të mëvonshëm të lindjes në RGJC	00
5	Aktvendimet për gabime teknike në Prog. Sistem si dhe plotësimi i të dhënave në RTHL	78
6	Aktvendime për refuzimin e ndërrimit të emrit personal	8
7	Aktvendime për anulim të regjistrimit të dyfishtë në RGJC	05
8	Aktvendim për njohjen e vendimit të shtetit të huaj për ndërrimin e emrit personal	09
9	Aktvendime për refuzim të regji. të mëvonshëm të vdekjes në RGJC	08
Gjithsej aktvendime		694

Numri i kërkesave për fitim dhe lirim të shtetësisë

1	Fitim të shtetësisë	57
2	Lirim nga shtetësia	72
Gjithsej kërkesa		129

Shkresa të ndryshëm

1	Njoftime për QPD për ndërrim të emrit personal	71
2	Sektori i Verifikimit – ARC-lëndë për verifikim	58
3	Përgjigje kërkesave nga Gjykata dhe Prokuroria	158
4	Departamenti i Pensioneve të Jashtme	28
5	Ekzekutim të vendimeve për fitim të shtetësisë	14
6	Ekzekutim të vendimeve për lirim të shtetësisë	107
7	Ekzekutime të vendimeve për rifitim të shtetësisë	2
8	Refuzime të vendimeve për humbje apo fitim të shtetësisë	15
Gjithsej shërbime		453

4. ZYRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE

13. Promovuar Turizmin e Komunës së Ferizajt tonë përmes publikimit të video spoteve në rrjetet sociale, publikimin e shkrimeve për atraksionet turistike të Ferizajt në media nacionale dhe të rajonit, sollëm grupe të alpinistëve nga qytete të tjera, prezantuar Komunën e Ferizajt në Panaire të ndryshme të turizmit dhe bizneseve.
14. Në vitin 2023 kemi krijuar hartën digjitale dhe interaktive, hartë e cila gjendet në ueb faqen e turizmit të Komunës së Ferizajt (www.visit-ferizaj.com) kjo hartë krijon mundësi që qytetarët përmes telefonit të marrin informata të sakta për vendndodhjen e lokacioneve turistike ngjashëm sikur me Google Maps. Ky model i hartës turistike interaktive u krijua për herë të parë në Kosovë.

Qendra për Regjistrimin e Bizneseve

Qendra Komunale e Regjistrimit të bizneseve është bërë me platformën e re elektronike me numër unik identifikues të bizneseve ku ka pasur rritje të kërkesave dhe kjo do të vazhdojë edhe në vitin 2024. Me këtë platformë, pronarët që kanë poseduar me shumë se një biznes individual, atyre ju është mundësuar që bizneset tjera ti shndërrojnë në njësi, gjatë periudhës Janar-Dhjetor në QKRB kanë arritur gjithsej 3149 kërkesa dhe këto janë:

- Regjistrime të reja - **1031**
- Ndryshime në biznes - **940**
- Ç'regjistrime biznesi - **101**
- Informata biznesi - **941**
- Vërtetime - **23**
- Ndërrime të certifikatave – **113**

Në qendrën e regjistrimit të bizneseve gjatë periudhës 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023 janë regjistruar gjithsej 1031 biznese të reja dhe gjatë kësaj periudhe janë gjithsej 1187 punëtorë të rinj.

Qendra për regjistrimin e bizneseve (QRB) në Ferizaj gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, ka kryer aktivitete të saja (tabela 1) sa i përket kërkesave të qytetarëve për regjistrimin e bizneseve dhe komunitetit të biznesit për ndërrim dhe shtim të aktiviteteve biznesore apo edhe shuarje të bizneseve. Sa i përket çregjistrimit të bizneseve, gjatë kësaj periudhe janë çregjistruar gjithsej 101 biznese.

Më poshtë gjeni të bashkëngjitur tabelën nr. 2. Ku është prezantuar raporti i vitit paraprak, i cili mund të shërbejë për të bërë krahasimin e situatës sa i përket numrit të bizneseve të regjistruara e të çregjistruara, përfshirë veprimtaritë si dhe numrin e punëtorëve.

Spektori i Regjistrimit të Bizneseve

Bizneset e regjistruara		
Emërtimet	Viti 2022	Viti 2023
Prodhuese	99	237
Tregtare	361	478
Shërbyese	356	244
Ndërtimore	106	72
Gjithsej	922	1031

Struktura gjinore	Viti 2022	Viti 2023
Meshkuj	880	905
Femra	216	282
Gjithsej	1096	1187
Sipas llojit të biznesit	Viti 2022	Viti 2023
SH.P.K.	667	787
B.I.	253	241
SH.A.	0	1
Dega në Kosovë	1	1
O.K	1	1
Gjithsej	922	1031

Bizneset e ç'regjistruara		
Emërtimet	Viti 2022	Viti 2023
Prodhuese	12	23
Tregtare	24	29
Shërbyese	23	44
Ndërtimore	4	5
Gjithsej	60	101
Struktura gjinore	Viti 2022	Viti 2023
Meshkuj	49	74
Femra	11	27
Gjithsej	60	101

Sipas llojit të biznesit	Viti 2022	Viti 2023
SH.P.K.	18	17
B.I.	42	83
SH.A.	0	0
Gjithsej	60	101



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Afrim Llabjani
Drejtore i Drejtorisë së Arsimit

HYRJA

Drejtoria e Arsimit, përkundër sfidave, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka realizuar punë dhe detyra të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe krijimit të kushteve më të mira në nivelin e arsimit parauniversitar, ku për vitin shkollor 2022/23, ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm mbi ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor, duke e analizuar suksesin e nxënësve për rezultatet dhe sukseset e arritura në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Përfundimi i vitit shkollor 2022-2023 është bërë në kushte të rregullta. Ndërsa edhe viti i ri shkollor 2023-2024, ka filluar normalisht.

Përkundër rrethanave të ndryshme, Drejtoria e Arsimit ka përcjellur nga afër ecurinë e procesit arsimor, duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale nga zyrtarët e arsimit, duke funksionalizuar dhe fuqizuar aktivet profesionale (seksionet), duke bashkëpunuar me institucionet dhe organizata të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe sigurimin e efikasitetit të procesit të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies dhe njëkohësisht në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim. Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme të Provimit Shtetëror të Maturës si dhe Testi i Arritshmërisë për klasët e IX-ta.

Duke ditur se vlerësimi është një proces dhe indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme, kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies në procesin edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënojnë progres dhe të arrijnë në nivelin dhe standardin e shkollave të përparuara, si në mësimitdhënie, mësimitnxënie dhe të një vlerësimi sa më objektiv të arritshmërisë së nxënësve.

Raporti i organizimit të punës së Drejtorisë së Arsimit

Organizmi i punëve në Drejtorinë e Arsimit bëhet përmes sektorëve të saj:

- **Spektori i Administratës**
- **Spektori i Financave**
- **Spektori i Arsimit**
- **Spektori i Shërbimit Teknik**

Qëllimi i raportit vjetor është prezantimi i punës njëvjeçare të të gjitha institucioneve edukativo-arsimore, gjegjësisht paraqitet suksesi, rezultatet, të arriturat, por edhe sfidat dhe vështirësitë që kanë përcjellur shkollat dhe procesin edukativo-arsimor në edukimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë në Komunën e Ferizajt, për vitin shkollor 2022-2023.

Drejtorja e Arsimit me kohë i ka planifikuar punët që duhet të kryhen dhe u ka kushtuar kujdes të veçantë, sidomos prioriteteve duke bërë përpjekje për shfrytëzim sa më racional të të gjitha resurseve të brendshme dhe të jashtme në shkollat tona.

Në raport janë përfshirë: rrjeti shkollor, lokali mësimor, nxënësit dhe paralelet, organizimi i mësimi, suksesi i nxënësve, mungesat e nxënësve, orët e mbajtura, aktivitetet jashtëkurrikulare etj. Pra, janë përfshirë të gjitha segmentet e punës dhe jetës në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Ferizajt.

Materialet bazë për hartimin e raportit:

- Plani vjetor i punës së DA-it për vitin 2023;
- Raporti vjetor i punës së Sektorëve të Arsimit pranë DA-it për vitin 2023;
- Programet vjetore dhe periodike të punës së njërive pranë DA-së;
- Njësia e Administratës;
- Njësia e Financave;
- Njësia e Shërbimeve Teknike;
- Kalendari për vitin shkollor 2023-2024 me Udhëzimin Administrativ nr.05/2022;
- Raportet tekstuale dhe tabelare të shkollave fillore dhe të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë;
- Raportet e organizimit të seminareve me mësimdhënës për zbatimin e KK-së dhe KB për nivelet e arsimit (0,1,2,3);
- UA nr.151/2020 për përzgjedhjen dhe emërimin e drejtorëve dhe zv. drejtorëve;
- Informatat rreth organizimit të Provimit të Maturës;
- Bashkëpunimi i zyrtarëve komunal të arsimit DA-së me SIA-në, dhe organe tjera relevante.

Drejtoria e Arsimit dhe stafi i saj në bashkëpunim me MASHT-in, drejtoritë e shkollave dhe organet tjera relevante janë angazhuar në krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për punë në shkollat e komunës sonë. Planifikimi me kohë ka mundësuar një fillim të mbarë të procesit edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit në përfundim të vitit shkollor, në të gjitha shkollat e komunës sonë, fillon punët në lidhje me përgatitjet e përgjithshme e të nevojshme për vitin e ri shkollor.

Drejtorët e shkollave me kohë kanë marrë udhëzimet e nevojshme për fillimin e punëve në lidhje me përgatitjet të cilat duhet të bëhen sipas dinamikës së paraparë nga Drejtoria e Arsimit.

Përgatitjet janë kryer sipas punëve me prioritet:

- Në përfundim të vitit shkollor, ka filluar me përgatitjet e objekteve shkollore si renovime, lysterje, gëlqerosje, dezinfektim dhe dezinfektim etj;
- Për të siguruar kuadrin e nevojshëm, Njësia Administrative pranë Drejtorisë sonë, me kohë ka bërë përgatitjen dhe shpalljen e konkurseve;
- Me kohë është bërë edhe planifikimi për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore të cilat gratis i ka siguruar MASHT-i, për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët. Për ndryshim nga vitet e kaluara, këtë vit, furnizimi me libra për nxënës është bërë përmes rimbursimit, me ç'rast prindërit, pas pranimit të mjeteve, kanë bërë blerjen e librave për fëmijët e tyre;
- Nga Drejtoria e Arsimit është bërë planifikimi për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse dhe material tjetër të nevojshëm shpenzues;
- Gjithashtu me kohë shkollat janë pajisur me dokumentacion pedagogjik si libra amë, ditar të punës, fletore të punës për mësimdhënës, material shkollor e gjëra të tjera të nevojshme;
- Drejtoria e Arsimit, përmes Aktivit të Drejtorëve të shkollave, kujdes të veçantë i ka kushtuar përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin edukativo-mësimor. Një kujdes të shtuar kemi pasur për nxënësit me nevoja të veçanta. Këtë kategori të nxënësve e kemi përfshirë në gjitha nivelet e arsimit, kurse një numër i tyre (për shkak të nevojave më specifike) janë të përfshirë edhe në dy shkolla fillore në „Gjon Serreçi” dhe në „Ahmet Hoxha”;
- Drejtoria e Arsimit ka themeluar edhe Ekipin Komunal për Vlerësimin e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, Ekipin Komunal për Vlerësim të Brendshëm dhe Ekipin për Parandalim e Braktisjes dhe Mosregjistrim.
- Drejtoria e Arsimit ka planifikuar buxhetin për ndarjen e bursave për studentët e komunës sonë. Po ashtu për vitin akademik 2022-2023 ka ndarë bursa për të gjithë studentët që kanë aplikuar si dhe ju kanë vazhduar bursat studentëve vijues.

Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit edukativo- arsimor dhe në përgjithësi të punëve nëpër shkolla, Drejtoria e Arsimit, i ka kushtuar kujdes të duhur edhe:

- Planifikimit dhe regjistrimit të fëmijëve në klasat parafillore;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e parë;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, në shkollat e arsimit të mesëm të lartë;

Gjatë vitit shkollor 2022-2023, kemi vazhduar me zbatimin e KK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt në të gjitha nivelet e arsimit përveç shkollave profesionale që ende nuk kanë filluar në zbatimin e KK-së;

Drejtoria e Arsimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës, ka realizuar vizitat të rregullta dhe informative nëpër shkolla;

Sigurisë në shkolla i është kushtuar rëndësi e duhur, duke vazhduar me sigurimin fizik në disa shkolla, është forcuar bashkëpunimi me Policinë, me Këshillin e Prindërve dhe është shtuar kujdestaria e ditës nga nxënësit dhe mësimmshënësit;

Gjelbërimeve në oborret shkollore i është kushtuar rëndësi e duhur. Në këtë drejtim edhe janë shënuar rezultate. Në disa shkolla janë rregulluar parqet shkollore.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe organizimit të aktiviteteve jashtëkurrikulare, si organizimi i kuizeve nga lëndë të ndryshme të diturisë, garave kulturore, sportive etj.

RAPORTI I PUNËS PËR SEKTORIN ADMINISTRATIV TË DA-së

Spektori Administrativ në Drejtorinë e Arsimit gjatë periudhës për vitin 2022/2023 ka udhëhequr procedurat administrative dhe ligjore për pranimin e mësimmshënësve dhe punëtorëve tjerë në shkolla për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në kuadër të Komunës së Ferizajt.

Gjatë këtij viti shkollor kemi publikuar gjithsej 14 konkurse. Konkursët janë shpallur me kohë duke i respektuar afatet ligjore, janë shpallur edhe në faqen zyrtare të Komunës si dhe në tabelën e shpalljeve me sa vijon:

- Për punëtorë teknik (2 konkurse)
- Për sekretarë (3 konkurse)
- Për mësimdhënës (7 konkurse)
- Bursa për studentë (1 konkurs)
- Për asistente për FNV (1 konkurs)

Gjithsej 14 konkurse

Janë udhëhequr procedurat e njoftimit të kandidatëve, intervistimit, për pranimin e kandidatëve për plotësimin vendeve të punës, si në zëvendësime, plotësime etj; janë zhvilluar procedurat e pushimeve të lehonisë, pushimeve mjekësore, pushimeve pa pagesë dhe të punëtorëve të pensionuar gjatë kësaj periudhe.

Kemi shqyrtuar kërkesa, ankesa, kemi dhënë përgjigje me shkrim sipas shkresave të palëve. Kemi bërë kompletimin e lëndëve për zyrën ligjore sipas padive të palëve për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit, për rastet e punësimit.

NJËSIA E FINANCAVE

- Përgatitja për raportimin e borxheve për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunali, investime kapitale dhe subvencione.
- Përgatitja për raportimin e pasqyrave financiare për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunali, investime kapitale dhe subvencione.
- Përgatitja e planit të keshit për vitin 2023 në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunali, investime kapitale.
- Shpërndarja e mjeteve në kategoritë e pagave për arsimin fillor të mesëm, sipas shkollave dhe raportimi i tyre për Ministrinë e Financave.
- Shpërndarja e mjeteve përmes free-balancit për çdo shkollë veç e veç në arsimin fillor të mesëm dhe çerdhën e fëmijëve.
- Kemi bërë shpërndarjen e pagave sipas shkollave, pastaj i kemi futur në free-balanc pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, komunalit për vitin 2023.
- Kemi bërë përgatitjen e zotimeve për investime kapitale, përgatitjen e disponueshmërisë së mjeteve, kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit.

- Përgatitjen e raportit tremujor për kategorinë e pagave, mallrave dhe shërbimeve, komunalive.
- Rregullimin e retroaktivit për mësimdhënësit që nuk kanë hyrë me kohë në listën e pagave.
- Raporti i borxheve në të gjitha kategoritë ekonomike për Ministrinë e Financave sipas kërkesës së tyre.
- Përgatitja e të dhënave për rishikim të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike në muajin qershor.
- Përgatitja e të gjitha të dhënave për bursat për studentë dhe pagesat e tyre prej subvencioneve.
- Futja e të dhënave në BDMS në të gjitha kategoritë ekonomike për çdo shkollë veç e veç;
- Përgatitja e investimeve kapitale për ridestitim, sipas programeve të arsimit;
- Përgatitja e listave të pagave për zyrën e thesarit;
- Raportimin e mjeteve të sindikatës;
- Trajnimet e drejtorëve dhe stafit administrativ, sipas nevojave;
- Kemi kryer të gjitha punët që na lidhin me prokurimin, planin e prokurimit, kërkesat për prokurim;
- Bashkëpunimi dhe harmonizimi i punëve me drejtorët e shkollave;
- Raportin e faturave të papaguara për vitin kalendarik 2023;
- Pasqyrat financiare 2023;

NJËSIA E SHËRBIMEVE TEKNIKE

Drejtoria e Arsimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe infrastrukturës shkollore dhe duke parë që shkollat në Komunën e Ferizajt kanë nevojë për renovime dhe përkujdesje, gjatë vitit 2023, ka vazhduar me realizimin e projekteve siç janë në vijim:

- Vazhdimi i punimeve të ndërtimit të shkollës "Ahmet Hoxha" në Ferizaj;
- Vazhdimi i punimeve të shkollës në fshatin Talinoc i Muhaxherëve;
- Rregullimi i parkingut, trotuareve dhe shtigjeve për këmbësorë në:
- SHFMU "Ismail Qemaili" (AMË dhe PNF) në fshatin Prelez i Jerlive,
- SHFMU "4 Prilli" në Zllatar,
- SHFMU "Muharrem Shemsedini" në Fshatin e Vjetër,
- SHFMU "Dituria" në Dardani, "Ramadan Rexhepi" në Sojevë,
- SHFMU "Ali Hadri" në Mirash,
- SHFMU "Liman Rekaj" në Prelez të Muhaxherëve,
- SHFMU "Hajriz Muhadini" në Dremjak,
- SHFMU "Bilall Shala" në Koshare,
- SHFMU "Arsim Rexhepi" në Sazli
- Gjimnazi "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj,
- IAAP "Pjetër Bogdani" në Ferizaj,

- Përrurimi i shkollës “Naim Frashëri” në Zaskok,
- Riparimi i kulmit në SHFMU “Abetarja” PNF në Pojatë dhe në SHFMU “Afrim Abazi” në Sherret;
- Vazhdimi i punimeve në Çerdhën e Fëmijëve në rrugën “Rexhep Bislimi”;
- Ndërtimi i shkollës së mesme në Komunën e Ferizajt – (punimet janë duke vazhduar në këtë projekt);
- SHFMU "Jeronim De Rada" në Ferizaj, është bërë drenazhimi komplet i shkollës dhe renovimi i bodrumit;
- SHFMU “Muharrem Shemsedini” në Fshatin e Vjetër – vazhdimi i punimeve për ndërtimin e sallës sportive;
- Ndërtimi i shkollës së re fillore në Tërrn;
- Renovimi komplet i shkollës së vjetër në fshatin Varosh;
- Renovimi i të gjitha klasave në SHFMU “Dardania” në Rakaj;
- Renovimi i disa klasave në SHFMU “Enver Topalli” në Omuraj - Greme,
- Renovimi i disa klasave në SHFMU “Vezir Jashari” në Ferizaj;
- Renovimi komplet i SHFMU “Kemajl Hetemi” në Rahovicë;
- Në shkollën "Gjon Serreçi" në Ferizaj (instalimi i paneleve solare);
- Në shkollën "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj (instalimi i paneleve solare);
- Në SHFMU “Jeronim De Rada” në Ferizaj (instalimi i paneleve solare)
- Në IP “Ardhmëria Jonë” në Ferizaj (instalimi i paneleve solare).

SEKTORI I ARSIMIT

Në kuadër të sektorit të arsimit aktivitetin e tyre e zhvillojnë:

- Zyrtari për arsimin parafillor dhe fillor
- Zyrtari për arsimin e mesëm të ulët dhe
- Zyrtari për arsimin e mesëm të lartë.

Zyrtarët arsimor, i kanë kushtuar kujdes të duhur këtyre punëve:

- Kanë përcjellur dhe mbikëqyrur përgatitjet e gjithëmbarshme të shkollave në kuadër të procesit edukativo-arsimor, janë angazhuar që të bëhet përfshirja e nxënësve në shkollimin e rregullt, kemi kontribuar në ngritjen e bashkëpunimit të shkollës me prindër dhe komunitetin në përgjithësi;
- Takimet mujore të Task Focës, të mbajtura në QPS në Ferizaj;
- Është bashkëpunuar me Shoqatën e Biologëve, Matematicientëve, Fizicientëve dhe Kulturës Sportive në organizimin e garave në lëmitë përkatëse;
- Në muajin gusht kanë pranuar dhe shpërndarë tekstet shkollore në të gjitha shkollat e komunës sonë, si dhe kemi vazhduar edhe me pjesën tjetër të teksteve të ardhura më vonë nga shtëpitë

tjera botuese, nga kontaktet që kemi pasur me shkolla mund të konkludojmë se të gjitha shkollat janë furnizuar me libra;

- Është bërë Vlerësimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, përmes Ekipës Vlerësuese;
- Zyrtarët arsimor në kuadër të punëve dhe detyrave të tyre të punës për çdo gjysëmvjetor, janë marrë me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore për suksesin e nxënësve, vijueshmërinë, disiplinën etj;
- Zyrtarët arsimor gjatë vitit 2023 kanë bërë vizita në të gjitha shkollat, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës. Gjatë këtyre vizitave është përcjellur respektimi i orarit mësimor, realizimi i planprogrameve, notimi i nxënësve, kontrollimi i dokumentacionit administrativ, pedagogjik, stafit arsimor, teknik si dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Janë dhënë udhëzime lidhur me organizmin e mbajtjes të Testit Kombëtar për klasat e IX-ta dhe të Testit të Maturës për klasat e XII-ta;
- Zyrtarët arsimor kanë bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e testit, si dhe kanë marrë pjesë në mbarëvajtjen e Testit;
- Zyrtarët arsimor, kanë shqyrtuar konkurset e shpallura për pranimin e kuadrit arsimor, udhëheqës, teknik dhe punëtorë administrativ, kanë bërë vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve;
- Koordinimi dhe përcjellja e të gjitha trajnimeve që realizohen në Qendrën për Ngritjen Profesionale (QNP) në shkollën “Tefik Çanga”, për të gjitha nivelet (0,1,2,3);
- Është hartuar plani i përcjelljes së trajnimeve për zbatim të KK dhe KB (Kurrikulës dhe Kurrikulës Bërthamë);
- Janë hartuar raporte mujore me shkrim lidhur me zbatimin e KKK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt, raportet janë dërguar në MASHTI-n;

Po ashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit arsimor në shkolla përmes zhvillimit profesional, DA në bashkëpunim me MASHTI-n dhe organizata të akredituara ka organizuar trajnime, seminare e punëtori.

DA në bashkëpunim me Caritas Zviceran përmes projektit “TAKE” ka furnizuar me inventarë 5 (pesë) klasë parafillore, ndërsa me projektin “Yeni”, 5 (pesë) shkolla kanë përfituar projekte në fushën e ambientit ekologjik në vlerë 5,000.00 euro.

Me CARITAS zviceran, kemi nënshkruar edhe një marrëveshje bashkëpunimi tre vjeçare që ka të bëjë edhe me projekte të radhës në vitet në vazhdim.

Trajnimet e mësimdhënësve

Trajnimi i stafit arsimor për zbatimin e Kurrikulës i paraparë gjatë muajit korrik 2023, nuk është realizuar këtë vit nga MASHTI edhe pse ka pasur mësimdhënës të interesuar.

RAPORT MBI ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS - 2023

Arsimi gjithëpërfshirës është një dimension i arsimit cilësor bazuar në të drejtat që thekson barazi në qasje dhe pjesëmarrje, dhe i përgjigjet pozitivisht nevojave individuale për nxënie dhe kompetencave të të gjithë fëmijëve.

Arsimi gjithëpërfshirës ka në qendër fëmijën dhe vendos përgjegjësinë e adaptimit të sistemit arsimor në bazë të nevojave të fëmijës. Së bashku me sektorë të tjerë dhe me komunitet më të gjerë, arsimi gjithëpërfshirës funksionon në mënyrë aktive për t'i siguruar çdo fëmijë, pavarësisht gjinisë, gjuhës, aftësisë, fesë, kombësisë ose karakteristikave të tjera, mbështetje për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote, të mësojë së bashku me shokët dhe shoqet e tij/saj, si dhe të zhvillojë potencialin e tij/saj të plotë. Arsimi gjithëpërfshirës keqkuptohet si koncept që aplikohet vetëm tek fëmijët me nevoja të veçanta, dhe ky fakt pikërisht na vendos pengesa në arritjen e arsimit gjithëpërfshirës.

Në Kosovë, koncepti i edukimit gjithëpërfshirës, është kuptuar në formën më të kufizuar të tij, duke ngecur te sigurimi i qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jo si sigurimi i kushteve për pjesëmarrje të plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor/mësimdhënës.

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me shkollat ka bërë mbledhjen e të dhënave mbi numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe për vitin 2024 vazhdimin e mbajtjes me informata të databazës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në nivelin komunal.

Në SHFMU “Ahmet Hoxha” funksionon me sukses Qendra për mësim shtesë, ku punohet me nxënësit që kanë ngecje në procesin mësimor e sidomos në shkrim-lexim. Po ashtu kjo qendër punon edhe me grupe të marginalizuara si komunitetet jo shumicë.

Projekte të realizuara me Save the Children

Në kuadër të programit “Arsimi Gjithëpërfshirës”, SCiK ka organizuar trajnimin e akredituar nga MASHTI me temën “Mbështetja psikosociale dhe të mësuarit socio-emocional” ku 67 mësimdhënës nga shkollat e Ferizajt do të certifikohen për vijimin e trajnimit.

Janë organizuar trajnime për KNF dhe përdorimi i instrumenteve për vlerësimin pedagogjik të nxënësve me nevoja të veçanta me mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Në Komunën e Ferizajt, gjithsej 52 mësimdhënës do të certifikohen për vijimin e trajnimit.

Gjatë këtij viti po në kuadër të të njëjtit program, SCiK ka organizuar sesione me shkolla për “Udhëzuesin mbi praktikat më të mira për arsimin gjithëpërfshirës”. Afërsisht 40 pjesëmarrës janë

informuar mbi Udhëzuesin, në mesin e tyre drejtorë të shkollave, mësimdhënës dhe koordinator cilësie.

Në shkollat (“Besim Rexhepi”, “Kostandin Kristoforidhi”, “Naim Frashëri”, “IP Ardhmëria jonë”) ku SCiK ka themeluar qendrat “Kujdesi dhe zhvillimi në fëmijërinë e hershme” ku janë mbajtur sesione informuese për prindër nga ekspertë të fushave të ndryshme, është inaguruar edhe qendra më e re në SHFMU “Ali Hadri” në Mirash.

Zhvillimi i procesit mësimor

Viti i ri shkollor ka filluar me 1 shtator. Shkollat me kohë kanë bërë të gjitha përgatitjet në aspektin teknik dhe kompletimin e dokumantacionit pedagogjik. Të gjitha shkollat janë pajisur me mjete higjienike, është bërë me kohë dezinfektimi dhe dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore si dhe është bërë vlerësimi higjienik edhe nga Inspektoriati Sanitar. Gjetjet e tyre kanë konstatuar se shkollat plotësojnë kushtet teknike për fillimin e vitit të ri shkollor.

Sfidë për DA-në gjatë këtij viti shkollor ishte dhe mbetet edhe më tutje zhvillimi i procesit mësimor në tri ndërrime në dy shkolla të Komunës së Ferizajt. Në SHFMU “Gjon Serreqi” për mungesë të hapësirës së pamjaftueshme dhe “Dy Dëshmorët” në Talinoc. Në Talinoc punimet janë në përfundim e sipër.

NJËSIA E ARSIMIT PARAFILLOR

Në komunën tonë funksionojë dy çerdhe të fëmijëve, IP “Ardhmëria Jonë”, si çerdhe publike, dhe Çerdhja “Engjujt” në partneritet publiko-privat.

Viti shkollor 2023-2024

Në institucionet parashkollore janë regjistruar:

Grup mosha	Numri i grupeve	Gjithsej numri i fëmijëve		
		M	F	Gj
06 muaj – 2 vjeç	3	20	18	38
1 vjeç – 2 vjeç	0	0	0	0
2 vjeç – 3 vjeç	5	49	52	101
3 vjeç – 4 vjeç	4	49	49	98
4 vjeç – 5 vjeç	5	53	71	124
5 vjeç – 6 vjeç	5	58	55	113
Gjithsej	22	229	245	474

Numri i fëmijëve të regjistruar në klasat parafillore
Viti shkollor 2023 – 2024

Numri i fëmijëve në klasat parafillore	M	F	GJ
	682	696	1378

Numri i nxënësve të regjistruar klasa I - V
Viti shkollor 2023 – 2024

Numri i nxënësve klasa I - V	M	F	GJ
	4122	3979	8101

Numri i nxënësve të regjistruar klasa VI - IX
Viti shkollor 2023 – 2024

Numri i nxënësve klasa I - IX	M	F	GJ
	3271	3216	6476

Numri i nxënësve të regjistruar klasa 10 - 12
Viti shkollor 2023 – 2024

Numri i nxënësve klasa X – XII	M	F	GJ
	2521	2663	5184

Numri i përgjithshëm i nxënësve I – XII
Vitin shkollor 2023 – 2024

Numri i nxënësve klasa 1 – 12	M	F	GJ
	9914	9958	19772

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë Klasa IX-të
Viti shkollor 2022 – 2023

Nr	Shkolla	Kodi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve që kanë hyrë në test	Totali		
					Pikët e arritura	%	Maksimumi i pikëve të arritura
1	"Gjon Serreçi"	1	9	208	21296	51.19	41600
2	"Jeronim de Rada"	2	6	150	15442	51.47	30000
3	"Tefik Çanga"	3	5	131	13996	53.42	26200
4	"Ahmet Hoxha"	4	5	96	8420	43.85	19200
5	"Ganimete Tërbeshi"	5	4	64	6258	48.89	12800
6	"Vezir Jashari"	6	3	63	6201	49.21	12600
7	"Bilall Shala"	7	2	22	1762	40.05	4400
8	"Jeta e Re"	8	2	32	2745	42.89	6400
9	"Kostandin Kristoforidhi"	9	2	24	2004	41.75	4800
10	"Naim Frashëri"	10	3	45	3164	35.16	9000
11	"Dituria"	11	2	39	3297	42.27	7800
12	"Besim Rexhepi"	12	3	49	4874	49.73	9800
13	"Imri Halili"	13	2	40	3396	42.45	8000
14	"Abetarja"	14	1	24	1802	37.54	4800
15	"Muharrem Shemsedini"	15	2	44	4084	46.41	8800
16	"Visar Dodani"	16	2	33	3011	45.62	6600
17	"Deshmorët e Kosharës"	17	2	26	2306	44.35	5200
18	"Ismail Qemajli"	18	1	23	2089	45.41	4600
19	"Liman Rekaj"	19	2	26	2139	41.13	5200
20	"Ramadan Rexhepi"	20	1	22	2100	47.73	4400
21	"Ali Hadri"	21	1	18	1663	46.19	3600
22	"Skënderbeu"	22	1	7	467	33.36	1400
23	"Halit Ibishi"	23	1	22	1969	44.75	4400
24	"Dardania"	24	1	15	1353	45.10	3000
25	"Mic Sokoli"	25	1	16	1220	38.13	3200
26	"Tërrn"	26	1	35	3162	45.17	7000
27	"Pesë Dëshmorët UÇK-së"	27	1	12	894	37.25	2400
28	"Dëshmorët e Lirisë"	28	1	29	2161	37.26	5800
29	"Kemajl Hetemi"	29	1	9	828	46.00	1800
30	"Dy Dëshmorët"	30	2	24	2014	41.96	4800
31	"Mejdi Xhaferi"	31	2	39	3158	40.49	7800
32	"Pavarësia"	32	1	14	1456	52.00	2800
33	"Astrit Bytyçi"	33	3	44	4249	48.28	8800
34	"4 Prilli"	34	1	11	915	41.59	2200
35	"Hajriz Muhadini"	35	1	21	1439	34.26	4200
36	"Afrim Abazi"	36	1	26	2332	44.85	5200
37	"Rizah Matoshi"	37	1	23	2105	45.76	4600
38	"Enver Topalli"	38	1	27	2430	45.00	5400
39	"Arsim Rexhepi"	39	1	16	1678	52.44	3200
40	"Aga Xhite"	40	1	13	1472	56.62	2600
G j i t h s e j			83	1582	147351	46.57	316400

Krahasuar me vitin e kaluar, vitin 2021-2022, suksesi është më i dobët 0.02 %

PROVIMI I MATURËS – Afati i Qershorit
Viti shkollor 2022-2023

Shkollat	Nr.i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
"K.Arbërit"	473	415	87.73	58	12.26
"F.Konica"	282	81	28.72	201	71.27
"P.Bogdani"	61	37	60.65	24	39.34
"Z.Hajdini"	76	27	35.52	49	64.47
"E.Gjika"	306	253	82.67	53	17.32
"Çesk Zadeja"	41	29	70.73	12	29.26
"Dr.Sh.Hashani"	291	150	51.54	141	48.45
"Kompetencës"	148	128	86.48	20	13.51
"Aga Xhite"	18	16	88.88	2	11.11
G j i t h s e j	1696	1136	66.98	560	33.01

Krahasuar me vitin e kaluar 2021-2022, në këtë vit shkollor, suksesi është më i dobët për 10.8 %

PROVIMI I MATURËS – Afati i Gushtit
Viti shkollor 2022-2023

Shkollat	Nr.i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
"K.Arbërit"	50	32	64	18	36
"F.Konica"	131	56	42.74	75	57.25
"P.Bogdani"	13	5	38.46	8	61.53
"Z.Hajdini"	18	4	22.22	14	77.77
"E.Gjika"	53	43	81.13	10	18.86
"Çesk Zadeja"	13	3	23.07	10	76.92
"Dr.Sh.Hashani"	149	88	59.06	61	40.93
"Qendra e Kompetencës"	18	11	61.11	7	38.88
"Aga Xhite"	2	1	50.00	1	50.00
G j i t h s e j	447	243	54.36	204	45.63

Krahasuar me vitin e kaluar 2021-2022, në këtë vit shkollor, suksesi është më i dobët për 5.84 %.

Përfundim

Përkundër sfidave dhe peripecive të shfaqura në shumë dimensione që është duke u ballafaquar arsimi në Republikën e Kosovës, ku ende nuk po mund të arrijmë një standard të dëshiruar që garanton zhvillim, përparim dhe stabilitet të qëndrueshëm, Drejtoria e Arsimit, pas vlerësimit dhe analizës së përgjithshme mbi rezultatet e arritura nga nxënësit në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2022/2023, si dhe zhvillimeve të përgjithshme të ecurisë së procesit edukativo-arsimor, konstatojmë se në këtë vit shkollor ka zhvillime dhe përmirësime të kënaqshme të rezultateve dhe suksesit të nxënësve në komunën e tonë.

Kjo është si rezultat i masave dhe veprimeve konkrete të ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit, në shumë dimensione në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim.

Drejtoria e Arsimit po punon në vazhdimësi me të gjithë kapacitetin maksimal, duke bashkëpunuar edhe me institucionet relevante përgjegjëse të arsimit, që në komunën tonë të ndërtohet një infrastrukturë shkollore e nivelit bashkëkohor, duke krijuar kushte optimale që në shkollat tona, të ngritet cilësia në mësimdhënie dhe mësimnxënie.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Xhemile Murati Shabani
Drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Hyrje

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të Komunës së Ferizajt, me detyra, funksione dhe përgjegjësi institucionale, duke ushtruar punë menaxhuese, krijuese e organizative në këto fusha: kulturë, rini, sport, biblioteka dhe në atë të arkivit. Në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, funksionojnë këta sektorë dhe njësi: Sektori i Kulturës, Teatri i qytetit, Galeria e Arteve, Muzeu i Qytetit, Sektori i Rinisë, Sektori i Bibliotekave, Sektori i Sportit, Arkivi Historik.

Kjo Drejtori ka nën menaxhim disa objekte ku zhvillon punën dhe aktivitetet e saj.

Këto janë: Teatri i Qytetit /Galeria/Muzeu, Palestra e Sporteve, Stadiumi i Qytetit, fusha sportive në fshatin Tërrn, Biblioteka e Qytetit, Biblioteka në fshatin Neredime, Biblioteka në fshatin Talinoc i Muhaxherëve, Biblioteka në fshatin Komogllavë, Biblioteka në fshatin Dardani, Arkivi Historik.

Përveç këtyre objekteve, aktivitetet zhvillohen edhe në hapësira tjera publike si: Bulevardi i Qytetit, Sheshi i Qytetit, Skena Verore e Teatrit, etj.

Projektet kryesore

- Shënuam gjithë vitin me aktivitete të ndryshme kulturore, rinore e sportive në jubileun e 150 vjetorit të themelimit të qytetit.
- Ferizaj komunë binjake me Cedar Falls, IOWA- ShBA, në fushën e kulturës, sportit, trashëgimisë kulturore.
- Të rinjtë ferizajas pjesë e lojërave paraolimpike në Gravelines të Francës.
- Implementimi i projektit “Komuna për të Rinjtë”.
- Përfunduar rregullimin e fushave sportive në Koshare, Varosh, Gaçkë, Komogllavë, Pleshinë.
- Përfunduar sallat e sportit në Greme dhe Balaj.
- Renovimin e jashtëm të Palestrës së Sporteve “Bill Clinton” si rrjedhojë e bashkëfinancimit me programin për efikasitet të energjisë.
- Funksionalizuar Qendrën Rinore dhe Kinemanë e Qytetit.
- Festivali i Teatrove në Ferizaj dhe Festivali “Kosovarja Këndon” u shpallën nga MKRS – vlerë e Trashëgimisë Kulturore – Kategoria e Trashëgimisë Shpirtërore.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj, bazuar në rregulloren e MF-së, publikon thirrjen publike, ku fton të gjitha organizatat me karakter kulturor, sportive e rinor që të aplikojnë në këtë thirrje, si mundësi për financim të projekteve kulturore, sportive e rinore.

Në vitin 2023 janë përkrahur me subvencione 72 OJQ, kryesisht shoqata kulturore, klube sportive dhe organizata rinore. Gjithashtu janë përkrahur artistë, të rinj e sportistë të pavarur.

Në vazhdim po japim raportin e punës nga secili sektor veç e veç, ku janë të përfshira aktivitetet kryesore.

SEKTORI I KULTURËS

Sektori i Kulturës është një nga dikasterët që funksionojnë në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Ferizaj. Ky sektor organizon aktivitetet kulturore të përbashkëta e të ndara, me grupet kulturore e komunitetin artistik. Këto aktivitete shtrihen gjatë punës njëvjeçare duke iu përmbajtur planit të punës të përpiluar në fillimvit e në të shumtën e rasteve duke tejkaluar këtë plan me aktivitete shtesë.

Në vazhdim shohim aktivitetet dhe ngjarjet kulturore, të mbajtura sipas rrjedhës kalendarike:

Fillimiviti zakonisht është periudhë ku bëhen rishikimet, analizat, raportet e planet e punës, takime punuese dhe ndarjeve të detyrave sipas llojit të aktivitetit. Por gjithësesi nuk mungojnë edhe aktivitetet e kohëpaskohshme.

Promovimi i librit “*Testament shpirti*” të autorit Ramadan Emini - Libri u promovua pas vdekjes së autorit e organizuar nga Klubi Letrar “De Rada”. Ramadan Emini ishte poet, shkrimtar, intelektual e veprimtar i çështjes kombëtare.

Ekspozitë kolektive - koloni e artistëve të rinj- Ekspozitë e organizuar nga SHAF “Zef Kolombi” & Galeria e Arteve Ferizaj.

Manifestim nacional kulturor- Dita e Pavarësisë së Kosovës - Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i kushton një rëndësi këtij manifestimi nacional kulturor, ku përgaditet një agjendë me aktivitete kulturore e sportive:

Ligjeratë nga Njësia për Trashëgimi dhe Muze - Kjo ligjeratë ishte me temën “*Kosova, rrugëtimi drejt Pavarësisë*” me nxënës të shkollave të mesme të Ferizajt, ku ligjeruan profesorë të historisë.

Promovimi i librit “1981-vidhe këtë libër” i autorit Agron Shala - Libri u promovua në Galerinë e Arteve nga Klubi Letrar “De Rada”. Promovimi u mbajt në kuadër të aktiviteteve për nder të 15 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.

Performancë artistike nga nxënësit e gjimnazit “Kuvendi i Arbërit”- Kjo performancë artistike u realizua në Teatër, nga artisti Heset Maliqi - Quza.

Akademi Solemne dhe Koncert Festiv - Kjo ngjarje kushtuar 15 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, përveç pjesës foljore, interpretuan edhe këngëtarët e estradës sonë: Liridon Sadriu, Selami Kolonja dhe Teuta Kurti. Manifestimi u mbajt në Teatrin “Adriana”, në një atmosferë festive.

Ekspozita e Pavarësisë - Ekspozitë kolektive tradicionale e quajtur ekspozita e Pavarësisë ku ndahet edhe çmimi special në emër të artistit dëshmor *"Gursel Sylejmani"*. Fituese e këtij çmimi ishte piktorja Laureta Vogliqi. Kjo ekspozitë është një prej ekspozitave më profesionale që mbahet nëpër galeritë e Kosovës, dhe ato në rajon.

Mbrëmje filmi - Në bashkëpunim me Qendrën Kinematografike të Kosovës, u shfaqën dy filma artistik; filmi *“Shok”* i regjisorit Jamie Donoughue dhe filmi *“Nëntor i ftohtë”* në regji të Ismet Sijarinës. Filmat u shfaqën në vigjilje të përvjetorit të Pavarësisë.

Koloni artistike dhe ekspozitë nga gratë piktores - Për nder të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, u organizua Koloni Artistike nga Galeria e Arteve & SHAF “Zef Kolombi”, mbështetur nga DKRS.

Debat me temën: “Kosovarja Këndon dhe rrugëtimi i nesërm”- Ky debat u organizua në vigjilje të 8 Marsit - Festës së Gruas, si një tryezë diskutimi lidhur me riprofilizimin e Festivalit “Kosovarja Këndon”, sidomos pas shënimit të 50 vjetorit të themelimit. Në diskutim morën pjesë profesorë, muzicientë dhe ekspertë të ndryshëm të fushës së muzikës dhe kulturës. Debatu u regjistrua si video dhe audio material, për t’u nxjerrur pastaj konkluzionet në një platformë të veçantë. Në fund të kësaj tryeze, grupi i grave artiste që kishin organizuar koloninë artistike, dhuruan nga një punim pikturë mysafireve gra pjesëmarrëse në këtë tryezë.

Shoqata “Miq të familjes Biden” Kuvend festiv - Kjo organizatë zgjodhi kuvendin e punës me seli në fshatin Mirosalë. Pas kësaj u inaugurua parku *“Natalie Naomi & Robert Hunter”*. Kjo shoqatë është bartëse e shumë aktiviteteve kulturore, sidomos në bashkëpunim me KFOR-in amerikan dhe festat e përbashkëta me popullin amerikan.

Festivali Ndërkombëtar i Filmit FerFilm

Festivali Ndërkombëtar i Filmit “FerFILM”, edicioni 11-të, u realizua më 2 – 6 maj 2023, në sallën e Teatrit “Adriana”- Ferizaj.

Dita e Muzeve- Njësia për Trashëgimi e Muze - Ligjëratë me temën *“Rëndësia dhe ruajtja e thesarit trashëgimor të Ferizajt”* ku të interesuarit u njoftuan me vlerat e trashëgimisë kulturore.

Gala Koncert me rastin e 50 vjetorit të grupit ikonik "TRIX" - Koncerti u organizua nga Trupa Artistika Regjionale TAR, në kuadër të 150 vjetorit të themelimit të qytetit dhe në nderim të 50 vjetorit të rock grupit TRIX- Veli Sahiti.

Ditët e Kulturës - Ditët e Kulturës janë zgjeruar me aktivitete të shumta në kuadër të 150 vjetorit të themelimit të Ferizajt:

1 qershor - Dita e Fëmijëve – Sheshi i qytetit u mbush me shumë aktivitete kushtuar fëmijëve. Manifestimi u hap me një prezantim në murin e objektit të Komunës me dizajne e rekuizita artistike për fëmijë. Pastaj sheshi u mbush me aktivitete kreative për fëmijë, si nga: Policia e Kosovës në Ferizaj, QKMF, FSK, Handikos, klubet kulturore e sportive, si dhe grupe me maskota që argëtuan fëmijët.

Mbrëmje baleti - Shkolla e baletit për fëmijë “Mjellmat” – program për fëmijë.

Festivali i këngës për fëmijë "Fëmijët e Gëzuar", edicioni i 35-të - Në Teatrin “Adriana” është mbajtur Festivali i Këngës për Fëmijë “Fëmijët e Gëzuar 2023”. Pjesëmarrës ishin fëmijë nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Presheva dhe Shqipëria. Vendin në kategorinë e parë e fitoi Elena Sadriu.

Koncert Kori i Filharmonisë së Kosovës - Në sallën e shkollës së mesme të agrobiznesit në Ferizaj, në hollin e kësaj shkolle u mbajt një koncert vokal nga Kori i Filharmonisë së Kosovës.

Premiera e shfaqjes “Gënjeshtari” - Teksti: Carlo Goldon, regjia Ilir Bokshi, trupa e Teatrit “Adriana”, shfaqje e cila vazhdon të jetë në repertor ende.

“Sofra Tradicionale” - koncert nga AKV “Kastriotët” - Ky aktivitet tradicional me melos popullor, organizohet çdo vit nga AKV “Kastriotët” (grupi i folklorit) në kuadër të manifestimit “Ditët e Kulturës”, dhe në jubileun e 150 vjetorit të qytetit. U kënduan këngë folklorike dhe u interpretuan anekdota popullore.

Promovim i krijimtarisë letrare Tahire Berisha Abazi - Promovimi u bë në Galerinë së Arteve, ndërsa librat që u promovuan ishin: “*Dimension Trëndafili*” “*Grerëza Api dhe bleta Fila*” dhe “*Shkolla në xhungël*”.

“Kësulkuqja” – shfaqja për fëmijë - Shfaqje për fëmijë që e pati premierën në fund të vitit të kaluar, po vazhdon të shfaqet kohë pas kohe në Ferizaj dhe rrethinë. Kësaj here ishte pjesë në “Ditët e Kulturës”.

Koncert dhe performancë artistike e shkollave të mesme - Performancë e përgatitur nga artisti ferizajas, Heset Maliqi – Quza. Aktiviteti ndërliqej me historikun e qytetit dhe kishte karakter festiv dhe jubilar.

Konferencë shkencore me temën: "Ferizaj në rrjedhat e historisë" - Në këtë konferencë tre ditore morën pjesë profesorë të historisë nga Shqipëria e Kosova, në kuadër të jubileut të 150-të të qytetit.

Ekspozitë retrospektive: "Artistët ferizajas të shekullit XX-të" - Ekspozitë me veprave të artistëve ferizajas të shekullit të XX-të, që nga gjurmët e para e deri në vitin 1999. U ndanë mirënjohje për të pranishmit dhe mirënjohje post-mortem.

Festivali "Piano Fest" edicioni i IV-të - Festivali i pianos "*Piano Fest Ferizaj*" organizohet nga profesoresha e muzikës Ylberina Isufi. Në këtë edicion morën pjesë fëmijë nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut.

Ndarja e dekoratave për Dëshmorët e Kombit - Në sallën e Galerisë së Arteve u organizua ndarja e dekoratave për familjet e dëshmorëve të kombit, në jubileun e 150 vjetorit të qytetit të Ferizajt. Ndarjen e bëri Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu. Edhe në fundvit, Kryetari i Komunës, ndau dekoratën "Nderi i qytetit" për personalitete të shquara e familje themeltare e kontributdhënëse të Ferizajt.

Gala Koncert – Dita e Çlirimit të Ferizajt - Në një atmosferë festive, në Palestrën e Sporteve "Bill Clinton" (e improvizuar si sallë koncerti) u dha një koncert madhështor me emra të njohur të estradës kosovare shqiptare. Në përcjellje ishte Orkestra Simfonike e Shkodrës dhe ajo e Tiranës, e drejtuar nga dirigjenti Jetmir Barbullushi, dhe Lirjona Sylejmani. Në skenë interpretuan emra të njohur si: Myfarete Laze, Kastriot Tusha, Selami Kolonja, Lorjan Ejlli, Liridon Sadriu, Egzona Salaj, Blerta Cina, Mehmet Zuka, Rrezarta Ramadani, Anesa Bunjaku, Blerim Grubi e të tjerë, gjersa e veçanta e mbrëmjes ishte prezantimi, premiera e Këngës Emblematike të qytetit – Himnit të Qytetit me tekstshkrues e kompozitor prof. Astrit Mustafa, orkestruar nga maestro Jetmir Barbullushi, shoqëruar nga kori i shkollës "Gjon Serreçi", të përgatitur nga prof. Albulena Nuredini.

Festivali MuralFest Kosova – Ceremonia e hapjes - Mural Fest filloi edicioni i VIII-të me një koncert festiv me këngëtarin e njohur Edona Reshitaj. Këtë vit motoja e festivalit ishte "*Fragments of Utopia*". Ekipi i festivalit, me artistët vendor e ndërkombëtarë, si dhe grupin e artistëve, punuan skica e murale, si dhe organizuan edhe disa punëtori lidhur me moton. Festivali i Muraleve - MuralFest Kosova, tani ka kaluar datat e një festivali, duke punuar mural gati gjatë gjithë vitit, dhe jo vetëm në Ferizaj por edhe në qendra të tjera të Kosovës. Deri më tani Mural Fest ka realizuar mbi 100 murale në Ferizaj.

Sheki & band - Koncert në Ferizaj - Në sheshin "Ismail Kadare" u mbajt jazz koncert me rokerin e njohur ferizajas e më gjerë Shefqet Hoxha - Sheki

Mbrëmje poetike nga "Hardh Fest" në Ferizaj - Nën organizim të Klubit Letrar "De Rada", në Galerinë e Arteve në Ferizaj u përurua vëllimi poetik "*Angelus Novus*" i poetit Xhevdet Bajraj, dorëshkrimi i fundit që ka lënë para se të kalonte në amshim.

Festivali AMOL – Edicioni i 6-të - Në sallën e Teatrit "Adriana" u mbajt festivali i këngës për fëmijë A –MOL, nën organizim të profesoreshë Anduena Tahiri. Ky festival mbahet çdo vit, ndërsa viteve të fundit ka marr karakter ndërkombëtar.

Manifestim “62 - vjetori i themelimit të Shkollës Normale në Ferizaj” -Ky aktivitet u organizua në hollin e Shkollës së Bujqësisë “Zenel Hajdini” - Ferizaj nga Klubi i Intelektualëve të Ferizajt dhe Sektori i Kulturës. Në tubim morën fjalën ish nxënës e ish profesorë të kësaj shkolle, që me nostalgji kujtuan atë kohë. Në prapavijë u shfaqën fotografi si dhe u hap një ekspozitë me fotografi. Interpretuan grupi i mandolinistëve “Nostalgjikët” dhe këngëtarje e re Daorsa Sopa.

4 Korriku - Dita e Pavarësisë së SHBA-ve - Nën organizim të shoqatës “Miq të familjes Biden”, në përkrahje nga Drejtoria e Kulturës, në fshatin Mirosalë u organizua një program kulturo-artistik. Veç pjesës foljore, u dha një koncert festiv nga AKV “Kastriotët”, grupi i folklorit. Poashtu u demonstruan disa lojëra tradicionale, lojë në basketboll, si dhe një koktej rasti. Prezent ishin KFOR-i amerikan dhe përfaqësues nga institucionet kulturore të Ferizajt.

DITËT E MËRGATËS

11 Korrik - 6 gusht - Manifestimi “*Ditët e Mërgatës*” organizohet çdo vit nga Drejtoria e Kulturës, ku përmbledh një kalendar të aktiviteteve kulturore e sportive në mikpritje të mërgimtarëve tanë. Këtë vit kjo ngjarje u realizua për një periudhë më të gjatë dhe me aktivitete më të veçanta në kuadër të 150 vjetorit të themelimit të Ferizajt.

Festivali multikulturor “PlayFest” - Tash e disa vite organizohet në muajin korrik, duke sjellë aktivitete të larmishme kulturore. Manifestimi u hap me një program për fëmijë tek “*Parku i Lirisë*”- Ferizaj. Programi ishte i larmishëm me muzikë nga fëmijët, këndim, vallëzim, akrobatikë, pikturime etj. Festivali Playfest vazhdoi për gjashtë netë radhazi, duke sjellë çdo natë muzikë alternative, rock, blues, jazz, elektronik etj, me emra të ndryshëm të estradës sonë.

Promovimi i krijimtarisë krijuese të gazetarit Rexhep Rifati - Në Galerinë e Arteve u bë promovimi i krijimtarisë publicistike e gazetareske të intelektualit Rexhep Rifati.

14 Korrik- Promovim i albumit "ZANI" nga Mentor Haziri dhe KELI'S BAND - Koncerti u mbajt në sheshin e qytetit, ku mblodhi artdashës e dashmirë të rock-ut.

Krijime të shëndetshme dhe njohje me trashëgiminë kulturore - Aktivitet disa ditor i piktores Pranvera Sylejmani, e cila mbajti një punëtori me fëmijët me sindromën down. Projektin e përmbylli me një ekspozitë të pikturave, të cilat punime ishin punuar nga vet fëmijët e kësaj kategorie.

Rock koncert nga grupet “By stand” dhe “7 me 7” - Ky koncert u mbajt në sheshin e qytetit të Ferizajt. Koncerti u mirëprit nga shumë dashamirë të rock muzikës.

U promovua libri publicistik “Anketa Intelektuale” autor Isak Guta - Promovimi u organizua nga Sektori i Kulturës në bashkëpunim me Shoqatën e ish të Burogosurve Politik në Ferizaj, dhe ishte pa praninë e autorit, pasi që mungonte për shkaqe shëndetësore. Libri i kushtohet veprimtarisë së simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçi.

Koloni Artistike njëditore "Ditët e Mërgatës 2023" - Galeria e Arteve dhe Shaf "Zef Kolombi" organizuan një koloni artistike me pjesëmarrës artistët e nga SHAF "Zef Kolombi", SHK "HiTHi" dhe Njësi i KFOR-it Amerikan LMT, në shenjë mikpritjeje për bashkatdhetarët tanë.

Muzeu i Qytetit-Ferizaj ekspozitë vizuale me karakter historik - Ditëve të Mërgatës, po ashtu ju kushtohet edhe Njësia për Trashëgimi e Muze, me një ekspozitë vizuale ku prezantohen eksponatet e Muzeut dhe trashëgimia jonë kulturore. Ekspozita zgjoi interesim të madh, sidomos tek mërgimtarët. Ekspozita u mbajt 10 ditë radhazi para Bulevardit të Qytetit (oborri i Bibliotekës).

Koncert "Kastriotët" (grupi i folklorit) koncert në shesh - Ky aktivitet u organizua nga AKV "Kastriotët" me grupin e folklorit dhe valleve, ndërsa mysafir special ishte SHKA "Bresana" nga fshati Bresanë- Dragash. Në këtë program të këndshëm, sidomos për mërgimtarët, interesante ishte prezantimi i dokeve dhe zakoneve popullore përmes këngës e lojës që prezantoi grupi nga Dragashi.

"Rezistenca" - Ekspozitë e fotografisë nga Hazir Reka - Hazir Reka mblodhi disa prej fotografive të tij të periudhës së viteve '90-të, që pasqyrojnë jetën politike të Kosovës në atë kohë. Të gjitha këto fotografi ishin botuar në gazetatat më të njohura të botës në atë kohë, që tregonin realitetin e hidhur në Kosovë.

Mega koncert "Street Party Ferizaj" – Me mbështetjen e DKRS-së , Street Party, u realizua në sheshin e qytetit në Ferizaj me artistët e mirënjohur, si: Sardi, Eugen Bushpepa, Bystander, Altin Boshnjaku, Pumo Space etj.

Program artistik për fëmijë "Argëtime për fëmijë" - Ky program u organizua në kuadër të manifestimit "Ditët e Mërgatës" në argëtim e për kënaqësi të fëmijëve edhe nga mërgata. Prezantoi grupi i maskotave nga Ferizaj.

Panairi i Librit në Ferizaj – nga Klubi Letrar "De Rada" – Ferizaj. Panairi i Librit – është një prej aktiviteteve më të veçanta kulturore në Ferizaj. Panairi për tre netë radhazi i ofroi dashamirëve të librit botime të ndryshme nga rreth 20 shtëpi botuese të ardhur nga Shqipëria, Kosova, e Maqedonia e Veriut. Gjatë këtyre ditëve u organizuan diskutime e promovime veprash letrare.

Manifestimi tradicional kulturor "Bjeshkët e Jezercit" -Ky aktivitet ishte në kuadër të manifestimit "Ditët e Mërgatës"- Ferizaj 2023, i cili u mbajt në fshatin Jezerc nga shoqata "Jezerci" – tek "Bashkimi i lumenjve".

MAGIC SAL nga Nju Jorku- aktivitet për fëmijë -Një prezantim atraktiv i artistit me performimet magjike të tij, Artisti Sali Buzhala - Magic Sal nga Nju Jorku performoi me lojërat akrobatike të tij para fëmijëve. Poashtu u dha edhe një program artistik me fëmijë, që u mbajtën në Sheshin e Qytetit të Ferizajt. Ky aktivitet ishte i fundit në kalendarin " Ditët e Mërgatës" - Ferizaj 2023.

Punëtori për fëmijë - Kosova Makers League –Qytetari Digjital -Në Galerinë e Arteve, “Kosova Makers League” zhvilloi një punëtori për fëmijë, në kuadër të projektit "Qytetari Digjital", nën temën *"Trip to the libraries of Kosovo"*. Fëmijët që prezantuan në këtë punëtori, mësuan të programojnë robotin mikro: Maqueen Plus dhe të përfundojnë sfidën me sukses.

Festivali "Kosovarja Këndon" e "Festivali i Teatrove" në trashëgimi shpirtërore

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka publikuar vendimet që dy festivalet më të vjetra në Ferizaj dhe në Kosovë, do të jenë pjesë në listën e trashëgimisë shpirtërore. Këto dy festivale të mëdha, më shumë se gjysmë shekulli kanë qenë identifikim i jetës kulturore në Ferizaj e Kosovë, bashkë me ansamblin "Kastriotët", Klubin Letrar "De Rada" shoqatën e artistëve "Zef Kolombi" dhe rok grupet Trix, Tonic etj. Tani Ferizaj ka dhjetëra organizata kulturore, e një brez të ri artistësh që falë kësaj tradite, mbajnë të gjallë jetën kulturore në Ferizaj.

Mbledhje komemorative për shkrimtarin Isak Guta. -Isak Guta gati katër decenie kishte jetuar në mërgatë (Gjermani), por kurrë pa u ndarë nga vendlindja me shkrime, kujtime e vepra të ndryshme. Mbi njëzet vepra të botuara të tij, pjesa dërmuese i janë kushtuar ikonës kombëtare e botërore të skenës së teatrit, Aleksandër Moisiu. Ai tërë jetën ia kushtoi kësaj figure, me vepra letrare, monografi, dokumentarë dhe ekspozitë me fotografitë e Moisiut. Pjesën dërmuese të këtyre promovimeve, ai i bëri në Drejtorinë e Kulturës në Ferizaj. Komuna e Ferizajt organizoi mbledhje komemorative dhe ceremoninë e fundit të tij.

Festivali i Teatrove – Ferizaj 2023.

Një prej ngjarjeve më të mëdha kulturore në Ferizaj, pa dyshim se është Festivali i Teatrove, i cili sivjet shënoi edicionin e 53-të. Në këtë edicion morën pjesë dhjetë shfaqje, prodhimet më të mira teatrore mbarëkombëtare, poashtu u organizuan debate të një rëndësie të veçantë me profesionistë të temave të caktuara, edhe aktivitete të tjera argëtuese, u organizuan për 9 netë, ku interpretuan artistët e mirënjohur, si: Shpat Deda, Mentor Haziri, Edona Reshitaj, Shpend Hysaj, Nita Latifi, Erëza Çerkini, La Fazani, Daff’N’ Dudes dhe Zada. Festivali i Teatrove u përmbyll me ceremoninë e ndarjes së çmimeve.

Artefakte të reja në Muzeun e Qytetit -Në kuadër të fushatës vetëdijësuese të Njesisë për Trashëgimi dhe Muze, Muzeu i Qytetit është pasuruar me artefakte arkeologjike, numizmatike nga dhuruesi Fisnik Brahimi nga fshati Pleshinë. Këto janë monedha nga periudha antike dhe e mesjetës si: unaza, thika, kopësa, gozhda e artefakte të një thesari me vlera të mëdha që e shpalos historinë e Mbretërisë Dardane në trevën e Ferizajt që nga shekulli III p.e.s

Festivali Ndërkombëtar i Karikaturës nga SHK “HiTHi”

Në Festivalin Ndërkombëtar të Karikaturës në Ferizaj, këtë vit morën pjesë me gjithsej 150 punime, si shënim simbolik të 150 vjetorit të themelimit të qytetit të Ferizajt me temën *"Hekurudha"*. Çmimi i parë dhe medalja *"Therrë Murrizi"* i takoi artistit të përmasave ndërkombëtare, mjeshtrit të karikaturës, Agim Sulaj. Mysafirëve ndërkombëtarë dhe stafit të festivalit, iu bëri pritje nga menaxhmenti i DKRS-së dhe stafi i saj. Ky festival vazhdon ta ketë rritjen e tij duke pasur në krahë Drejtorinë e Kulturës në Ferizaj. Festivali u organizua nga drejtori i SHK "HiThi" Imri Musliu, bashkë me stafin e tij. Festivali u përkrah nga MKRS dhe DKRS.

Duhet të theksojmë se SHK “HiTHi” ka shtrirë aktivitetet gjatë gjithë vitit, në organizim të punëtorive, vizitave dhe ekspozitave të ndryshme.

Koncert memorial kushtuar kompozitorit Vinçenc Gjini (1935-2022) - Në sallën e Teatrit “Adriana” në Ferizaj u mbajt një koncert memorial kushtuar kompozitorit të njohur shqiptar Vinçenc Gjini, pedagog shumëvjeçar në Akademinë e Arteve në Prishtinë, pastaj kompozitor i shumë veprave të njohura simfonike. Koncerti u përgatit nga Kori dhe Orkestra e Qytetit nën dirigjim të Lindita Isufit, ndërsa u përkrah dhe u inicua nga Komuna e Ferizajt.

28 shtatori – “Dita e Dëshmorëve të Komunës së Ferizajt” – Në kuadër të aktiviteteve të 150 vjetorit të Ferizajt, me aktivitete të shumta u shënua edhe kjo ngjarje e veçantë për Ferizajn.

Promovimi i librit monografik “Simbolet e Lirisë” nga Musa Emini - Ky libër përmban kryesisht statistika e fotografi nga lufta e fundit në Kosovë, konkretisht janë fotot e lapidarëve dhe përmendoreve të Dëshmorëve të Kombit të UÇK-së.

Performanca e trupës artistike e "AKV SHOTA" në Ferizaj - Krahas manifestimeve dhe aktiviteteve të organizuara për nder të Ditës së Dëshmorëve të Kombit të Ferizajt, u mbajt një akademi përkujtimore dhe u dha një koncert festiv nga Ansambli “Shota”, në nderim të dëshmorëve të UÇK-së. Koncerti u mbajt në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve të Kombit të UÇK-së në Ferizaj, ku performuan emra të njohur të estradës, si: Liridon Sadriu, Violetë Kukaj, etj, si dhe pjesë recitale përgatitur nga Heset Maliqi- Quza.

Aktivitet letrar “Ora e Astritit” -Në sallën e Galerisë së Arteve – u mbajt konkursi i poezisë "ORA E ASTRITIT" - edicioni i shtatë, organizuar nga Klubi Letrar “De Rada” dhe përkrahur nga DKRS. Ky aktivitet mbahet tradicionalisht në vigjilje të Ditës së Dëshmorëve dhe mban emrin e poetit dëshmor Astrit Bytyçi. Fitues i vendit të parë ishte Xheladin Rexhepi.

“Hana po fluturon”- shfaqje premierë e Teatrit “Adriana” - Teksti: Arta Arifi, regjia Iliriana Arifi.

Ekspozita shëtitëse - u organizua nga Asociacioni i Artistëve Vizuel të Kosovës në bashkëpunim me SHAF "Zef Kolombi" dhe Galerinë e Arteve Ferizaj.

Aktivitet kreativ nga QKD “Pema” me fëmijët sindromën down - Një aktivitet kreativ e argëtues me fëmijët me Sindromën Down nga Ferizaj. U shfaq një film komedi, një video motivuese, si dhe një koktej me muzikë e argëtim.

Festivali i Recitatorëve -Në Teatrin “Adriana” u mbajt “*Festivali i Recitatorëve*”. Organizator i këtij edicioni ishte Fondacioni Chaplin me aktorin Ali Krasniqi. Kujtojmë se ky festival mbahet në nderim të aktorit të ndjer Misret Halili. Fituese e çmimit special, Erina Sahiti.

Promovimi i librit “Buzëqesh për të nesërmen” nga Blerina Murtezi -Libri i tretë me poezi i saj.

Njohje fillestare me artin skenik - Ky aktivitet ka filluar që nga viti 2008, si ide për zbulimin e talentëve të rinj në artin skenik. Ishte organizuar disa herë gjatë viteve, varësisht nga mundësitë financiare. Sivjet me shumë sukses e organizoi Fondacioni Chaplin. Projekti u përmbyll me një shfaqje për të rinj *"Ndal bullizmit"* nga nxënësit e shkollave të mesme të Ferizajt. Projekti u mbështet financiarisht nga: MKRS dhe DKRS.

Debat nga Festivali "Fëmijët e Gëzuar" "Kënga për fëmijë sot" - Një debat lidhur me këngën për fëmijë ndër vite. Për këtë të temë folën personalitete të fushës së kulturës e mediave.

Ekspozita e Skulpturës "SKULPT-FER" 2023 - Në ambientet e Galerisë së Arteve në Ferizaj u hap Ekspozita e Skulpturës "Skulpt-Fer" 2023. Ekspozita e Skulpturës "Skulpt-Fer" është një nga ngjarjet më unike për skenën e artit pamor në Kosovë.

Festivalit Piano Fest Ferizaj -Festivali "Ferizaj Piano Fest" për tre ditë radhazi mbajti edicionin e IV-të me radhë, duke sjellë talentë të rinj nga Kosova e Shqipëria, të cilët treguan talentin e tyre në piano. Në natë e fundit interpretoi një emër i përveçëm i muzikës klasike, soprano Eva Golemi. Bashkë me të ishte edhe pianistja e njohur Fjorda Veizaj si dhe violinistja e re e diplomuar në Vjenë, Laura Llozi. U interpretuan veprat e njohura të kompozitorëve shqiptarë: Pjetër Gaci, Toni Harapi, Prenk Jakova, Avni Mula, Ramadan Sokoli e Pirro Çako.

Bienali i Vizatimit – Edicioni i 6-të -Më 26 Nëntor u hap ekspozita e Bienalit Ndërkombëtar të Vizatimit në Galerinë e Arteve në Ferizaj. Kjo ekspozitë është organizuar nga Galeria e Arteve dhe SHAF "Zef Kolombi".

Panoramë apoetike "Kristale Lypeteni" nga Mustafë Xhemaili -Kjo panoramë përfshin poezi të krijuara përgjatë gjashtë dekadave nga 42 krijues ferizajas, por edhe krijues që kanë jetuar dhe vepruar në qytetin tonë. Organizoi Klubi Letrar "De Rada", përkrahur nga Komuna e Ferizajt.

Festivali "Kosovarja Këndon" - Në prani të shumë shikuesve në sallën e Teatrit "Adriana" - Ferizaj, u mbajt Festivali i këngës popullore *"Kosovarja Këndon"*- edicioni i 51-të. Kandidate të trevave të ndryshme të Kosovës, kishin bërë përgatitje, më shumë se një muaj, bashkë me orkestrën e ansamblit "Kastriotët" për të prezantuar ashtu siç është më së miri. Pas interpretimit të vajzave pjesëmarrëse, u bë ndarja e çmimeve të fitueseve të Festivalit "Kosovarja Këndon".

Mbrëmje përkujtimore për Zyhrije Vatën - Klubi letrar "De Rada" në një ambient mallëngjyes u kujtua Zyhrije Vata, një grua e veçantë, një intelektuale, aktiviste, poete, gazetare e kontribuese e pashoq në arsim, edukim e kulturë. Pjesëmarrës ishin familjarë, miq të Zyhrijes, shkrimtarë e personalitete të kulturës, përfaqësues të institucioneve etj. U lexuan poezi e u evokuan kujtime.

Stand up komedi "Koftë kysmet"- shfaqje premiere -Projekt nga Valdrin Osmani e Taki Beqiri në bashkëpunim me Teatrin "Adriana".

"Libri magjik" shfaqje për fëmijë -Projekt për fëmijë, i realizuar nga aktori Dashuri Rexhepi në bashkëpunim me Teatrin "Adriana".

“Hajnat nuk vijnë gjithmonë për të keq”- shfaqje premierë -Shfaqje projekt i aktores Uratë Shabani, në bashkëpunim me Teatrin “Adriana”.

“Shtëpia Magjike” shfaqje për fëmijë -Projekt i aktores Doruntina Xhemaili dhe Teatrit “Adriana”, regjia Besim Ugzmajli.

Mbrëmje artistike për fundvit –Në mbrëmjen e fundvitit u shfaq koncerti nga Rona Nishliu & Band dhe u falënderuan artistët ferizajas për angazhimin e tyre njëvjeçar, njëkohësisht u ndanë mirënjohje për bashkëpunorët e DKRS-së. Në këtë mbrëmje u shpall edhe Artisti i Vitit 2023 - Blin Mani.

SEKTORI I BIBLIOTEKAVE

Sektori i Bibliotekave funksionon në kuadër të DKRS-së me detyra e përgjegjësi funksionale sipas rregullave të punës. Një ndër segmentet kyç për suksesin e Bibliotekës është pasurimi i fondit librar. Bibliotekat janë qendër informacioni dhe si të tilla duhet të pasurohen në vazhdimësi me botimet e reja krahas kërkesave të lexuesve. Kështu do të rritet edhe numri i lexuesve. Synim tjetër është ruajtja e koleksioneve librare që biblioteka të ketë koleksione të shumta në periudha të gjata kohore.

Biblioteka do të bashkëpunoj me degët në fshatrat Talinoc i Muhaxherëve, Neredime, Komogllavë, Dardani për të pasuruar fondin librar, kushtet infrastrukturore të punës, si dhe ngritjen e nivelit profesional në kryerjen e punëve.

Mbarëvajtja e sektorëve, sektorët e librit-kujdesi ndaj fondit librar, sektori i përpunimit të koleksioneve librare, periodikut, salla e informatikës, sallat e leximit. Sistemimi i punëve të brendshme që biblioteka të jetë qendër e informacionit të shpejtë dhe korrekt me shfrytëzuesit e fondeve tona.

Biblioteka “Sadik Tafarshiku”

Në sektorin për fëmijë u anëtarësuan 959 lexues me 12257 libra të lexuara.

Tek sektori për të rritur u anëtarësuan 672 lexues me 7547 libra të lexuara.

Gjithsej :1631 lexues 19804 libra të lexuara.

Në sallën e leximit ishin 6888 lexues, kurse të informatikës 396 lexues.

Bibliotekat nëpër fshatra

Në Talinoc të Muhaxhervëve u anëtarësuan 110 lexues me 575 libra të lexuara.

Në Dardani u anëtarësuan 20 lexues me 57 libra të lexuara.

Në Komogllavë u anëtarësuan 212 lexues me 6685 libra të lexuara.

Në Neredime u anëtarësuan 112 lexues me 902 libra të lexuara.

Gjithsej 454 lexues me 8219 libra të lexuara.

Në sektorin e katalogimit dhe përpunimit të librit janë pranuar 3339 libra dhe u bë inventarizimi i 3339 librave.

Aktivitete të tjera

Veç detyrave të përditshme që bënë ky sektor me stafin e saj në përkujdesje të librave dhe lexuesve, gjithsesi gjatë vitit organizon edhe aktivitete e veprimtari të tjera në fushën e librit dhe të kulturës. Në vazhdim paraqesim të dhënat për disa nga aktivitete e realizuara, si në vijim:

Ekspozita e pirografit Xhemil Ismani - Dita e Pavarësisë - në kuadër të aktiviteteve të përvjetorit të Pavarësisë në Bibliotekën "Sadik Tafarshiku" u hap ekspozita me punimet në pirografi të autorit dhe artistit ferizajas, Xhemil Ismani, e cila ekspozitë zgjoi kureshtje si asnjëherë më parë tek të pranishmit.

Proovimi i librit "100 ditë" të autorit Faruk Buzhala - Për librin folën, profesoresha Dije Demiri Frangu dhe redaktori i librit, Prend Buzhala.

Orë letrare me nxënësit e shkollës "Tefik Çanga" - Për nder të shkrimtarit dëshmor Ymer Elshani, u recituan vargjet e poetit. Prezent ishte vajza e shkrimtarit, Teuta Elshani, ku bibliotekës së shkollës dhe bibliotekës sonë ia dhuroi disa libra të shkrimtarit Ymer Elshani.

Ekspozita me dokumente origjinale të KMDLNJ - Në Bibliotekën "Sadik Tafarshiku" u hap ekspozita me dokumente origjinale të KMDLNJ. Për historikun e veprimtarisë dhe themelimit të KMDLNJ-së foli ish Kryetari i Komunës së Ferizajt si dhe kryetari i parë i këshillit të KMDLNJ-së, z. Bajrush Xhemajli. Për përzgjedhjen e dokumenteve për tu ekspozuar foli ish koordinatori i KMDLNJ z. Lumni Salihu.

Promovimi i dy librave të rinj të poetit dhe publicistit Shaip Beqiri: "Muzeu i mërzisë" (poezi në shqip dhe anglisht) dhe "Mozaiku i mbuzur" (dialog, monolog, nekrolog).

Shumë nxënës gjithashtu e vizituan bibliotekën dhe u njoftuan me punën profesionale që bëhet në bibliotekë.

SEKTORI I RINISË

Sektori i Rinisë është dikaster që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj e që merret me aktivitete rinore, takime edukative, kreative. Krahas ngjarjeve të organizuara nga DKRS, organizoi dhe udhëhoqi shumë aktivitete rinore në iniciativa të ndryshme.

Ferizaj në Gravelines – Marrëveshje bashkëpunimi për të rinjtë me organizatën franceze Play International, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Francës, Komuna e Gravelines, Komuna e Ferizajt dhe Ambasada Franceze në Kosovë. Të rinjtë e Ferizajt filluan mësimin në gjuhën frënge. Të rinjtë u certifikuan për lojëra të ndryshme sportive dhe ishin pjesë e lojërave paraolimpike në Gravelines të Francës.

Klasa për mësimin e gjuhës angleze - Një nga formatet e organizimit në fushën e edukimit jo-formal është klasa për mësimin e gjuhës angleze, e cila tashmë është bërë traditë për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta dhe për shkollat e mesme të larta, falë komunikimit bashkëpunimit të ngushtë me KFOR-in amerikan. Përfitues ishin gjithsej 20 (njëzet) të rinj, kursi zgjati 6 muaj.

Tryezë diskutimi e Shoqërisë Civile në Komunën tonë por edhe më gjerë ka luajtur një rol të rëndësishëm në proceset rinore por edhe proceset vendimarrëse dhe për të sjell një pasqyrë të gjithë kontributit nga viti 2000 e tutje është organizuar tryeza e diskutimit me panelistë që për vite me radhë kanë krijuar aktivitete në të mirë të rinisë por edhe të komunitetit. Paneli diskutues nga Bar Camp Ferizaj dhe Rrjeti i OJQ-ve Avonet.

Vullnetari i Vitit – Duke u bazuar në Rregulloren për Dhënien e Dekorativave, DKRS formoi Komisionin për shpalljen e Vullnetarit të Vitit, me këtë rast me vlerësimin e komisionit - Vullnetare e Vitit 2022 u shpall Aolta Bajrami. Për organizimin e ceremonisë u kujdes Sektori i Rinisë.

Takim informues për qasje në tregun e Punës - Sektori i Rinisë në bashkëpunim Zyrën Regjonale për Punësim në Komunën e Ferizajt në hapësirat e Sallës së Kuvendit të Komunës kanë organizuar takimin informues për të rinjtë punë-kërkues dhe mundësinë e e qasjes në tregun e punës përmes masave aktive të tregut të punës dhe të platformave publike.

Ecim me Policinë e Kosovës –Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Drejtoria Rajonale në Ferizaj, Kuvendin e të Rinjve dhe organizata tjera rinore u realizuan aktivitete të shumta, si: patrullimi i përbashkët në komunikacion mes zyrtarëve policor dhe të rinjve aktivist, duke përfshirë edhe të rinjtë nga shoqata e personave me nevoja të veçanta nga Shoqata Handikos, ecja nga objekti i Policisë Regjonale deri tek Parku i Lirisë, aktivitet artistik me Policinë e Kosovës, ligjërata me temën ‘Drogat Vrasin’. Agjenda e aktiviteteve “Ecim me Policinë e Kosovës” u përfundua me aktivitete sportive në sportin e futbollit.

Sesion informues në fushën e IT - Në kuadër të garës ndërkombëtare në fushën e IT është mbajtur sesioni informues për të rinjtë ferizajas nga ICT Awards në kuadër të bashkëpunimit mes Unionit të Bashkive Shqiptare. Pjesëmarrës ishin dhjetëra të rinj të cilët kanë pasion dhe profesion fushën e teknologjisë informative.

Java e KFOR-it - Është një nga ngjarjet më të rëndësishme në fushën e rinisë për arsye të bashkëpunimeve dhe peshës së aktiviteteve të cilat vendosen në agjendë për pesë ditë me radhë. Kryesisht lojëra e aktivitete tradicionale.

Dita Ndërkombëtare e Rinisë - Vizita e grupit të vullnetarëve në Camp Bondsteel, aktiviteti ecje në natyrë në fshatin Jezerc në bashkëpunim me Klubin Alpinist “Kastrioti”.

Ndihmojmë të tjerët - Grupet e vullnetarëve të Sektorit të Rinisë, dhanë mbështetje teknike për prindërit dhe familjarët në procesin e subvencionimit të librave shkollor, aplikim ky përmes platformës digjitale që hasën në vështirësi për tu furnizuar me libra. Kjo ndihmë u realizua dy ditë me radhë në hapësirat e Galerisë së Arteve, ku u ndihmuan 160 prindër.

Tryeza e diskutimit “As edhe një më shumë” – Në kuadër të fushtës globale “ 16 ditë të aktivizmit kundër dhunës mbi bazë gjinore”, Sektori i Rinisë organizoi tryezën e diskutimit me të rinjtë “As edhe një më shumë”, pjesëmarrja e institucioneve nga niveli lokal dhe qendror dhe shoqëria civile.

Dita Ndërkombëtare e Punës Vullnetare – Për të shënuar këtë datë të veçantë për të rinjtë, u mbajt tryezë diskutimi për sfidat dhe të arriturat e punës vullnetare në Kosovë.

Ndarja e dhuratave për fëmijët në festat e fundvitit –

Sektori i Rinisë organizoi shpërndarjen e dhuratave për nxënësit e SHMU “Skënderbeu” në fshatin Jezerc.

SEKTORI I SPORTIT

Sektori i Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ferizaj, e që merret me aktivitete sportive. Këto aktivitete realizohen duke iu referuar planit të punës të përpiluar në fillimvit.

Ky sektor organizon aktivitete sportive të përbashkëta me klubet sportive e komunitetin sportiv me Komitetin Olimpik të Kosovës, Departamentin e Sportit dhe me Federatat Sportive. Krijon kushte për mbarëvajtjen e aktiviteteve të klubeve sportive e të sportistëve.

Fillimisht po paraqesim gjeneralet e klubeve sportive për vitin 2023 ku janë të përfshirë në organizimin e sportit ferizajas gjithsej 68 klube sportive dhe 4 shoqata sportive, të cilat janë të organizuar mjaft mirë në zhvillimin e sportit në Komunën e Ferizajt.

Në të gjitha klubet sportive janë të përfshira në të dy gjinitë me të gjitha grupmoshat, duke u përfshirë nga grupmosha U 7 deri tek veteranët, çka do të thotë se në Komunën tonë kemi diku rreth 5800 sportistë.

Stërvitjet e realizuara gjatë vitit 2023

Sektori i Sportit kujdeset për infrastrukturën fizike-sportive që të krijoj kushte sa më të mira për zhvillimin e orëve stërvitore dhe garave të ndryshme sportive. Njëkohësisht po krijohen edhe terrene të reja sportive edhe nëpër fshatrat e Komunës së Ferizajt, në këtë mënyrë aktivizojmë jo vetëm klubet aktive por edhe komunitetin në fshatra.

Pallati i Sporteve “Bill Clinton” – Klubet sportive kolektive dhe individuale e sportit të pavarur, aktivitetin e tyre e realizojnë në Palestrën e Sporteve. Stafi i Sektorit të Sportit kujdeset për lehtësimin e realizimit të aktiviteteve sportive.

Në Pallatin e Sporteve në Ferizaj gjatë vitit 2023 janë realizuar gjithsej 6049 orë ekonomike, stërvitje. Shfrytëzues të Palestrës kryesisht janë klubet sportive të Komunës së Ferizajt e në disa raste edhe klubet sportive nga komunat fqinje.

Lojë kampionale - Në Pallatin e Sporteve “Bill Clinton” janë realizuar gjithsej 352 lojë kampionale, 7(shtatë) lojë për Kupë dhe 6 (gjashtë) lojë miqësore.

Në Palestrën e Sporteve janë realizuar edhe disa koncerte kulturore dhe aktivitete të tjera jo-sportive për përgatitjen e pjesës teknike të aktivitetit është përkujdesur Sektori i Sportit.

Stadiumi i Qytetit “Dardania” - Në stadiumin e qytetit në Ferizaj janë realizuar 2340 orë ekonomike, stërvitje. Shfrytëzues të stadiumit të qytetit janë kryesisht klube të futbollit të Komunës së Ferizajt.

Në Stadiumin e qytetit janë zhvilluar përpos stërvitjeve edhe lojë me rëndësi– Janë zhvilluar 327 lojë kampionale, 12 lojë miqësore.

Shumica e klubeve sportive aktivitetet stërvitore i kanë mbajtur në Pallatin e Sporteve “Bill Clinton”, Stadiumin e Qytetit “Dardania”, poashtu janë shfrytëzuar palestrat sportive nëpër shkolla dhe hapësira tjera publike, gjithashtu edhe garat e planifikuara, turnet dhe lojërat miqësore janë realizuar në objektet sportive publike.

Aktivitete sportive

Përveç punëve të përditshme në sektorin e sportit organizohen edhe aktivitete të ndryshme sportive, në bashkëpunim me klubet sportive dhe shoqata sportive. Në vijim të raportit shihni aktivitetet kryesore sportive.

Kuvendet e rregullta të punës dhe ato zgjedhore - Sektori i Sporteve në bashkëpunim me klubet sportive kanë organizuar kuvendet e punës. Gjatë viti 2023 pesëmbëdhjetë klube sportive të Komunës së Ferizajt, kanë mbajtur kuvendet e rregullta të punës dhe ato zgjedhore, ky organizim i kuvendeve ishte në pajtueshmëri me MKRS-në dhe KOK-un, si objektiv që të riorganizohen të gjitha kuvendet e klubeve. Janë themeluar dy klube të reja: Klubi Atletikës “Ferizaj Runners” dhe Klubi i Futbollit “Athletic Club”.

Të gjitha këto kuvende janë monitoruar nga DKRS, gjegjësisht nga Sektori i Sporteve, por në disa raste monitorues ishin edhe zyrtarët nga Federatat Sportive.

Turneu në volejball, Institucionet e Komunës së Ferizajt (vajzat dhe gratë) - Komuna e Ferizajt gjegjësisht DKRS për nder të 17 Shkurtit organizoi turneun e institucioneve në volejball (vajzat dhe gratë), pjesëmarrëse ishin 4 ekipe të organizatave punuese, në vendin e parë u rendit Polica Rajonale e Ferizajt. Tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe mirënjohje nga Sektori i Sportit.

"Ecja pranverore" – Me një pjesëmarrje masive, Sektori i Sportit në Ferizaj organizoi Ecjen Pranverore 2023.

Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe - Është organizuar, në bashkëpunim me Sportin Shkollor dhe KOK-un. Mesazhi është dhënë përmes aktiviteteve sportive, për të nxitur paqe dhe mirëkuptim, për të nxitur ndryshim në shoqëri, zhvillim në komunitetin sportiv që manifestohet përmes fuqisë së sportit. Pjesëmarrës 120 nxënës të organizuar nga sporti shkollor.

Dita Olimpike 2023 – Për nder të Ditës Olimpike, Sporti Shkollor në bashkëpunim me Komunën e Ferizajt kanë zhvilluar kryesisht aktivitete me lojëra elementare, me të lindurit në vitin 2008, nga të dy gjinitë.

Minimaratona “Vrapojmë me Policinë e Kosovës” – Minimaratona u organizuar nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me DKRS-në, në kudër të Ditës së Çlirimit të Ferizajt. Në këtë organizim morën pjesë qytetarë të moshave të ndryshme.

Ecje malore – Hiking - Organizata ambientale “Kaça” në bashkëpunim me DKRS, organizoi ecje kolektive me alpinistë e qytetarë. Destinacioni ishte emëruar “*Shtigjeve të lirisë*”, me synim Malet e Koshares në brezin kufitar Kosovë- Shqipëri. Veçse një rekreacion, ky aktivitet u shënuar edhe në nderim të 11 dëshmorëve të Komunës së Ferizajt që ranë në këtë betejë.

Turneu Ndërkombëtar i Boksit “Muharrem Mehmeti”- Në kuadër të aktiviteteve të shumta, kjo ngjarje u realizua për të nderuar boksierin e parë ferizajas, Muharrem Mehmeti. U mirëpritën mysafirë, emra të mirënjohur të boksit vendor. Në ring u ngjiten boksierë vendor e ndërkombëtarë, si nga Bullgaria, Maqedonia e Veriut, Shqipëria etj.

Ditët e Mërgatës - Më disa demonstrime sportive, me pjesëmarrjen e shumë klubeve sportive, u hap manifestimi tradicional “Ditët e Mërgatës”. Ky manifestim shënohet edhe me aktivitete të shumta sportive, të cilat organizohen në shenjë mikpritje për mërgimtarët tanë që vijnë në vendlindje.

Ecje në natyrë - Ecje Liqeni i Gjolit - Kjo ecje u organizua si aktivitet në kuadër të manifestimit “Ditët e Mërgatës”. DKRS dhe shoqëritë bjeshkatore në kuadër të aktiviteteve për mërgimtarë, u organizua edhe një ecje bjeshkëve në bashkëpunim me shoqëritë bjeshkatore ferizajase. Ky rrugëtim ishte i përbashkët me pjesëmarrjen e shumë bashkatdhetarëve që jetojnë larg vendlindjes.

Turneu memorial në volejboll (femrat) “Ismet Ramadani” - Nën organizimin e DKRS dhe KVF “Ferizaj” u mbajt turneu memorial në volejboll (femrat) “Ismet Ramadani” ku ishin pjesëmarrës 4 ekipe nga Kosova të cilat treguan një cilësi të lartë të lojës së volejbollit. Tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe kupa nga organizatori.

Garat shkollore, lokale dhe regjionale - Në Pallatin e Sporteve u organizuan garat shkollore, lokale dhe regjionale në dy gjinitë ku morën pjesë të gjitha ekipet nga shkollat e Komunës sonë, si dhe ekipet nga Komuna e Shtimes, Lipjanit, Kaçanikut, Shtërpçës dhe Hanit të Elezit. Edhe në këtë garë tri vendet e para u shpërblyen me medalje dhe kupa si dhe dy vendet e para fituan të drejtë të marrin pjesë në garën finale që mbahet në Prishtinë.

Turneu memorial në Pingpong “Ahmet Hoxha” - Klubi i Pingpongut “Ahmet Hoxha” dhe DKRS organizuan turneun memorial në pingpong me disa klube pjesëmarrëse të Kosovës dhe shpërbleu tri vendet e para me kupa dhe medalje.

Turneu i Veteranëve në Pingpong “Gani Maloku” - Klubi i Pingpongut “Gani Maloku” në bashkëpunim me DKRS-në organizuan turneun e veteranëve në pingpong me disa klube pjesëmarrëse të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, ku tri vendet e para u shpërblyen me kupa dhe medalje.

Tiranë- Defile – Dita e Flamurit Kombëtar - Nën organizimin e Bashkisë së Tiranës, në bashkëpunim edhe me Komunën e Ferizajt dhe komunat tjera mbarëshqiptare, në nderim të Festës së Flamurit Kombëtar, u organizua një defile i përbashkët mbarëshqiptar nga gjitha bashkitë e komunat e trojeve shqiptare. Komuna e Ferizajt prezantoi me 209 pjesëmarrës, prej tyre 11 klube sportive, poashtu ishin pjesëmarrës edhe artistët e Ansamblit “Kastriotët”, Okteti dhe Orkestra e Qytetit si dhe përfaqësues të institucioneve.

TË ARRITURAT NË SPORT PËR VITIN 2023

Sportet Kolektive – Sporti i Futbollit në Komunën e Ferizajt gjatë vitit 2023, ishte i organizuar mjaft mirë, kishte një ngritje të klubit të futbollit “Dinamo”- Kampion vjeshtor në ligën e parë. Klubi i futbollit “Ferizaj” dhe “Dinamo” janë pretendentë për Superligën e Kosovës.

Klubet e hendbollit janë mirë të organizuar gjatë këtij viti, KH “Ferizaj” vajzat janë kampion vjeshtor, poashtu kemi ngritje të rezultatit dhe shumë synime drejt sukseseve nga KH “Kastrioti” djemtë. Sukseset nuk kanë munguar edhe në sportet tjera kolektive, por në raport janë përfshirë rezultatet kryesore.

Sportet tjera individuale - Klubet e karatesë, xhudos, notit, pinpongut, gjimnastika dhe automobilizmit i kanë sjellë qytetit të Ferizajt me qindra medalje nga turnetë e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Klubi i Shahut në Ferizaj është i organizuar mjaft mirë, fitues i shumë medaljeve në nivel vendi, por edhe pjesëmarrës në turne ndërkombëtare si dhe Kampion i Kosovës. Sportistë ferizajas i sollën qytetit të Ferizajt, medalje vendore dhe ndërkombëtare.

ARKIVI HISTORIK

Arkivi Historik Komunal përfshinë territorin e Komunës së Ferizajt dhe vepron si njësi në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Gjatë vitit 2023, kjo njësi ka vazhduar punët e mbetura nga viti paraprak, duke i grumbulluar, evidentuar dhe vendosur nëpër rafte dokumentacionin arkivor. Dokumentacioni arkivor që gjendet në arkiv është përpunuar detajisht dhe profesionalisht dhe është vendosur në vendin adekuat sipas numrit dhe llojit të lëndës.

Gjatë vitit 2023 në Arkivin Historik kemi pasur gjithsej 114 qytetarë që i kemi shërbyer, duke i respektuar kornizat ligjore, duke ju shërbyer me material arkivor dhe dokumentacione personale që ata kanë kërkuar nga ne.

Gjatë këtij viti kemi bërë ndarjen e materialit arkivor në Drejtoritë përkatëse, sipas shenjave dhe numrit të lëndëve. Gjatë vitit 2023 në kryerjen e punës në Arkivin Historik jemi përcaktuar sipas kësaj veprimtarie:

1. Ndarja dhe përcaktimi i dokumentacionit arkivor dhe lëndës arkivore
2. Klasifikimi i lëndës arkivore në fonde
3. Formimi dhe kompletimi i dosjeve në fonde
4. Sistematizimi i lëndëve arkivore në fonde
5. Mbrojtja teknike

1. Përpunim i fondit: Komisioni informues dega LDK Ferizaj 1995/96
2. Përpunim i fondit: Raporte, vendime, aktvendime, procese viti 1985/86/87
3. Përpunim i fondit: Procesverbale të Kuvendit Komunal 1969/78
4. Përpunim i fondit: Procesverbale të Kuvendit Komunal 1975
5. Përpunim i fondit: Procesverbale të Kuvendit Komunal 1981

PËRFUNDIM

Viti 2023 ishte vit i arritjeve, rezultateve dhe sukseseve në organizim të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive. Ndonëse në fillimvit, DKRS shtron një plan dhe një kalendar të aktiviteteve që planifikohen të mbahen gjatë vitit, në fund shohim se plani është tejkaluar me shumë aktivitete shtesë. Pjesa dërmuese e aktiviteteve gjatë vitit 2023 ishin për nder të 150 vjetorit të themelimit të qytetit të Ferizajt.

Në bazë të analizës së raportit dalin këto rezultate:

Në Muzeun e Qytetit kishte 58 vizita grupe të organizuara (nxënës, mësimdhënës, shkolla, kolegji etj), si dhe mbi 4000 vizitorë të Muzeut dhe aktiviteteve që ka organizuar kjo njësi.

Në Galerinë e Arteve u organizuan dhjetëra aktivitete nga fusha e artit pamor, duke vazhduar me manifestimet tradicionale dhe aktivitetet e pavarura. Nga raporti mësojmë se në këtë vit Galeria kishte mbi 5000 vizitorë dhe mbi dhjetë grupe të organizuara (nxënës, mësimdhënës, shkolla, kolegji etj)

Teatri i qytetit „Adriana“ vazhdoi me repertorin e saj të rregullt, poashtu realizoj gjashtë premiera teatrore, (katër për të rritur dhe dy për fëmijë). Organizoi Festivalin e Teatrove (edicioni i 53-të), pastaj pjesëmarrëse në festivalin e Tiranës, etj. Me numër të përafërt të shikuesve në Teatër rreth 8000 persona.

Në Sektorin e Kulturës janë organizuar **169 aktivitete kulturore**, pa përfshirë këtu vizitat grupe të shumta, takimet dhe organizime të tjera të pavarura etj.

Në Bibliotekën e Qytetit “Sadik Tafarshiku” dhe në degët e saj në fshatra, janë gjithsej 2085 lexues me 23143 libra të lexuara. Aktivitete në çdo vit kalendarik afërsisht 20 aktivitete.

Në objektet sportive që menaxhohen nga Sektori i Sportit u realizuan gjithsej 8389 orë stërvitore, 679 lojë kampionale dhe 18 lojë miqësore. Nuk ka të dhëna të sakta për pjesëmarrjen e shikuesve. Ndërsa aktivitete e realizuara për data dhe ngjarje të veçanta shtetërore e sportive, janë mbi 30 aktivitete.

Ndërsa në Sektorin e Rinisë janë të realizuara mbi 30 aktivitete rinore.

Me përfshirjen e të gjithë sektorëve të DKRS-se në Ferizaj, janë realizuar mbi 250 aktivitete kulturore, rinore dhe sportive, pa përfshirjen e vizitave, takimeve, garave e organizime tjera.



Pjesa dërmuese e aktiviteteve ishin në vigjillje
të 150 vjetorit të qytetit të Ferizajt.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2023

Kemajl Emini
Drejtore i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, paraprakisht ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara në vitin paraprak, me qëllim të identifikimit të të gjitha sfidave që do të merren si bazë në përcaktimin e objektivave kryesore për vitin 2023, për të dy sektorët – Sektorin e Shëndetësisë dhe Sektorin e Mirëqenies Sociale.

SEKTORI I SHËNDETËSISË

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka vlerësuar si të domosdoshme mbajtjen e takimeve konsultuese me strukturat udhëheqëse të QKMF-së, Këshillin Drejtues, Këshillin Profesional si dhe udhëheqës të njësive për përcaktimin e objektivave.

Konkluzion i përbashkët ishte se bazë e përcaktimit të objektivave për vitin 2023, do të jetë buxheti që kemi, duke u fokusuar në objektivat më të domosdoshme në Kujdesin Parësor Shëndetësor që drejtpërsëdrejti do të reflektonin në nivelin e ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore për një mirëqenie shëndetësore më të mirë për qytetarët tanë.

Objektivat e Sektorit të Shëndetësisë për vitin 2024

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në KPSH
- Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH
- Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional
- Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve.
- Angazhimi i vazhdueshëm në plotësimin e standardeve teknike dhe ngritja e performancës në punë në AMF-të e komunës sonë.
- Përmirësimi i infrastrukturës me ndërtimin e objekteve QKMF, QMF 2 dhe QMF në fshatin Prelez i Muhaxherëve.
- Funkcionalizimi i laboratorëve nëpër QMF-të në fshatra.
- Krijimi i një plan-strategjie për shtimin e numrit të specialistëve të rinj në Mjekësi Familjare.
- Pas përfundimit të pilot-projektit në katër komunat e caktuara, pritët të vazhdohet me zonimin dhe listimin e pacientëve, sipas kriterëve të grupit punues të angazhuar nga MSH.
- Vazhdimi i implementimit të tërësishëm të SISH-it dhe programit të SMSF-së.
- Fuqizimi i Programit të Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë 0-3 vjeç, me shtimin e kapaciteteve humane.
- Fuqizimi i aktiviteteve të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor, me shtimin e kapaciteteve humane.
- Fuqizimi i Vizitave Shtëpiake Paliative.
- Renovimi i objekteve shëndetësore.
- Vazhdimi i botimit të numrave të tjerë të revistës Kujdesi Shëndetësor.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, DSHMS, respektivisht Sektori i Shëndetësisë, pas përcaktimit të planit dhe objektivave, angazhimi ynë ka qenë që çdoherë të jemi në përputhje me planin e punës duke bërë përcaktimin e objektivave periodike si në atë tremujor, gjashtëmujor, nëntëmujor dhe atë përfundimtar.

▪ **Menaxhimi i Burimeve Njerëzore**

Përgatitja e planeve dhe menaxhimi i pushimeve vjetore, menaxhimi i pushimeve mjekësore, pushimeve të lehonisë është një punë me të cilën merren në vazhdimësi shefat e njësive në bashkëpunim me Departamentin e Administratës.

▪ **Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në KPSH**

DSHMS si prioritet ka rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore kundrejt qytetarëve tanë. Ne konsiderojmë se niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve është i mirë dhe çdoherë i kushtojmë vëmendje secilës ankesë të palëve që cenojnë nivelin e shërbimit.

▪ **Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH.**

Ngritja e cilësisë së shërbimeve bëhet përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe auditit klinik nga koordinatori i cilësisë në QKMF.

▪ **Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional**

Me qëllim që të trajnohen dhe aftësohet personeli shëndetësor në QKMF me nevojat e stafit të QKMF-së gjithëherë bëhet koordinimi me ZHVP për të harmonizuar programin e ZHVP-së me nevojat e personelit shëndetësor.

▪ **Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve**

Siguria dhe mirëqenia në punë e stafit shëndetësor dhe atij ndihmës është prioritet pasi me plotësimin e kushteve të punës dhe sigurisë ne do të kemi një staf më të shëndoshë, do të zvogëlohen mungesat në punë etj.

▪ **Përmirësimi i infrastrukturës me ndërtimin e objekteve QKMF, QMF 2 dhe QMF në fshatin Prelez i Muhaxherëve**

Me ndërtimin e objekteve të reja të QKMF-së, QMF-2, QMF-në Prelez të Muhaxherëve, që veç janë në ndërtim e sipër, do të kemi edhe hapësira të mjaftueshme dhe kushte më të mira të punës. Do të bëhet edhe shpërndarja e rrjetit të QMF-ve, si në fshatin Prelez, që i mundëson një numri të madh të banorëve të asaj ane të kenë shërbime shëndetësore aty dhe mos të stërngarkohen me pacientë, qendrat në qytet.

▪ **Funksionalizimi i laboratorëve nëpër QMF në fshatra**

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore më cilësore këtë vit do të kompletohen me laboratorë edhe QMF-të në Neredime dhe Komogllavë.

- **Krijimi i një plan-strategjie për shtimin e numrit të specialistëve të rinj në Mjekësi Familjare**

Në bazë të hulumtimeve dhe në konsultim me menaxhmentin e QKMF-së është vlerësuar si domosdoshmëri rritja e numrit të mjekëve familjarë duke marrë për bazë numrin e përgjithshëm të banorëve të komunës sonë. Për këtë arsye me prioritet do t'i trajtojmë specializimet në kuadër të Mjekësisë Familjare, gjegjësisht të Kujdesit Parësor Shëndetësor.

- **Vazhdimi i implementimit të tërësishëm të SISH-it dhe programit të SMSF-së**

Sistemi informativ shëndetësor është sistem ku ruhen të dhënat e pacientëve, historia shëndetësore e pacientit (kartoteka elektronike, e shpejtë dhe efikase), si dhe përcjellja e punës nëpër të gjitha qendrat shëndetësore të vendit, kështu që është prioritet i QKMF-së dhe njëherit edhe prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë.

- **Fuqizimi i Programit të Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë 0-3 vjeç, me shtimin e kapaciteteve humane.**

Vizitat për nëna dhe fëmijë, program i MSH-së i përkrahur nga UNICEF-i, këtë vit (2023) ka qenë mjaft i suksesshëm në QKMF, falë dhe angazhimit të infermierëve përmes marrëveshjes me Caritas Kosova. Prandaj, edhe këtë vit ne synojmë të zgjerojmë edhe më shumë këtë program me staf infermior të trajnuar për këto shërbime.

- **Fuqizimi i aktiviteteve të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor, me shtimin e kapaciteteve humane**

Edukimi dhe promovimi shëndetësor në komunitet paraqet një prej shtyllave të KPSH dhe në këtë aspekt këtë vit do të plotësohen ekipet e edukimit dhe promovimit me mjekë dhe me infermierë të tjerë me qëllim të zgjerimit të vizitave sistematike dhe mbajtjen e ligjëratave dhe aktiviteteve në komunitet.

- **Fuqizimi i Vizitave Shtëpiake Paliative**

Vizitat shtëpiake në kujdesin kronik dhe paliativ janë një sfidë në vete por që QKMF ka arritur mirë t'i menaxhojë gjatë këtyre viteve. Duke u ofruar kujdes shëndetësor këtyre pacientëve ne arrijmë që të përmbushim një të drejtë fundamentale njerëzore të të drejtave të pacientit *në shërbime shëndetësore për secilin banorë që ka nevojë për shërbim shëndetësor.*

Edhe në këtë rast, punëtorët e angazhuar me Caritas Kosova do të na japin një mbështetje të madhe për këto vizita.

- **Renovimi i objekteve shëndetësore**

Renovimi i objekteve shëndetësore si QMF-4 dhe renovime të pjesshme në disa QMF dhe AMF do të bëhet me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe mirëmbajtjes së objekteve shëndetësore.

▪ **Vazhdimi i botimit të numrave të tjerë të revistës Kujdesi Shëndetësor**

Me qëllim të pasqyrimin të shërbimeve shëndetësore dhe të arriturave të QKMF-së, do të vazhdoj botimi i punimeve nga mjekët dhe infermierët e QKMF-së, prandaj prioritet i yni është edhe vazhdimi i botimit të numrave të tjerë të revistës së QKMF-së *Kujdesi shëndetësor*.

Gjatë vitit 2023 në DSHMS, respektivisht Sektorin e Shëndetësisë, angazhim permanent ishte zhvillimi i politikave shëndetësore konform infrastrukturës ligjore në fuqi, që rregullon sferën e Kujdesit Parësor Shëndetësor, duke qenë të përkushtuar në ndërmarrjen e veprimeve për një funksionalizim të mirëfilltë të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve, me të vetmin qëllim që qytetarëve tanë t'u ofrohen shërbime shëndetësore sa më dinjitoze dhe cilësore.

Jemi të vetëdijshëm se edhe përkundër përkushtimeve tona mbetet ende për tu bërë, ndaj angazhimi ynë do të jetë i përhershëm edhe përkundër që shpeshherë po përballemi me sfida jo të tejkalueshme, si furnizimi jo i mjaftueshëm me barna esenciale nga Ministria e Shëndetësisë. Kjo është arsyeja që jemi angazhuar të gjejmë alternativa të tjera që nga të hyrat nga participimi të furnizohemi me barna esenciale që sado pak t'i mbështesim qytetarët tanë.

Një sfidë e vazhueshme është gjithashtu, mungesa e ligjit mbi sigurimet shëndetësore që pamundëson një sistem të mirëfilltë shëndetësor.

DSHMS është transparente për punën dhe aktivitetet që zhvillon kundrejt hierarkisë institucionale lokale dhe qendrore, ashtu si edhe ndaj qytetarëve. Pasqyrim i transparencës është edhe bashkëgjytja në vazhdim e raportit njëvjeçar të punës QKMF-së.

RAPORT PUNE QKMF

Shkurtesat

AMC – Action for Mothers and Children
AMF – Ambulanca e Mjekësisë Familjare
AMFK - Asociacioni i Mjekëve Familjarë të Kosovës
CDF – Community Development Found
DAT - Dispanseri Antituberkular
DMF – Departamenti i Mjekësisë Familjare
DShMS - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
ESP - Edukimi Specialistik Postdiplomik
EPSh – Edukimi dhe Promovimi Shëndetësor
EVP - Edukimi i Vazhdueshëm Profesional
IKShPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IRShPK – Instituti Rajonal i Shëndetit Publik të Kosovës
KAN – Kujdesi Antenatal
KD – Këshilli Drejtues
KP – Këshilli Profesional
KPSH – Kujdesi Primar Shëndetësor
MF – Ministria e Financave
MRCPG – Medical Royal College of General Practitioners
MSh - Ministria e Shëndetësisë
OBSh - Organizata Botërore e Shëndetësisë
OIK - Oda e Infermierëve të Kosovës
QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
OMK – Oda e Mjekëve të Kosovës

QMF – Qendra e Mjekësisë Familjare

QTMF – Qendra Trajnuese e Mjekësisë Familjare

QZhVP – Qendra për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional

SISh - Sistemi Informativ Shëndetësor

ShEP - Shërbimi Emergjent Primar

UNHCR - United Nations High Commissioner for Refugees

UNICEF - United Nations International Children's Emergency Found

ZhVP - Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

HYRJE

Personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e filloi vitin 2023 me angazhimet e nevojshme me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe detyrave të punës. Që në ditët e para të **vitit 2023**, puna filloi me ritmin e zakonshëm nëpër të gjitha QMF – të dhe AMF – të, për të vazhduar më tej me synim të intensifikimit. Si gjithmonë, përkushtimi ndaj organizimit të punës dhe eliminimi i ngecjeve eventuale, kanë qenë preokupim i vazhdueshëm i stafit menaxhues dhe hap imediat drejt përmbushjes së objektivave të paracaktuara për këtë vit, të cilat janë:

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore.
2. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në KPSH.
3. Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH.
4. Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional.
5. Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve.
6. Angazhimi i vazhdueshëm në plotësimin e standardeve teknike dhe ngritja e performancës në punë në AMF të komunës sonë.
7. Përmirësimi i infrastrukturës me ndërtimin e objekteve QKMF, QMF 2, dhe QMF në fshatin Prelez i Muhaxherëve.
8. Funkcionalizimi i laboratorëve nëpër QMF në fshatra.
9. Krijimi i një plan-strategjie për shtimin e numrit të specialistëve të rinj në Mjekësi Familjare.
10. Pas përfundimit të pilot-projektit në katër komunat e caktuara, pritet të vazhdohet me zonimin dhe listimin e pacientëve, sipas kriterëve të grupit punues të angazhuar nga MSH.
11. Shtrirja e rrjetit të internetit në AMF nëpër fshatra.
12. Vazhdimi i implementimit të tërësishëm të SISH-it dhe programit të SMSF-së.

13. Fuqizimi i aktiviteteve të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor, me shtimin e kapaciteteve humane.
14. Fuqizimi i Programit të Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë 0-3 vjeç, me shtimin e kapaciteteve humane.
15. Fuqizimi i Vizitave Shtëpiake Paliative.
16. Renovimi i objekteve shëndetësore.
17. Vazhdimi i botimit të numrave të tjerë të revistës Kujdesi Shëndetësor.

Aktivitetet dhe takimet

Më 13.01.2023 - është bërë kërkesa drejtuar Dr.Mohamed Soliman-drejtor i Organizatës Humanitare të Kuvajtit „Islamic Relief" për plotësimin e nevojave për personel shëndetësor: 5 mjekë, 35 infermierë dhe një asistent administrativ.

Më 16.01.2023 - në Ferizaj ka qëndruar "Karvani i vaksinimit", një aktivitet specifik lidhur me vaksinimin kundër Gripit sezonal dhe vaksinimin kundër COVID-19 i organizuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe me përkrahjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Kjo fushatë që u zhvillua me moton: “Ruaje veten-Vaksinohu” kishte për qëllim t'i jap shtytje të mëtejme vaksinimit kundër COVID-19 dhe Gripit sezonal, si dhe ta promovoj vaksinimin si mënyrën më të thjeshtë, më të lirë dhe më efikase për mbrojtje kundër sëmundjeve infektive siç janë Gripi sezonal dhe COVID-19.

Më 19.01.2023 - në Hotel „Emerald" u mbajt eventi ceremonial i ndarjes së certifikatave për trajnimin e rëndësishëm për Menaxhment, mbështetur nga AQH „Menaxhimi Shëndetësor", i ndjekur në gjashtë module radhazi gjatë vitit 2022, nga drejtorët e DSHMS-ve, menaxhmenti i QKMF-ve si dhe certifikata për trajnerë të Regjionit të Ferizajt, Gjilanit, Pejës, Prishtinës dhe Prizrenit. Pas fjalëve përshëndetëse nga përfaqësuesja e Projektit: Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor, Zëvendës Ministri i MSH dhe Zëvendës Drejtori i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, nga përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë u ndanë certifikatat për të trajnuarit dhe trajnerët e regjionit të Ferizajt.

Më 02.02.2023 - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia bashkë me Kryetarin e Komunës, Agim Aliu, vizituan institucionet publike shëndetësore, QKMF-në dhe Spitalin e Përgjithshëm. Zgjerimi i kapaciteteve dhe shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Komunës së Ferizajt ishte temë diskutimi dhe synim i kësaj vizite. Ministri Vitia u zotua se vazhdimi i ndërtimit të Spitalit të Ferizajt dhe ndërtimi i objektit të ri të QKMF-së, do të jenë projekte me prioritet për shëndetësinë në Ferizaj.

Më 02.02.2023 - Oda e Mjekëve të Kosovës ka akredituar Programin e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional të QKMF-Ferizaj.

Më 10.02.2023 – Drejtoresha e QKMF-së, nëpërmjet drejtorit të DSHMS-së, Dr.Kemajl Emini, ka bërë kërkesë drejtuar Ministrit dhe zyrtarëve të tjerë të MSH-së dhe MF-së për rritjen e numrit të punëtorëve, me profilet në vijim: 10 mjekë familjarë, 5 stomatologë, 30 infermierë, 3 farmacistë, 5 teknikë të farmacisë, 5 laborantë, 5 teknikë të RTG-së, 7 mirëmbajtës, 7 vozitës dhe 7 punëtorë për bashkëpagesa.

Më 01.03.2023 - mjekët e rinj të Komunës së Ferizajt u pritën nga Drejtori i DSHMS-së, Dr.Kemajl Emini dhe Këshilli Drejtues në zyrën e drejtoreshës së QKMF-së, për të filluar punën në këtë institucion, përmes marrëveshjes mes Komunës së Ferizajt dhe Caritas Kosovës. Punësimi i të gjithë mjekëve të rinj të diplomuar viteve të fundit ka qenë synim i kahershëm i menaxhmentit të QKMF-Ferizaj, DSHMS-së dhe Kryetarit të Komunës së Ferizajt.

Më 21.03.2023 - në hapësirat e Qendrës së Telemjekësisë në Prishtinë, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe *Action for Mother and Children* u mbajt trajnimi i infermiereve të programit për Vizita për Nëna dhe Fëmijë 0 deri 3 vjeç, për Sistemin Informativ Shëndetësor ku morën pjesë edhe infermieret e ekipeve të këtij programi nga QKMF-Ferizaj.

Më 24.03.2023 – në Prishtinë është mbajtur trajnimi përfaqësuesve menaxherial duke përfshirë edhe përgjegjësit e BQ dhe Koordinatorëve të Cilësisë të QKMF-ve, organizuar nga Zyra e OBSH-së, me temën „Menaxhimi i mbeturinave mjekësore në kuadër të institucioneve të tri niveleve të kujdesit shëndetësor.”

Më 30.03.2023 - Menaxhmenti i QKMF-së dhe Drejtori i DSHMS-së kanë mbajtur dy takime të ndara me koordinatorët dhe infermieret e ekipeve të Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë, dhe të Vizitave shtëpiake paliative. Qëllimi i këtyre takimeve ishte riorganizimi i punës së këtyre ekipeve pas pranimi të punëtorëve përmes kontratës Komuna e Ferizajt & Caritas Kosova, në QKMF me ç'rast janë shtuar ekipet e Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë dhe të Vizitave paliative. Orari i punës së këtyre shërbimeve është publikuar edhe në faqen zyrtare të QKMF-së me qëllim të informimit të qytetarëve.

Më 04.05.2023 - Kryeshefi i QKMF-së Dr. Albert Sherifi, si përfaqësues i QKMF-së ka marrë pjesë në punëtorinë Hartimi i Planit të veprimit për shërbimet sociale për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Ferizajt. Aty kanë qenë pjesëmarrës asambleistët, pjesëtarë të shoqatave të personave me aftësi të kufizuara si: Shoqata e Shurdhmemecëve, të verbërve etj. Aty janë dhënë propozime të ndryshme se si mund të ofrohen më së miri shërbimet shëndetësore prej QKMF-së për këto kategori.

Më 11.05.2023 - në vigjilje të Ditës Ndërkombëtare të Infermierisë në QTMF, nën përkujdesjen e kryetarit z. Agim Aliu dhe zyrës së Drejtorit të DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini me rastin e 150 vjetorit të themelimit të qytetit tonë u mbajt solemniteti për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Infermierisë me moton "Infermierët e bashkuar një forcë për ndryshim", i cili u organizua nga Këshilli Organizativ i QKMF-së për kremtimin e 150 vjetorit të qytetit me përkrahje të drejtorit të DSHMS-së. Me këtë rast, Kryetari i Komunës z. Agim Aliu, Drejtori i DSHMS-së Dr. Kemajl Emini, Drejtoresha e QKMF-së dhe Kryeinfermieri i QKMF-së, i falënderuan infermierët për kontributin në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe i uruan për Ditën

Ndërkombëtare të Infermierisë. Të gjithë infermierët u nderuan me mirënjohje, kartolinë dhe nga një lule. Për të pranishmit në fund të takimit ishte përgatitur kokteji nga QKMF.

Më 12.05.2023 - është shënuar Dita Ndërkombëtare e Infermierisë me aktivitete në sheshin e qytetit të mbajtura nën patronatin e kryetarit z. Agim Aliu dhe Drejtorit të DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini. Në këtë aktivitet, Drejtori i DSHMS-së, Drejtoresha dhe Kryeinfermieri i QKMF-së edhe këtë herë uruan infermierët për ditën e tyre dhe i falënderuan për kontributin në shërbim të qytetarëve. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Grupi i Grave të Asamblesë Komunale, personeli i QKMF-së, si dhe përfaqësues të institucioneve të shumta si: Spitalit i Përgjithshëm, IRSHP, Qendra e Shëndetin Mendor, FSK, Policia, zjarrfikësit, Shkolla e Mesme e Mjekësisë, Qendra e Kompetencës dhe Kolegji Universum që ishin pjesë e aktiviteteve demonstruese dhe të cilëve iu ndanë edhe mirënjohje.

Më 12.05.2023 - me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Infermierisë, Drejtoresha e QKMF-së bashkë me drejtorin e DSHMS-së ishin të pranishëm në ngjarjen për promovimin e **Manualit të Parë të Procedurave Standarde të Infermierisë në Kujdesin Parësor Shëndetësor** i cili është mbajtur në Hotel Emerald në Prishtinë, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Prezantimin për manualin e bëri MSc. Niman Bardhi, Zv. Drejtor i Departamentit për Zhvillim Strategjik Shëndetësor në MSH.

Më 16.05.2023 - në "Vila Gërmia" me iniciativë të Asociacionit të Komunave të Kosovës, u mbajt takimi i Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ku u diskutuan aspekte të lidhura me mirëqenien, shërbimet sociale të ofruara për grupet e cenuara si dhe reformën aktuale në fushën e shërbimeve sociale. Nga AQH dhe QKMF – Fushë Kosovë u paraqit prezantimi me titull "Kujdesi i integruar Shëndetësor dhe Social për të moshuarit me diabet mbi 65 vjeç". Ky takim u mundësua nga projekti "Joint Action for Decentralizacion", i financuar nga BE dhe menaxhuar nga zyra e BE-së në Kosovë.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) ka organizuar një cikël trajnimesh një ditore në periudhën Maj - Korrik 2023 me punëtorët shëndetësorë dhe bashkëpunëtorët në Kujdesin Parësor Shëndetësor për raportimin e sëmundjeve kronike (masovike) jongjitëse, me gjithsej 30 pjesëmarrës. Trajnimet njëditore kanë filluar të mbahen më **16 dhe 18 Maj 2023**, në hotel *Sirius* me nga 4 persona në ditë, në mesin e të cilëve ishin edhe Koordinatori për Cilësi të Shërbimeve dhe Koordinatori i SIS-it.

Më 18.05.2023 - Në QKMF dhe qendrat e tjera të qytetit, me rastin e 17 Majit - Ditës Botërore të Hipertensionit janë zhvilluar aktivitete nga ekipet e infermierëve me qëllim të ndërgjegjësimi dhe informimit të qytetarëve lidhur me sëmundjen e hipertensionit. Përveç matjes së presionit të gjakut infermierët pacientëve u ofruan edhe këshilla rreth parandalimit të hipertensionit, rëndësinë e identifikimit të hershëm, inkurajimin për ndryshimin e mënyrës së jetës, marrjen e terapisë me rregull, konsultimin me profesionistët shëndetësor, matjen e rregullt të tensionit, si dhe pasojat që mund të sjell injorimi i kësaj sëmundje.

Më 18.05.2023 - në vigjilje të Ditës Botërore të Mjekut Familjar është mbajtur takimi kolegjial i udhëheqjes së DSHMS-së, menaxhmentit të QKMF-së dhe trajnerëve të Qendrës Trajnuese me mjekët e rinj të rregullt dhe ata të angazhuar me Caritas Kosova, me qëllim të promovimit të rolit të mjekut familjar. Në këtë takim fillimisht u diskutua për rolin qendror të mjekut familjar në ofrimin e kujdesit shëndetësor personal, gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm për pacientë, për sfidat, si mos orientimi i mjekëve të rinj në specializim të Mjekësisë Familjare. Gjithashtu, u informuan se këtë vit QKMF do t'i mbështesë dhjetë mjekë për këtë specializim.

Më 19.05.2023 - në QTMF-së në përkujdesjen e kryetarit z. Agim Aliu dhe zyrës së Drejtorit të DSHMS-së me rastin e 150 vjetorit të themelimit të qytetit tonë, me organizimin e Këshillit Organizativ dhe përkrahjen e Drejtorit të DSHMS-së, u mbajt solemniteti për të shënuar Ditën Botërore të Mjekut Familjar me moton: "MJEKËT FAMILJARË- ZEMRA E KUJDESIT SHËNDETËSOR". Krahas Kryetarit Aliu dhe Drejtorit, Dr. Kemajl Emini, të pranishëm në këtë solemnitet ishin edhe drejtoresha e IRSHP, përfaqësuesi i Qendrës së Shëndetit Mendor, Dr. Mensur Qiraxhiu, familjarë të mjekëve familjarë të ndjerë, Dr. Faik Rexhepit, Dr. Nezir Luzhës dhe Dr. Ylber Muratit, anëtarët e Këshillit Drejtues, mjekë familjarë, mjekë të përgjithshëm, shefat e njësive, kryeinfermierët etj. Në fund të takimit u shpërndanë mirënjohje, kartolina mirënjohje post mortem për mjekët e ndjerë dhe mirënjohje falënderimi për institucionet shëndetësore publike.

Më 25.05.2023 – Takim në Prishtinë. Tema: *Vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë deri 3 vjet*, me ç'rast QKMF-së Ferizaj i janë dhënë donacion nga UNICEF-i 21 tableta për infermieret e këtyre vizitave dhe një laptop për koordinatoren.

Më 13.06.2023 - Me homazhe tek Varrezat e Dëshmorëve të Kombit të UÇK-së në Ferizaj, ka filluar Java e Shëndetësisë me moton “Me shnet 150” vjet , aktivitet ky që po mbahet në kuadër të shumë aktiviteteve për 150 vjetorin e themelimit të Ferizajt.

Më 13.06.2023 - Pas homazheve, në sheshin e qytetit ka filluar të bëhet edhe dhurimi vullnetar i gjakut, aktivitet ky pjesë e të cilit ishte edhe Kryetari i Komunës së Ferizajt bashkë me drejtorin e DSHMS-së, drejtues të QKMF-së dhe të gjitha institucioneve shëndetësore në Ferizaj. Të pranishmeve me një fjalë rasti u është drejtuar edhe Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, Dr. Xheladin Reçica si dhe Drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini.

Më 13.06.2023 - Në mbrëmje, në kuadër të Javës së Shëndetësisë Ferizajase u hap ekspozita e Dr. Agim Bytyçit me fotografi e dokumente nga periudha të ndryshme të zhvillimit të shëndetësisë në Ferizaj.

Më 14.06.2023 - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 150 vjetorit të themelimit të Ferizajt, me pjesëmarrjen e Kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, deputetit të Kuvendit të Kosovës, Elmi Reçica, drejtorit të DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini, menaxhmentit të QKMF-së, Spitalit Rajonal, QRSHP-së, Shëndetit mendor si dhe dhjetëra punonjësve shëndetësor u shpalos memoriali kushtuar kontributit të mantelbardhëve ferizajas ndër dekada.

Me një fjalë rasti, të pranishmëve iu drejtua edhe Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu i cili falënderoi mantelbardhët për kontributin e tyre, dhënë për shëndetin e qytetarëve, kurse drejtori i

DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini vuri theksin tek aktivitetet që po shënojnë këtë javë. Me fjalë përshëndetëse të pranishmëve iu drejtuan edhe menaxhmenti i lartë i institucioneve shëndetësore të tri niveleve në Ferizaj.

Më 14.06.2023 - u vendos pllaka përkujtimore në Shpellën e Lakuriqëve në Topillë të Shtimes dhe u mbajt ekspozitë me motive nga lufta e UÇK-së në pikën 6 të Parkut Memorial në Jezerc. Në këto aktivitete morën pjesë qindra punonjës shëndetësor, prirë nga Nënkryetari i Komunës, Lulzim Aliu, deputeti Elmi Reçica, drejtori i DSHMS-së, Kemajl Emini si dhe menaxhmentet e punonjësit e institucioneve shëndetësore në Ferizaj.

Më 15.06.2023 - Në amfiteatrin "Hyzri Varoshi" në USHAF në Ferizaj u mbajt simpoziumi i shëndetësisë ferizajase me moton "Me shnet 150 vjet - Bashkë për shëndetësinë që duam", ku u prezantuan punime nga përfaqësues të të gjitha institucioneve shëndetësore publike. Nga QKMF ishin tri prezantime: Drejtoresha, Dr. Nadire Ymeri prezantoi temën "KPSH në Ferizaj nga viti 1999", Koordinator i Cilësisë, Dr. Hesat Shatrolli prezantoi Auditin klinik "Menaxhimi dhe Trajtimi i Pacientëve të dyshuar dhe të konfirmuar COVID 19 pozitiv në QKMF-Ferizaj në periudhën Korrik-Gusht 2020", Dr. Drita Emini prezantoi temën "Vaksinimi ndër vite" dhe Kryeinfermieri i QKMF-së, Selim Bega temën "Infermiera ferizajase dje, sot dhe nesër". Me këtë simpozium shkencor u mbyll Java e Shëndetësisë Ferizajase.

Më 26.06.2023 - Me nismën e DSHMS dhe në bashkëpunim me DA, të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt janë pajisur me çanta të ndihmës së parë. Për këtë qëllim në Qendrën Trajnuese u mbajt edhe trajnimi për dhënien e ndihmës së parë me arsimtarët dhe profesorët e edukatës fizike të këtyre shkollave. Në hapjen e këtij trajnimi ishin të pranishëm drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini, drejtori i DKA-së, z. Afrim Llabjani dhe zëvendës drejtori i QKMF-së, Dr. Afrim Abazi, të cilët e cilësuan si shumë të rëndësishme këtë nismë. Trajnimi u mbajt nga infermierët, Ali Shaqiri, Afërdita Muharremi dhe Selim Bega trajnerë të QTM-së. Në grupin e parë të trajnimit ishin arsimtarët e shkollave të mesme të ulëta, kurse të nesërmen trajnimi ka vazhduar me grupin e dytë, me profesorët e shkollave të mesme të larta.

Më 27.06.2023 - në FC Ferizaj me grupmoshat U15, u shënua Dita Ndërkombëtare Kundër Drogave dhe abuzimi me lëndë narkotike. Tema e ligjëruar nga Ali Shaqiri, Selim Bega dhe Sherif Topalli, kishte për qëllim vetëdijesimin dhe pasojat e përdorimit të drogave dhe lëndëve narkotike. Në ligjëratë ku ishte prezent edhe Drejtori i DSHMS Dr. Kemajl Emini, u diskutua për numrin e madh të përdoruesve të drogës dhe lëndëve narkotike në vendin tonë. Fokusi ishte tek parandalimi, që të kemi një rini të shëndoshë.

Më 30.06.2023 - filluan punën laboratorët në QMF 8 në fshatin Dardani dhe QMF 5 në Komogllavë. Me këtë rast, Nënkryetari i Komunës së Ferizajt, Lulzim Aliu, bashkë me Drejtorin e DSHMS-së, Dr. Kemajl Eminin, Drejtorin e QKMF-së Dr. Nadire Ymerin, zv. Drejtorin e QKMF-së Dr. Afrim Abazin si dhe Dr. Xhevdet Haxhidemën, kanë vizituar Qendrat e Mjekësisë Familjare në fshatin Dardani dhe Komogllavë. Në vazhdim këto dy qendra do të punojnë me kapacitete të plota, duke përfshirë këtu edhe sektorin e stomatologjisë dhe shërbimet bazë të

laboratorit. Të njëjtën ditë është vizituar edhe QMF në Neredime, ku ka filluar puna pas renovimit në tërësi. Në këtë qendër shëndetësore do të ofrohen shërbimet e mjekut familjar dhe të stomatologut, ndërsa pritet që së shpejti të fillojnë së funksionuari edhe shërbimet laboratorike.

Më 14.07.2023 - Zv. Drejtori i QKMF-së, Dr. Afrim Abazi dhe Kryeshefi i DMF-së, Dr. Albert Sherifi, pritën në vizitë përfaqësues të KFOR-it Amerikan. Palët u dakorduan për organizimin e një trajnimit të përbashkët për Shërbimin Emergjent Primar të QKMF-së dhe Emergjencës së KFOR-it Amerikan.

Më 09.08.2023 - Në Zyrën e takimeve të Kryetarit të Komunës, z. Agim Aliu u mbajt takimi për komunitete ku mori pjesë edhe Drejtoresha e QKMF-së. Në këtë takim u diskutua për shqetësimet dhe ankesat e pjesëtarëve të komuniteteve. Ishte takim për shkëmbimin e përvojave ndërmjet komiteteve për komunitete Ferizaj, ku u bashkëngjijt edhe OSBE-ja.

Më 06 dhe 07.09.2023 - në Hotel "Emerald" në Prishtinë u mbajt Konferencën e Tetë Ndërkombëtare e Mjekësisë Familjare ku kanë marrë pjesë 33 punëtorë shëndetësor nga QKMF - Ferizaj, për të cilët institucioni ynë i ka mbuluar shpenzimet e kuotizimit.

Më 08.09.2023 - në QKMF për herë të parë u shënuar Dita Botërore e Ndihmës së Shpejtë. Shënimi i kësaj dite përkon me vitin jubilar të shënimit të 150 vjetorit të qytetit me aktivitete të shënuara nga Zyra e Kryetarit. Të pranishëm në këtë aktivitet, krahas mjekëve, infermierëve, vozitësve e stafit mbështetës, ishin edhe Nënkryetari i Komunës, z. Lulzim Aliu, Drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini, Drejtoresha e QKMF-së edhe Dr. Nadire Ymeri, të cilët iu drejtuan të pranishmëve me fjalë rasti bashkë me Kryeinfermierin e QKMF-së, z. Selim Bega. Me këtë rast, ata falënderuan personelin e Shërbimit Emergjent për angazhimin e tyre në trajtimin e rasteve në terren. Nënkryetari dhe Drejtori shprehën gatishmëri për mbështetjen dhe avancimin e Shërbimit Emergjent Primar, në ofrimin e kushteve më të mira dhe furnizimin me pajisje dhe autoambulanca të reja.

Më 08.09.2023 - në Zyrën e Ministrit të Shëndetësisë, është organizuar një ceremoni e shkurtër, me ç'rast Ministri Dr. Arben Vitia, drejtorëve të QKMF-ve i ka dorëzuar certifikatat e pjesëmarrësve të trajnimit *Dhuna në baza gjinore* që është mbajtur prej 08 deri 30 maj 2023.

Më 12.09.2023 - në Hotel Emerald u mbajt takimi për promovimin e Udhërrëfyesit për përdorimin e antibiotikëve. Në këtë takim, Ministri Dr. Arben Vitia foli për përgjigjen qeveritare në përballjen me rezistencën mikrobike. Ndërsa për kërcënimin nga rezistenca antimikrobike sipas Udhëzuesit për përdorimin e antibiotikëve në KPSH foli Dr. Lul Raka i cili e udhëhoqi takimin. Lidhur me këtë temë bëri një prezantim edhe Robert Show Kryetar *International Centre for Antimicrobial Resistance Solutions* dhe Kryetar i *Shoqatës Evropiane të Mikrobiologjisë Klinike dhe Sëmundjeve Ngjitëse*, i cili pas këtij takimi bashkë me Dr. Lul Rakën e vizitoi qendrën tonë. Mysafirët nga Danimarka u interesuan për organizimin e punës te ne, shërbimet përdorimin e antibiotikëve, sfidat etj. të dhëna këto të nevojshme për hartimin e projektit të tyre mbi funksionimin e shërbimeve shëndetësore në QKMF.

Më 29.09.2023 - Kryeshefi i QKMF-së Dr. Albert Sherifi mori pjesë në ditën e tretë të Simpoziumit ndërkombëtar "Sëmundjet kronike jo ngjitëse në Kosovë" që u mbajt në hapësirat e Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Më 26.09.2023 – u shënua Dita Botërore e Farmacistëve me një tryezë pune në Qendrën Trajnuese me temën “Farmacia ferizajase ndër vite“ si dhe me ligjëratën ”Praktikat e mira farmaceutike” në Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Elena Gjika” – me nxënësit e profilit të farmacisë së kësaj shkolle.

Më 02.10.2023 - kanë filluar aktivitetet sensibilizuese kundër kancerit të gjirit. Aktivitetit i parë është mbajtur tek mamografi në QKMF, ku Drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini, ka paralajmëruar aktivitete të shumta me qëllim të vetëdijesimit të grave për rrezikun nga kjo sëmundje. Gjithashtu, ai ka ftuar gratë pas moshës 40 vjeçare të bëjnë mamografinë. Ndërsa drejtoresha e QKMF-së Nadire Imeri, ka njoftuar se këto shërbime do të ofrohen falas.

Më 04.10.2023 - në QKMF u shënua Java e gjdhënies me një ligjëratë dhe diskutim ku morën pjesë disa nëna gjdhënëse. Takimin e udhëhoqi Koordinatorja e Programit të Vizitave për Nëna dhe Fëmijë 0 deri 3 vjeç, Haxhere Bërkolli, ndërsa në diskutim u përfshinë edhe Drejtoresha Dr. Nadire Ymeri, pastaj Dr. Ganimete Bajrami dhe kryeinfermierja, Kefsere Vata. Krahas temës së përmendur u diskutua edhe rreth ndërgjegjësimit të grave për rëndësinë që ka zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit.

Më 05.10.2023 - u hodh gurthemeli i Qendrës së Mjekësisë Familjare 2 në Ferizaj bashkëfinancim i Komunës së Ferizajt me Qatar Charity. Kjo ngrehinë do të shtrihet në mbi 1745m² hapësirë dhe do të jetë një nga qendrat më moderne shëndetësore në Ferizaj.

Më 06-10.10.2023 - për nder të "Tetorit rozë", muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, ekipet e mjekëve dhe infermierëve të QKMF-Ferizaj kanë mbajtur ligjëratë në shkollat të mesme të qytetit të Ferizajt me nxënësit e klasave të 12-ta dhe mësimdhënëset e tyre. Gjimnazi shkencor "Kuvendi i Arbrit", Gjimnazi gjuhësor-shoqëror "Dr. Shaban Hashani", Shkolla e mesme ekonomike "Faik Konica", Shkolla e mesme e mjekësisë "Elena Gjika", Shkolla e mesme teknike "Pjetër Bogdani" dhe Qendra e Kompetencës ishin shkollat ku u ligjërua mbi "Parandalimin e kancerit të gjirit dhe vetëkontrollin e gjirit". Përveç ligjëratave, me qëllim të informimit të popullatës lidhur me kancerin e gjirit, infermieret kanë shpërndarë broshura në Çerdhen "Ardhmëri jonë", në Sheshin e Qytetit dhe në Qendrën Tregtare Village. Këto aktivitete janë organizuar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe udhëheqja e QKMF-së.

Më 09.10.2023 - ka filluar vaksinimi i qytetarëve me vaksinën kundër gripit sezonal sipas grupmoshave. Fillimisht janë vaksinuar të moshuarit mbi 65 vjeç, pastaj personat me sëmundje kronike, gratë shtatzëna dhe lehonat, personeli shëndetësor dhe së fundi fëmijët me indikacione shëndetësore.

Më 11.10.2023 - janë njoftuar qytetarët për shtimin e tri vaksinave të reja në kalendarin e vaksinimit të rregullt: HPV- vaksinë kundër kancerit të qafës së mitrës, vaksina ROTARIX- vaksinë kundër infeksioneve me roavirusë që do të aplikohen në dy doza, doza e parë tek foshnjat

dymuajshe, kurse doza e dytë në moshën katërmuajshe dhe vaksina PNEUMOWAX - vaksinë për infeksionet e traktit respirator, e cila do të aplikohet për foshnjat e moshave dymuajshe, doza katërmuajshe dhe e fundit dymbëdhjetëmuajshe.

Më 13.10.2023 - filloi ndërtimi i objektit të ri të QKMF-së investim 2,5 milionësh bashkëfinancim ky mes Komunës së Ferizajt dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Në këtë solemnitet të pranishëm ishin: Ministri i Shëndetësisë, Dr. Arben Vitia, Kryetari i Komunës së Ferizajt, z. Agim Aliu, Drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini, menaxhmenti i QKMF-së, mjekët që vunë themelet e shëndetësisë ferizajase, mjekë infermierë dhe personel mbështetës nga QKMF. Objekti i ri QKMF-së do të shtrihet në afro 5000m2 sipërfaqe, mbi trefishi i objektit ekzistues.

Më 20.10.2023 – në shkollën "Ganimete Tërbeshi" në Ferizaj, në shkollën e fshatit Komogllavë, në Dardani si dhe në shkollën e fshatit Neredime janë mbajtur takime me gratë në komunitet me qëllim të vetëdijesimit të tyre lidhur me rëndësinë e parandalimit dhe zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit.

Më 25.10.2023 - kompania kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike (KEDS) ka organizuar aktivitetin për simulimin / ushtrimin e evakuimit emergjent në ndërtesën qendrore të KEDS-it në Ferizaj, i mbajtur në kuadër të javës evropiane për siguri dhe shëndet në punë dhe për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore sipas ligjeve në fuqi. Ky aktivitet është realizuar sipas 'Planit të ushtrimit për evakuim dhe shpëtim' me pjesëmarrje të ekipit të Shërbimit Emergjent Primar të QKMF-së, ekipeve nga Policia, Shërbimi i zjarrfikësve, ekipi i rrjetit të KEDS-it dhe punëtorët që ishin prezent në objekt. Në fund të aktivitetit u ndanë mirënjohje për pjesëmarrësit.

Më 30.10.2023 - aktivitetet ndërgjegjësuere të organizuara gjatë "Muajit Rozë" me moton "Zbulimi i hershëm, mbijetesë", u përmyllun me marshin në sheshin e qytetit.

Më 08.11.2023 - për nder të Ditës Botërore të Radiologjisë, Drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini dhe Drejtoresha e QKMF-së, Dr. Nadire Ymeri me disa anëtarë të stafit menaxherial vizituan Kabinetin e Radiologjisë, me ç'rast falënderuan personelin e kësaj njësie për punën e palodhshme dhe kontributin e dhënë gjatë Tetorit - Muajit Rozë. Gjithashtu, të dy drejtorët treguan gatishmëri për përmirësimin e kushteve të punës dhe zhvillimin Njesisë së Radiologjisë.

Më 08.11.2023 - menaxhmenti i QKMF-së dhe personeli i Dispanserit të Sëmundjeve të Mushkërive pritën përfaqësueset e Fondit Global znj.Olga Avdeeva-Menaxhere e Portofolias për Kosovë, znj.Samantha Akahpo, znj. Majlinda Gjocaj - Menaxhere Kombëtare e Programit të Tuberkulozit dhe Dr.Lulzim Çela -Menaxher i Programit të TB. Drejtoresha e QKMF-së i falënderoi për bashkëpunimin, mbështetjen me pajisje mjekësore nga CDF për testimin me Gen-Expert, si dhe për vizitën e tyre në DSM,të përzgjedhur si njësinë më të dalluar ndaj regjioneve tjera në ofrimin e shërbimeve mjekësore antituberkulare për pacientët në Regionin e Ferizajt.

Më 14.11.2023 - për nder të Javës së Diabetit, në të gjitha QMF-të e qytetit të Ferizajt, ekipe të infermierëve u angazhuan në matjen e nivelit të glukozës në gjak për pacientët e rastit dhe ofruan këshilla për pacientët me diabet.

Më 16.11.2023 - në QMF 1 u organizua *Sofra Diabetike* nga personeli i këndit të shërbimeve për personat me diabet. Kjo sofër është tradicionale dhe ka për qëllim promovimin e ushqimeve të shëndetshme që duhet të përdorin personat me diabet. Në këtë ngjarje, veç

punëtorëve shëndetësor, të pranishëm ishin edhe një numër i pacientëve që aktualisht trajtohen në këtë qendër.

Më 21.11.2023 - Nga Ministria e Shëndetësisë është mbajtur një takim me qëllim të promovimit të Manualit të dytë të procedurave standarde të infermierisë, Infermiera në Kujdesin Primar Shëndetësor - Kujdesi infermior në komunitet. Me këtë rast na janë dhënë 15 libra (manuale) të cilat janë shpërndarë në QKMF nga kryeinfermieri.

Më 01.12.2023 - për nder të 1 Dhjetorit, Ditës Botërore të HIV-AIDS, ekipi i QKMF-së mbajti ligjëratë në Gjimnazin "Kuvendi i Arbërit" për nxënësit e klasës XII. Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe Drejtori i DSHMS-së.

Më 05.12.2023 - në hapësirat e QTMF-së u mbajt takimi me karakter regjional në kuadër të projektit të AQH-së (Accessible Quality Healthcare) "Projekti shëndetësor i qasshëm dhe cilësor". Ky projekt ka për qëllim njoftimin e komunave me aktivitetet dhe proceset e implementimit të tyre, si dhe shkëmbimin e përvojave në mes të komunave regjionale. Në këtë takim, përveç përfaqësuesve të QKMF-Ferizaj dhe atyre nga Lipjani, Kaçaniku, Hani i Elezit dhe Shtimja, ishte i pranishëm edhe Drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emmini, me ç'rast foli për shëndetësinë në Komunën e Ferizajt. Në fazën e tretë të projekteve të AQH-së, që do të nis në fillim të vitit të ardhshëm, përfituese do të jenë edhe komunat e tjera, në mesin e të cilave edhe QKMF - Ferizaj.

Më 06.12.2023 - në Hotel "Internacional" është mbajtur tryeza "16 ditë të aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore" organizuar nga MSH, ku të pranishëm ishin përfaqësues të QKMF-ve dhe institucioneve të tjera. Pas fjalëve të zyrtares së lartë për barazi gjinore, sekretarit të përgjithshëm të MSH-së, kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë për Barazi Gjinore dhe prezantimit të mjekut ligjor, nga Zyra për dhunë dhe barazi gjinore në Policinë e Kosovës, pati edhe diskutim të hapur mbi këtë temë. Në fund u janë dhënë rekomandimet, për plotësimet e formularëve mbi dhunën në familje dhe u apelua që mjekët familjarë të paraqesin çdo rast të dhunës në familje, në asnjë mënyrë të mos i fshehin ato, sepse fshehja e dhunës mund të ketë si pasojë rastet me fatalitet.

Më 08.12.2023 - pas lajmit për suksesin e realizimit të vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë të kryera nga ekipet e të gjitha ambulancave dhe Qendrave të Mjekësisë Familjare, dy ekspertë të UNICEF-it, nga zyrat regjionale të vendeve tjera, kanë vizituar shërbimin e Kujdesit Antenatal në QMF1, si dhe bashkë me ekipin e vizitoreve në shtëpi të QMF2, kanë shkuar në vizitë në një familje ku infermieret kanë kryer vizitën sipas terminit të planifikuar.

Më 08.12.2023 - në kuadër të përmbushjes së obligimeve për informim dhe edukim në fushën e Shëndetit Seksual dhe Riprodhues (SHRS) dhe mjeteve kontraceptive, u mbajt një ligjëratë promovuese dhe edukative mbi këtë fushë me një grup të grave të komunitetit RAE nga Grupi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor në kuadër të QKMF-së. Takimi u mbajt në zyrën e Organizatës BRAN- Bashkimi Rinor e Ardhmja e Ndritur.

Më 12 dhe 13.12.2023 - në QTMF është zhvilluar trajnimi dyditor nga Agjencia për Informim dhe Privatësi. Komisionerja për Informim dhe Privatësi, znj. Krenare Sogojeva - Dërmaku dhe Drejtori i Departamentit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Valon Kryeziu për personelin e Kujdesit Primar Shëndetësor kanë mbajtur këtë trajnim, me qëllim informimit të

tyre dhe sigurimit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave në QKMF-Ferizaj. Përfaqësuesit nga Agjencia kanë diskutuar përgjegjësitë e QKMF-së si kontrollues i të dhënave personale të ndjeshme, duke theksuar detyrimet ligjore rreth privatësisë dhe konfidencialitetit të pacientëve, ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave, si dhe ndërlidhjen e sistemeve. Ky trajnim është mbajtur me kërkesën e drejtuesve të QKMF-Ferizaj, sipas rekomandimeve të Zyrës së Avokatit të Popullit.

Më 22.12.2023 - në Teatrin e Qytetit u mbajt takimi përmbyllës i aktiviteteve vjetore të shëndetësisë, organizuar nga DSHMS. Në këtë solemnitet, krahas personelit shëndetësor dhe mysafirëve nga institucionet shëndetësore, ishin të pranishëm edhe Kryetari Aliu dhe përfaqësues të tjerë të qeverisjes lokale. Drejtori DSHM-së, Drejtoresha e QKMF-së dhe Drejtoresha e QPS-së prezantuan rezultatet e punës gjatë vitit 2023, ndërsa Kryetari Aliu i falënderoi mantelbardhët dhe drejtuesit e institucioneve shëndetësore në Ferizaj, që begatuan festën e vitlindjes së Ferizajt.

Më 28.12.2023 - në Prelez të Muhaxherëve u vendos gurthemeli i objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në bashkëpunim me shoqatën *Qëndresa Kosovare*. Kjo qendër shëndetësore do të ofrojë shërbime shëndetësore për banorët e këtij fshati dhe zonave të tjera përreth.

Numri i përgjithshëm i të gjitha shërbimeve shëndetësore në QKMF gjatë **vitet 2023** është **1 017 536**, nga të cilat **280 849** janë vizita mjekësore, **701 467** shërbime infermierike dhe shërbime të tjera, **35 220** janë shërbime stomatologjike.

TRUPAT PROFESIONALE TË QKMF – së KËSHILLI DREJTUES DHE ZYRA E DREJTORIT

Këshilli Drejtues si organi më i lartë i udhëheqjes së QKMF – së, gjatë ***periudhës Janar-Dhjetor*** ka mbajtur **gjashtëmbëdhjetë mbledhje**, për të cilat janë mbajtur rregullisht procesverbalet, që pas aprovimit janë protokolluar dhe ruhen në arkiv. Në këto mbledhje ndër temat kryesore që u shqyrtuan ka qenë të lidhura me organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës në QKMF; disa prej temave të diskutuara janë paraqitur në vazhdim sipas datave të mbledhjeve:

Më 05.01.2023 - Ka hyrë në fuqi kontrata e nënshkruar nga Komuna e Ferizajt dhe Caritas Kosova (më 29.11.2022) për "Shërbimet e Kujdesit social, shëndetësor, shtëpiak dhe ambulator në QKMF" dhe kanë filluar përgatitjet për angazhimin e punëtorëve.

Më 13.01.2023 - Është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i *Planit të punës për vitin 2023* dhe në të njëjtin takim është shqyrtuar edhe marrëveshja e bashkëpunimit mes QKMF-së dhe NPL "Ambienti" SHA marrëveshje kjo që ka përfunduar dhe për shkak të mospërmblidhjes së plotë të obligimeve nga ana e NPL "Ambienti" SHA është vendosur nga Këshilli Drejtues që të mos vazhdohet më tej. Gjithashtu është shqyrtuar marrëveshja me bashkëfinancim mes Komunës së Ferizajt dhe Islamic Relief, për pranimin e mjekëve dhe infermierëve.

Më 23.01.2023 - Është shqyrtuar dhe aprovuar *Draft Raporti i Punës për vitin 2022* i cili pas plotësimit dhe aprovimit është përcjellë në DSHMS.

Më 08.02.2023 - Këshilli Drejtues ka shqyrtuar Qarkoren Informative Nr. 02/2023, të aprovuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, që ka për qëllim: 1) Zbatimin e Nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-125 për shëndetësi me të cilin përcaktohet që Kujdesi Primar Shëndetësor sigurohet në pajtim me politikat, planet dhe standardet e përcaktuara me aktin nënligjor të nxjerrë nga MSH dhe 2) Zbatimin e UA Nr.04/2020 në Kujdesi Parësor Shëndetësor me theks të veçantë ofrimin e shërbimeve shëndetësore, referimin e brendshëm dhe të jashtëm dhe profesionistët shëndetësor që duhet të ofrojnë shërbime shëndetësore në KPSH.

Më 13.02.2023 - në mbledhjen e Këshillit Drejtues, Komisioni për shqyrtimin e Draft-Statutit të QKMF-së ka marrë vendim rreth përcjelljes së Draft-Statutit të QKMF-së më tutje në Kuvendin e Komunës.

Më 20.03.2023 - është diskutuar rreth mundësisë së formimit të një komisioni për rregullimin e koeficienteve të punëtorëve, të cilët kanë ankesa dhe janë të pa kënaqur me hyrjen në fuqi të Ligjit të Pagave. Në të njëjtin takim është diskutuar edhe rreth sistemimit të punëtorëve të pranuar përmes marrëveshjes Caritas Kosova & Komuna e Ferizajt.

Më 22.03.2023 - Këshilli Drejtues ka diskutuar rreth nevojës për organizimin e trajnimeve për personelin e Shërbimit Emergjent Primar dhe Vizitave Shtëpiake Paliative, si dhe për formimin e ekipeve që do të merren me regjistrimin e barnave me afat të skaduar që duhet të asgjësohen.

Me rekomandim të Inspektorëve të punës të bërë nga vizita e tyre më 28.02.2023 janë bërë kërkesat:

- Kërkesa për inicim me vlerë minimale për trajnimin e stafit për përdorimin e aparateve kundër zjarrit,
- Kërkesa për inicim të procedurave për vlerësim të riskut për rrezikshmëri të vendeve të punës,
- Kërkesa për testim dhe mbushje të bombolave kundër zjarrit.

Më 28.04.2023 - lidhur me angazhimin e punëtorëve në kujdestari, në muajt që kanë shumë festa ata po i kalojnë 40 orë punë, është marrë vendim që t'u mundësohet pagesa e orëve shtesë (mbi 40) për muajt prill dhe maj.

Më 05.05.2023 - Drejtorit i DA-së, z. Afrim Llabjani ka kërkuar nga menaxhmenti i QKMF-së që të gjithë punëtorët e arsimit të komunës sonë t'i pajisen me certifikata mjekësore. Kjo kërkesë është mbështetur në Ligjin me Nr. 04/L -161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, si dhe në kërkesën e Inspektoratit të Punës. Meqë bëhet fjalë për numër të madh të punëtorëve të arsimit në komunën tonë (rreth 2000), është vendosur që ata të paraqiten sipas lokacionit të shkollave të ndahen në katër qendrat e qytetit (QKMF, QMF 1, QMF 2 dhe QMF 4).

Më 25.05.2023 - në mbledhjen e Këshillit Drejtues është shqyrtuar Qarkorja Informative Nr. 05/2023 drejtuar institucioneve shëndetësore nga MSH me qëllim *Njoftimin për zbatimin e Listës së produkteve Mjekësore dhe Materialit Shpenzues*.

Më 20.07.2023 - Këshilli Drejtues i QKMF-së ka shqyrtuar dhe aprovuar Raportin gjashtëmujor janar - shtator.

Më 17.10.2023 - është shqyrtuar dhe aprovuar Draft-Raporti nëntëmujor i punës në QKMF (janar-shtator) nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

Më 21.12.2023 - Në Mbledhjen e Këshillit Drejtues është aprovuar të bëhet plotësimi i Draft- Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe procedimi i saj për aprovim të mëtejme në Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal.

DONACIONET

Gjatë periudhës janar-shtator në QKMF Kanë arritur edhe donacione.

Më 07.07.2023 - ka arritur donacioni nga GIZ - Pajisje për grumbullimin e mbeturinave medicinale:

- Kutit mbeturinash të mprehta 2.5 L - gjithsej 161
- Qese mbeturinash infektive 400*780mm - 3632
- Qese mbeturinash infektive 800*1100mm - 2018
- Kosh i zyrës - 14
- Kosh i mbeturinave infektive 60L i verdhë- 10
- Kosh i mbeturinave të përgjithshme 60 L i zi - 10

Më 25.08.2023 - është pranuar donacion nga Projekti i AQH-së (Accessible Quality Healthcare) një aparat - analizator për HbA1c me 500 teste (reagensë HbA1c), një aparat-glukometër me 700 lanceta dhe 700 shirita të glikemisë, si dhe dy çanta me pajisje për ndihmë mjekësore emergjente. Duke iu falënderuar kësaj përkrahje, nga data 28.08.2023 në laboratorin e QKMF-së, për pacientë me diabet me fletë-udhëzim nga mjeku, do të bëhet analiza e hemoglobinës së glikuar gjegjësisht nivelet mesatare të glikemisë në tre muajt e fundit.

KËSHILLI PROFESIONAL DHE ZYRA E KRYESHEFIT TË DMF (DEPARTAMENTIT TË MJEKËSISË FAMILJARE)

Zyra e Kryeshefit të Departamentit të Mjekësisë Familjare gjatë **vitet 2023** është angazhuar në menaxhimin e punës nëpër njësi dhe sistematizimin e stafit nëpër QMF pas angazhimit të mjekëve përmes kontratës me Caritas Kosova. Më 24 shkurt, 23 mars, 27 mars, 6 qershor, 11 gusht, 26 shtator dhe 27 dhjetor, janë mbajtur mbledhje të Këshillit Profesional ku kanë raportuar shfatat e njësive dhe janë shqyrtuar çështje të lidhura me mbarëvajtjen e punës nëpër njësi. Nëpërmjet vizitave të shpeshta në terren, është njoftuar me rrjedhën e procesit të punës, nevojat e personelit dhe vështirësitë në ofrimin e shërbimeve më cilësore.

Gjatë kësaj periudhe Kryeshefi i DMF ka marrë pjesë nëpër takime dhe aktivitete, krahas drejtoreshës dhe zëvendës-drejtorit të QKMF-së. Po ashtu, janë mbajtur edhe takime të Këshillit Profesional gjatë të cilave është diskutuar rreth detyrave, angazhimeve dhe çështjeve të tjera thelbësore për rrjedhën e procesit të punës. Ndërsa si preokupim permanent i Zyrës së Kryeshefit

edhe më tej mbetet angazhimi në monitorimin e mbarrëvajtjes së procesit të punës dhe realizimit të objektivave në vijim:

1. Respektimi i orarit të punës nëpër njësi nga stafi shëndetësor dhe ai mbështetës;
2. Përpilimi i orareve për kujdestaritë e të dielave dhe festave;
3. Vizitat mbikëqyrëse nëpër njësitë e QKMF-së;
4. Takimet dhe kontaktet e vazhdueshme me shefat e njësive;
5. Vazhdimi i ligjëratave dhe trajnimeve për stafin shëndetësor.

Zyra e Kryeinfermierit

Shërbimet infermierike në QKMF gjatë **vitit 2023** përbëjnë mbi 70% të volumit të përgjithshëm të punës në këtë institucion, prandaj edhe kërkojnë një menaxhim dhe përkushtim të punës infermiore si tërësi. Në fillim të vitit është bërë plani i punës për vitin 2023 në të cilin janë evidentuar ngecjet në vitin paraprak dhe janë vënë prioritetet në infermieri për këtë vit. Si ngecje janë evidentuar:

- Rënia e numrit të vizitat shtëpiake paliative,
- Rënia e numrit të vizitave në *Shërbimin e vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë nga 0-3 vjeç*,
- Pamjaftueshmëria e personelit në njësinë e Emergjencës Primare, si dhe
- Vështirësitë në organizimin e orareve të të shtunave.

Prandaj, si prioritet janë caktuar përmirësimi i këtyre shërbimeve si:

- Vizitat shtëpiake paliative,
- Shërbimi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë,
- Plotësimi i personelit të Emergjencës Primare,
- Plotësimi i personelit nëpër njësitë e tjera, veçanërisht nëpër QMF-të periferike dhe laboratorët e këtyre QMF-ve,
- Ri-licencimi i infermierëve pasi që në tremujorin e parë të këtij viti u kanë sakduar licencat mbi 90% të infermierëve.

Në bazë të këtyre prioritetëve kemi synuar që gjatë vitit 2023 të rikthejmë cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të ngacura, gjë që është mundur në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me Caritas Kosova për angazhim të stafit shëndetësor.

Në muajin janar, në bashkëpunim me koordinatoren e EVP-së për infermierë, kemi dërguar planin e EVP-së për vitin 2023 për akreditim, i cili edhe është akredituar. Ndërkohë, kemi filluar me aplikimin e infermierëve për ri-licencim. Vlen të theksohet se të gjithë infermierëve të QKMF-së, duke përfshirë edhe ata me Caritas, u janë plotësuar kushtet për fitimin e pikëve akredituese

me programin e EVP-së, si dhe trajnimeve specifike që kemi organizuar për profile të caktuara të infermierëve në institucionin tonë, pa pasur nevojë të shkojnë në trajnime apo konferenca me pagesë për të përfituar pikë akredituese.

Në muajin prill me pranimin e infermierëve të angazhuar përmes Caritas Kosovës, është plotësuar së pari mungesa e infermierëve në SHEP, pastaj në shërbimet e tjera të caktuara si prioritete, si dhe nëpër QMF- periferike dhe AMF-të. Pas shpërndarjes së stafit nga QMF 2 nëpër të gjitha QMF-të periferike i kemi caktuar nga 3-4 infermiere, varësisht nga nevojat e këtyre qendrave për staf, si p.sh. Në QMF3 – kemi dërguar pesë infermiere, në QMF 5 kemi tri infermiere, QMF 6 kemi tri infermiere, QMF 7 katër infermiere, QMF 8 katër infermiere, QMF 9 tri infermiere, AMF Varosh tri infermiere, AMF Gaçkë dy infermiere dhe AMF Talinoc dy infermiere.

Aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë këtij nëntëmuajori

05.01.2023 - është mbajtur një takim virtual me kryeinfermierë të njësive ku është kërkuar të hartojnë planet e punës për secilën njësi për vitin 2023, si dhe janë përcaktuar pikat dhe direktivat e ecursisë së punës për këtë vit.

13.01.2023 - meqenëse infermiereve të punësuar në QKMF do t'u skadonin licencat në janar të këtij viti, kemi organizuar një trajnim njëditor me kryeinfermieret dhe me nga një infermiere prej secilës njësi, të cilat do t'u ndihmojnë infermierëve të tjerë në përditësimin e të dhënave dhe aplikimin online për rilicencim në OIK.

14.01.2023 - Në karvanin e vaksinimit, organizuar nga MSH, kundër gripit sezonal dhe Covid 19 janë angazhuar krahas mjekut dhe dy infermiere nga Shërbimi i vaksinimit, si dhe dy infermiere në stazh, si ndihmës infermiere në autobusin e vaksinimit në qendër të qytetit.

17.01.2023 - u mbajt mbledhja e parë me kryeinfermierë të njësive të QKMF-së, me këto pika të rendit të ditës: 1) Mbarëvajtja e punës nëpër njësi, 2) Mënyra e arritjes së objektivave për 2023, si dhe 3) Rilicencimi i infermierëve. U raportua se procesi i aplikimit po shkon në rregull dhe se pothuaj të gjithë infermierët kanë tashmë pikët e nevojshme që iu nevojiten për rilicencim që është edhe rezultat i punës së madhe të EVP-së gjatë këtyre katër viteve.

24.01.2023 - në bashkëpunim me koordinatoren e EVP-së, është dërguar për akreditim plani i “Ligjëratave në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional” për vitin 2023.

15.02.2023 - Takim i organizuar nga MSH me kryeinfermierë të QKMF-ve në nivel vendi, mbajtur në Hotel Internacional në Prishtinë. Tema: Vijimi i kryerjes së stazhit për nxënësit dhe studentët e diplomuar në infermieri, rregullat dhe përgjegjësitë e kryeinfermierit, stafit menaxhues të QKMF-së dhe infermierëve në mentorimin e kryerjes së stazhit/praktikës nëpër QMF. Kryeinfermieri i QKMF-së, në emër të kryeinfermierëve të të gjitha QKMF-ve, ka kërkuar nga zyrtarët e MSH-së që të hartohet një rregullore për këtë qëllim ku do të përfshihen rregullat e

përcaktuara dhe kjo rregullore t'u shpërndahet të gjitha QKMF-ve, spitaleve dhe institucioneve relevante të shëndetësisë në mbarë vendin.

15.03.2023 - Në kuadër të marrëveshjes me Caritas Kosova është pranuar grupi i parë infermierëve të cilët u caktuan në Emergjencën Primare dhe laborator. Kurse nga grupi i dytë infermieret janë caktuar në shërbimin e Vizitave shtëpiake paliative dhe Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë.

21.03.2023 - në bashkëpunim me AMC në sallën e telemjekësisë së SHSKUK-së, është mbajtur trajnim për nëna dhe fëmijë, ku kanë marrë pjesë 7 infermiere që aktualisht janë të angazhuara në këtë shërbim.

23.03.2023 – U mbajt mbledhja e radhës me kryeinfermierë të njësive, ku si pikë e rendit të ditës ishte sistemimi i infermierëve të pranuar me Caritas Kosova, plotësimi i radhëve me infermierë në shërbimet e cekura më lartë, si dhe nëpër QMF-të periferike dhe AMF-të.

23.03.2023 - Mbledhje me kryeinfermierë të njësive – ku si pikë e rendit të ditës ishte sistemimi i infermierëve të pranuar nga Caritas Kosova dhe plotësimi i radhëve me infermierë në shërbimet e cekura më lartë si dhe nëpër QMF periferike dhe AMF.

25.04.2023 - mbledhja e tretë me kryeinfermierë të njësive, riorganizimi i vizitave shtëpiake të kujdesit paliativ si dhe shërbimit për nëna dhe fëmijë pas angazhimit të infermierëve me Caritas këto shërbime tashmë janë kompletuar me infermierë., si dhe shënimi i ditës së infermierisë me 12 Maj.

05.05.2023 - mbledhje e radhës me kryeinfermierët e njësive, Dita ndërkombëtare e Infermierisë, organizimi, ndarja e përgjegjësisë dhe detyrat të cilat duhen të kryhen deri në këtë datë nga kryeinfermierët.

19.04.2023 - është organizuar trajnimi një ditor "Dhuna në baza gjinore" në bashkëpunim me MSH.

Nga data 08.05.2023 deri më 29. 05.2023 në bashkëpunim me AMC-UNICEF dhe MSH në QZHMF në Prishtinë janë trajnuar tri grupe nga 7 infermieresh nga “Shërbimet për nëna dhe fëmijë”.

11.05.2023 - në Qendrën trajnuese është mbajtur një takim nga Kryetari i komunës z.Aliu dhe Drejtori i DSHMS z. Emini me menaxhmentin e QKMF-së dhe Infermierët e QKMF me rastin e ditës së Infermierisë. Me këtë rast Kryetari Aliu shpërndau mirënjohje për infermierët e QKMF për angazhimin e palodhur dhe në vazhdimësi në shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve.

12.05.2023 - është shënuar Dita ndërkombëtare e Infermierisë në qytet me improvizim të rasteve të emergjencës, matje e glikemisë, Tensionit arterial etj. ku morën pjesë dhe ekipe infermierësh nga Spitali Rajonal, IRSHP, FSK, shkolla e mesme e mjekësisë “Elena Gjika”, Qendra e Kompetencës, Kolegji Universum si dhe Ekipi i Policisë së Kosovës i cili siguroi vendin

e zhvillimit të këtyre aktiviteteve. Kjo ditë u shënua në kuadër të 150 vjetorit të Qytetit tonë në organizim të DSHMS dhe QKMF në Ferizaj.

15.06.2023 - në simpoziumin e mbajtur për nder të Ditës së shëndetësisë dhe 150 vjetorit të qytetit tonë, morën pjesë rreth 350 infermierë nga QKMF në simpozium i cili ishte i akredituar me tetë pikë akredituese të cilat i përfituan infermierët me këtë rast.

23.08.2023 - një grup prej 10 infermierësh janë caktuar të marrin pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Mjekësisë Familjare në Prishtinë –organizuar nga MSH.

24.08.2023 - janë caktuar 6 infermiere të marrin pjesë në trajnimin “Komunikimi Ndërpersonal për Imunizimin”.

31.08.2023 - së bashku me koordinatoren e praktikës nga shkolla e mesme profesionale “Qendra e Kompetencës“ hartuam planin e praktikës për nxënës të profileve shëndetësore që do të kryejnë praktikën nëpër njësitë e QKMF-së.

01.09.2023 - së bashku me koordinatoren e praktikës nga shkolla e mesme e mjekësisë “Elena Gjika“ hartuam planin e praktikës për nxënës të profileve shëndetësore që do të kryejnë praktikën nëpër njësitë e QKMF-së

13.09.2023 - Filluam me sesionin vjeshtor të ligjëratave të EVP-së për infermierë sipas planit të akredituar në OIK në fillim të vitit.

29.09.2023 - janë bërë përgatitjet e nevojshme për muajin tetor, gjegjësisht fushatën për ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit.

02.10.2023 - u bë hapja e Muajit ROZË - ndërgjegjësimi kundër kancerit të gjirit. Nga kjo datë deri më 10.10.2023 ekipi i infermierëve bashkë me një mjek nga QKMF kanë mbajtur ligjërata me nxënës të klasave të XII-ta të gjashtë shkollave të mesme të Ferizajt.

05.10.2023 - Organizuar nga MSH në QTMF u mbajt trajnimi për të drejtat e pacientëve ku morën pjesë 21 infermierë nga QKMF.

11.10.2023 – është caktuar një infermiere nga Shërbimi Emergjent Primar që të përcjellë Hikingun në Jezerc organizuar nga shkollat e mesme të komunës sonë.

17-20.10.2023 – në kuadër të Muajit Rozë, nga infermieret e QKMF-së dhe koordinatorja e EPSH-së, u mbajtën ligjërata dhe diskutim me gratë e komunitetit në Neredime, Dardani, Komogllavë dhe shkollën “Ganimete Tërbeshi”.

26-28.10.2023 - u mbajt trajnimi *Dhuna në baza gjinore* ku kanë marrë pjesë tri infermiere.

30.10.2023 - Infermieret e QKMF nga të gjitha njësitë morën pjesë në organizimin e marshit përmbyllës të aktiviteteve për muajin e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit.

31.10.2023 - është mbajtur trajnim për vaksinimin në Prishtinë, ku kanë marrë pjesë nga dy infermiere nga QMF 5 dhe QMF 8.

07-09.11.2023 - trajnim lidhur me aplikimin e tri vaksinave të reja të kalendarit të rregullt të vaksinimit ku janë trajnuar 12 infermiere.

14.11.2023 - Ekipet e infermierëve nga QMF e qytetit zhvilluan aktivitete në qytet dhe në institucione për nder të Ditës Botërore të Diabetit.

21.11.2023 - kryeinfermieri, drejtoresha e QKMF-së, koordinatori dhe trajnerja e EVP-së morën pjesë në promovimin e Manualit të PSO për Infermierë, *Kujdesi Infermieror ne Komunitet*.

24.11.2023 - bëmë shpërndarjen e manualeve të PSO për infermierë nëpër të gjitha QMF-të dhe njësitë e QKMF.

06.12.2023 - u përmbyll cikli i ligjëratave në kuadër të EVP për infermierë për vitin 2023, në kuadër të të cilit janë mbajtur gjithsej 12 ligjërata të akredituar me nga dy pikë secila. Të gjithë infermierët e rregullt dhe ata të angazhuar përmes Caritasit, i kanë ndjekur këto ligjërata që janë mbajtur në dy seanca, me qëllim që të përfshihen të gjithë infermierët e QKMF-së.

11.12.2023 - Ligjëratë e organizuar nga QKMF me rekomandim të Zyrës së Avokatit të Popullit në QTMF për *Mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë* morën pjesë 50 infermier.

14.12.2023 – në bashkëpunim me koordinatorin e EVP për Infermier, hartuam dhe dërguam për akreditim ne OIK planin e ZHVP për vitin 2024.

22.12.2024 - në përmbylljen e aktiviteteve që shënuan vitin jubilar, 150 vjetorin e qytetit, në takimin e mbajtur në teatër morën pjesë 220 infermierë. Ky takim profesional u akreditua nga OIK me 4 pikë akredituese për të gjithë infermierët pjesëmarrës.

Në kuadër të 150 vjetorit të themelimit të qytetit tonë nga bashkëpunimi në mes DSHMS dhe Drejtorisë së Arsimit kemi mbajtur një trajnim për ndihmën e parë me arsimtarët dhe profesorët e edukatës fizike të shkollave të Ferizajt në dy grupe, më 26 dhe 27 qershor, në Qendrën Trajnuese të QKMF-së ku i kemi trajnuar këta arsimtarë të këtyre shkollave për dhënien e ndihmës së parë dhe përdorimin e mjeteve në çantat e ndihmës së parë të dhuruara ditë më parë nga DSHMS- trajnimin e mbajtën Ali Shaqiri, Afërdita Muharremi dhe Selim Bega.

Një sfidë tjetër e infermierisë dhe Zyrës së Kryeinfermierit është edhe sistemimi dhe monitorimi i praktikës së nxënësve dhe studentëve të infermierisë. Gjatë këtij viti nga Zyra e Kryeinfermierit janë sistemuar 270 studentë të diplomuar të infermierisë në stazh, janë lëshuar 250 vërtetime mbi kryerjen e praktikës - stazhit në QKMF, si dhe janë sistemuar edhe 193 studentë të tjerë të infermierisë nga fakulteti i infermierisë dhe kolegjet private me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi, ashtu si edhe nxënës të shkollave "Elena Gjika" dhe "Qendra e Kompetencës".

Me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në QKMF, diskutimit të problemeve apo kërkesave dhe rekomandimeve janë mbajtur 10 mbledhje me kryeinfermierët e njësisë të QKMF-së. Përndryshe, gjatë vitit 2023 infermiera në QKMF ka arritur suksese të njëpasnjëshme si në ofrimin

e shërbimeve brenda institucionit ashtu edhe ofrimin e shërbimeve në komunitet. Vlen të theksohet se shërbimi për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç ka dyfishuar numrin e shërbimeve duke u renditur ndër të parët në nivel vendi me numrin e shërbimeve. Po ashtu edhe Shërbimi i Kujdesit Shtëpiak ka dyfishuar numrin e shërbimeve ndaj pacientëve kronik dhe paliativ, Shërbimi Emergjent Primar është plotësuar me staf infermior dhe ka rritur ndjeshëm numrin e intervenimeve në terren. Infermierët gjatë këtij viti ishin të angazhuar pa rezervë në aktivitetet shëndetësore në kuadër të 150 vjetorit të themelimit të qytetit, shumë prej këtyre aktiviteteve të cekura në raportin e mësipërm janë akredituar në OIK si aktivitete me karakter promovues.

KOMITETI PËR CILËSI DHE SIGURI TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Zyra për sigurimin e cilësisë në punë

Krahas punës së përditshme me pacientë Koordinatori i Cilësisë ka kryer edhe detyra të tjera në kuadër të përgjegjësi të tij. Më 30 Janar 2023 nga Ministria e Shëndetësisë përmes emailit njofton për zbatimin e Qarkores Informative Nr.02/2023 të aprovuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, qarkore kjo e cila ka për qëllim:

1. Zbatimin e nenit 18-të Ligjit Nr.04/L-125
2. Zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.04/2020 në Kujdesin Parësor Shëndetësor me theks të veçantë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, referimin e brendshëm dhe të jashtëm dhe profesionistët shëndetësor që duhet të ofrojnë shërbime shëndetësore në KPSH.

Duke u bazuar në këtë udhëzim, Koordinatori i Cilësisë në muajin Shkurt 2023 ka punuar Auditin Klinik "Referimet e jashtme në KPSH-Ferizaj" për vitin 2022.

Gjithashtu, koordinatori i Cilësisë ka marrë pjesë edhe nëpër takime të ndryshme, siç është edhe pjesëmarrja në takimet e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Profesional, ku janë shqyrtuar çështje të ndryshme dhe janë marrë vendime në interes të institucionit tonë, por edhe në takime të tjera, si:

- Takimi në Zyrën e Drejtorit të QKMF-së së bashku me Kryeshefin e Departamentit të DMF dhe Përgjegjësen e Barnatores Qendrore të QKMF-së, ku është diskutuar lidhur me furnizimin me barna esenciale dhe përshkrimin e tyre nga ana e mjekëve. Me këtë rast janë bërë edhe vizita nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare ku janë dhënë rekomandime për menaxhimin e barnave esenciale.

- Në kuadër të ZHVP-së, Koordinatori i Cilësisë ka prezantuar të dhënat e Auditit Klinik, "Përshkrimi i Antibiotikëve në KPSH-Ferizaj për vitin 2022".

- Më 16.03.2023 - Takim pune (lidhur me rekomandimet e Drejtorit të DSHMS-së në takimin e mbajtur më 08.03.2023 me përgjegjësen e Barnatores Qendrore) në Zyrën e Drejtoreshës së QKMF-së së bashku me Kryeshefin e DMF-së dhe Përgjegjësen e Barnatores Qendrore të QKMF-së. Në këtë takim është diskutuar lidhur me furnizimin me barna esenciale dhe përshkrimin e tyre nga ana e mjekëve, me ç'rast janë bërë vizita nëpër QMF dhe janë dhënë rekomandime për menaxhimin e barnave esenciale.

- Më 24.03.2023 - është mbajtur një trajnim tejet i rëndësishëm në Prishtinë, i organizuar nga Zyra e OBSH-së me temën: Menaxhimi i mbeturinave mjekësore në kuadër të institucioneve të tri niveleve të kujdesit shëndetësor.

Duke ju referuar shkresës nga OMK me 12 Prill 2023 përmes kemi njoftuar shefat e njësive për produktet mjekësore që përmbajnë folkodinë, të marrin në konsideratë alternativa të tjera të trajtimit të pacientëve, pasi që produktet mjekësore që përmbajnë folkodinë nuk janë të disponueshme më në tregun e Bashkimit Evropian (BE-së).

- Më 26.04.2023 - nga Ministria e Shëndetësisë - Divizioni për Cilësi të Shërbimeve Shëndetësore dhe Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor është organizuar një takim me Koordinatorët e Cilësisë të institucioneve të KPSH-së, ku është diskutuar për pikat në vijim:

1. Prezantimi i termave të referencës për Koordinatorët e Cilësisë
2. Diskutimi dhe elaborimi i modaliteteve
3. Prezantimi i planit të auditeve klinike për vitin 2023 nga Koordinatorët e Cilësisë

- Më 15.05.2023 - vizitë pune në QKMF, QMF1, QMF2 dhe QMF4, takim me shefat e njësive, kryeinfermieret dhe teknikët e farmacisë lidhur me menaxhimin e barnave nga lista esenciale, për analizë janë kërkuar të dhënat për periudhën 01-30 Prill 2023, sipas dakordimit në vizitën e datës 17.03.2023.

Rezultatet: Numri i pacientëve dhe përshkrimi i barnave nga Lista Esenciale sipas indikacioneve

Në QKMF në periudhën 01-30 Prill 2023 janë vizituar 3802 pacientë, nga ana e mjekëve janë përshkruar 1224 barna nga lista esenciale, në përqindje: 32% .

Në QMF1 në periudhën 01-30 Prill janë vizituar 2158 pacientë, nga ana e mjekëve janë përshkruar 479 barna nga lista esenciale, në përqindje: 22% .

Në QMF2 në periudhën 01-30 Prill 2023 janë vizituar 4058 pacientë, nga ana e mjekëve janë përshkruar 671 barna nga lista esenciale, në përqindje: 17% .

Në QMF4 në periudhën 01-30 Prill 2023 janë vizituar 1524 pacientë, nga ana e mjekëve janë përshkruar 160 barna nga lista esenciale, në përqindje: 11% .

Tabela 1. Të dhënat rreth përshkrimit të barnave nga lista esenciale për muajin Prill 2023

Qendra	Numri i pacientëve (01-30.04.2023)	Numri i barnave esenciale të përshkruara	Përqindja
QKMF	3802	1224	32 %
QMF 1	2158	479	22%
QMF 2	4058	671	17%
QMF 4	1524	160	11%
Totali	11 542	2 534	21.95%

- Më 16.05.2023 Koordinator i Cilësisë ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga IKSHPK me mbështetje nga Zyra e AQH-së në Kosovë. Tema: *Raportimi i sëmundjeve kronike masovike jo ngjitëse.*

- Më 30.05.2023 - me ftesë të Dr. Hajrullah Fejzës, Këshilli i Koordinatorëve ka mbajtur takim në Prishtinë. Tema: *Forma unike e raportimit vjetor për Koordinatorët e Cilësisë.*

- Më 02.06.2023 - lidhur me përmbajtjen e takimit në fjalë, Koordinator i Cilësisë në QKMF ka njoftuar Koordinatorët e QKMF-ve: Shtime, Kaçanik dhe Hani i Elezit.

- Më 20.07.2023 vizitë pune në QKMF, QMF1, QMF2 dhe QMF4. Tema: Plotësimi i formularit (raportimi) për Sëmundjet kronike masovike jongjitëse dhe malinje.

- Më 27.07.2023 është mbajtur mbledhja e Komitetit për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore, është plotësuar Komiteti për Cilësi me anëtarë të rinj dhe janë themeluar komisionet punuese për audite klinike, hulumtime, rishqyrtime kolegjale dhe komisioni për referime të jashtme dhe terapi parenterale.

- Më 01.08.2023 me ftesë të Koordinatorit të Cilësisë është mbajtur mbledhja e komisionit për referime të jashtme dhe për përshkrimin e terapisë parenterale, në këtë takim anëtarët e Komisionit janë njoftuar për detyrat dhe obligimet e tyre, janë dorëzuar formularët dhe janë dhënë sqarime për plotësimin e tyre çdo muaj, për secilin mjek.

- Më 31.08.2023 - vizitë mbikëqyrëse dhe informuese në AMF - Talinoc i Muhaxherëve, QMF 9 - Softaj, QMF 8 - Dardani dhe në QMF 5 - Komogllavë.

- Më 01.09.2023 - vizitë mbikëqyrëse dhe informuese në QMF 7 - Neredime, QMF 6 - Pleshinë, QMF 3 - Greme.

- Më 02.09.2023 - vizitë mbikëqyrëse dhe informuese në QKMF, QMF1, QMF4 Ferizaj. Mbikëqyrja është realizuar në këto pika: Emri i institucionit dhe lloji i veprimtarisë, orari i punës,

lista e shërbimeve që kryhen me çmimore, karta për të drejtat e pacientëve, shenja për ndalimin e pirjes së duhanit, mbajtja e kartelave identifikuese dhe uniformës së plotë të punës nga ana e personelit, shenja për orientim brenda institucionit, kutia e ankesave, higjiena, menaxhimi i mbeturinave, anti-shok terapia të jetë e kompletuar, e organizuar dhe me qasje të lehtë, udhëzimi për përdorim të anti-shok terapisë të jetë i vendosur pranë anti-shok terapisë, tabela me listën e nënshkrimeve se kush dhe kur e ka kontrolluar i fundit afatin e anti-shok terapisë, barnatorja, vula e profesionistit dhe e institucionit, udhërrëfyesit dhe protokolet klinike, dokumentacioni unik shëndetësor, infrastruktura. Punëtorët shëndetësor janë informuar për obligimin ligjor për raportimin e sëmundjeve kronike jongjitime dhe malinje, si dhe për mënyrën e plotësimit të drejtë të formularëve për sëmundjet e cekura.

- Më 27.09.2023 - vizitë mbikëqyrëse së bashku me Kryeshefin e QKMF-së, në AMF-Talinoc, QMF 9 - Softaj, QMF 8 - Dardani, QMF 5 - Komogllavë me ç'rast këtyre njësive u është dorëzuar nga një kopje e Udhëzuesit për përdorimin e antibiotikëve në Kujdesin Parësor Shëndetësor.

- Më 10.10.2023- është bërë vizitë mbikëqyrëse së bashku me Kryeshefin e DMF-së, në QMF7-Neredime, QMF 6 - Pleshinë, QMF 3 - Greme AMF - Gaçkë, QMF 4, QMF1 dhe QKMF-Ferizaj. Në këto njësi është dorëzuar nga një kopje e Udhëzuesit për përdorimin e antibiotikëve në Kujdesin Parësor Shëndetësor, orari i punës, disa nga udhërrëfyesit klinik, karta e të drejtave të pacientëve dhe çmimorja e bashkëpagesave në KPSH, aty ku ka munguar, shenjat orientuese brenda institucioneve, tabela me listën e nënshkrimeve se kush dhe kur e ka kontrolluar i fundit afatin e antishok terapisë, shenja për ndalimin e pirjes së duhanit dhe udhëzimi për përdorimin e antishok terapisë.

- Më 12.10.2023 - vizitë mbikëqyrëse së bashku me Kryeshefin e QKMF-së në AMF-Talinoc, QMF 9 - Softaj, QMF 8 - Dardani dhe QMF 5 - Komogllavë, këtyre njësive u është dorëzuar: orari i punës, disa nga udhërrëfyesit klinik, karta e të drejtave të pacientëve dhe çmimorja e bashkëpagesave në KPSH, shenjat orientuese brenda institucioneve, tabela me listën e nënshkrimeve se kush dhe kur e ka kontrolluar i fundit afatin e antishok terapisë, shenja për ndalimin e pirjes së duhanit dhe udhëzimi për përdorimin e antishok terapisë.

- Më 18.10.2023 - është mbajtur takim pune në zyren e drejtorit me rendin e ditës: 1) Propozimi i temave për UPK për vitin 2024, 2) Propozim i temave për rishqyrtime kolegiale.

- Më 02.11.2023 - takim pune me Komisionin për audite klinike dhe Komisionin për rishqyrtime kolegiale, diskutim dhe ndarje e detyrave për anëtarët e komisioneve në fjalë.

- Më 13-15.11. 2023 - Koordinator i cilësisë ka marrë pjesë në punëtorinë tre ditore, të organizuar nga MSH dhe IKSHPK në përkrahje të OBSH-së . Mjeti strategjik për vlerësimin e rrezikut duke shfrytëzuar veglën (STAR).

- Më 22.11.2023 - është mbajtur Rishqyrtimi Kolegial: Përdorimi i maskës së njejtë dhe sondës nazale gjatë inhalimit dhe oksigjenimit, në fund janë dhënë rekomandimet. Gjatë muajit nëntor në bashkëpunim me Kryeinfermieret e njësive të QKMF-së nga libri i vizitave të pacientëve, për secilin mjek janë nxjerrë të dhënat për punimin e Riauditit klinik për Përshkrimin e Antibiotikëve.

- Më 12.12.2023 - është mbajtur Rishqyrtimi Kolegial: Procedurat standarde gjatë dhënies së infusioneve (shpimi i shisheve me gjilpërë-praktikë jo e mirë), janë dhënë rekomandime.

- Gjatë muajit dhjetor ka filluar punimi i Riauditit klinik për Përshkrimin e Antibiotikëve në QKMF gjatë nëntor 2023, riaudit ky që është në proces.

- Më 27.12.2023 - është bërë hartimi i Raportit Vjetor nga Koordinator i Cilësisë dhe është dërguar në Divizionin e Cilësisë dhe Sigurisë së Shërbimeve Shëndetësore (DCSSSHS) në Ministrinë e Shëndetësisë.

I. DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

Departamenti i Mjekësisë Familjare, me shtrirjen e aktivitetit nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare në të gjitha nivelet, ka vazhduar angazhimet drejt realizimit të objektivave të veta mbi shëndetin, për të gjithë banorët e komunës sonë, aktivitete këto që bëhen duke respektuar gjithnjë politikat lokale për shëndetësi të referuara nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (Sektori i Shëndetësisë) dhe Ministria e Shëndetësisë, të bazuara në ligjet dhe rregulloret administrative në fuqi.

Departamenti i Mjekësisë Familjare gjatë **vitet 2023**, si gjithnjë funksionimin e vet e ka përqendruar në kryerjen e shërbimeve të përhershme: Shërbimet konsultative nga mjeku i përgjithshëm, mjeku familjar dhe specialistët e tjerë (fiziatri, oftalmologu), shërbimet e shëndetit oral, shërbimet infermierike, shërbimet preventive (edukimi, vaksinimi, KAN-i, vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë, Qendra informuese për shëndetin e gruas), shërbimet shtëpiake, emergjente dhe diagnostike (EKG, ECHO, shërbimet laboratorike, shërbimet röntgenologjike).

Raporti në vazhdim jep një pasqyrë të detajuar të punës dhe angazhimeve të personelit shëndetësor në Departamentin e Mjekësisë Familjare.

1. SHËRBIMET MJEKËSORE

Shërbimet mjekësore kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë mes mjekëve dhe infermierëve, krahas përgjegjësisë dhe shkallës së lartë të përgatitjes profesionale. Gjatë punës dhe aktivitetit të përditshëm të mjekëve dhe infermierëve bëhen përpjekje të vazhdueshme për të ofruar shërbime shëndetësore me cilësi të lartë për të gjithë qytetarët e komunës sonë dhe më gjerë.

Numri i shërbimeve dhe mbarëvajtja – Rezultatet e punës për **viti 2023**, në Departamentin e Mjekësisë Familjare të QKMF – së, mund të radhiten sipas qendrave dhe sektorëve, me sa vijon:

- **Në QKMF:** janë ofruar **179 961** shërbime shëndetësore, prej tyre **63 482** janë vizita mjekësore kurse **116 479** shërbime infermierike.
- **Në QMF 1:** janë kryer **132 899** shërbime shëndetësore, prej tyre **39 446** janë vizita mjekësore, kurse **93 453** shërbime infermierike.
- **QMF 2:** janë kryer **82 549** shërbime shëndetësore, prej tyre **26 511** janë vizita mjekësore kurse **56 038** janë shërbime infermierike dhe të tjera.
- **QMF 3 - Greme:** janë kryer **20 133** shërbime shëndetësore, prej tyre **5 867** janë vizita mjekësore kurse **14 266** shërbime infermierike.
- **QMF 4:** janë kryer **124 155** shërbime shëndetësore, prej tyre **35 984** janë vizita mjekësore kurse **88 171** shërbime infermierike.
- **QMF 5 - Komogllavë:** janë kryer **12 178** shërbime shëndetësore, prej tyre **3 942** janë vizita mjekësore kurse **8 236** shërbime infermierike.
- **QMF 6 - Pleshinë:** janë kryer **8 487** shërbime shëndetësore, prej tyre **3 446** vizita mjekësore dhe **5 041** shërbime infermierike.
- **QMF 7 - Neredime:** janë kryer **3 426** shërbime shëndetësore, prej tyre **1232** vizita mjekësore dhe **2194** shërbime infermierike.
- **QMF 8 - Dardani:** janë kryer **13 460** shërbime shëndetësore, prej tyre **3 910** vizita mjekësore dhe **3 983** shërbime infermierike.
- **QMF 9 - Softaj:** janë kryer **9 201** shërbime shëndetësore, prej tyre **2 943** vizita mjekësore dhe **6 258** shërbime infermierike
- **AMF – të** – janë kryer **5 929** shërbime shëndetësore, prej tyre **1 571** vizita mjekësore kurse **4 358** shërbime infermierike.
- **KUJDESTARIA E NATËS** – si njësi që funksionon në kuadër të Shërbimit Emergjent Primar në QKMF, ka ofruar gjithsej **64 994** shërbime shëndetësore, nga të cilat **38 819** vizita mjekësore dhe **26 175** shërbime infermierike.
- **KUJDESTARIA E TË DIELAVE** – ka kryer gjithsej **29 150** shërbime, prej të cilave **14 914** vizita mjekësore dhe **14 236** shërbime infermierike. Prej tyre **20 441** shërbime janë ofruar në QKMF (SHEP) dhe **8 709** në QMF 2

Tabela 2. Numri i shërbimeve në të gjitha QMF-të dhe AMF-të

Qendra	Numri i vizitave mjekësore	Numri i shërbimeve infermierike	Numri i përgjithshëm i shërbimeve
QKMF	63482	116479	179961
QMF 1	39446	93453	132899
QMF 2	26511	56038	82549
QMF 3 - Greme	5867	14266	20133
QMF 4	35984	88171	124155
QMF 5 - Komogllavë	3942	8236	12178
QMF 6 - Pleshinë	3446	5041	8487
QMF 7 - Neredime	1232	2194	3426
QMF 8 - Dardani	3910	9550	13460
QMF 9 - Softaj	2943	6258	9201
AMF - të	1571	4358	5929
Kujdestaria e natës	38819	26175	64994
Kujdestaria e të dielave	14914	14236	29150

2. SHËRBIMET DIAGNOSTIKE

2.1. Njësia e laboratorit

Personeli i laboratorëve në pesë qendrat ka ofruar shërbime të vazhdueshme, në këta laboratorë janë kryer shumica e analizave të nevojshme për diagnostikim, numri i përgjithshëm i të cilave gjatë **këtij viti** arrin në **154 467** analiza, prej të cilave **139 775** janë analiza gjaku dhe **14692** analiza urine.

Tabela 3. Numri i shërbimeve në laboratorët e qendrave

Laboratorët në qendra	Analiza urine	Analiza gjaku	Gjithsej
QKMF	9641	102758	112399
QMF 1	2184	15418	17602
QMF 2	1704	12335	14039
QMF 3 (Greme)	289	1470	1759
QMF 4	630	5959	6589
QMF 8 (Dardani)	244	1835	2079
Totali	14 692	139 775	154 467

2.2. Njësia e radiologjisë

Njësia e Radiologjisë në kuadër të QKMF-së është e ndarë në gjashtë kabinete: RTG në DAT, RTG digjital në SHEP, RTG dental, Mamografia dhe kabineti i radiologes i pajisur me aparat të ultrazërit. Shërbimet e kryera gjatë *periudhës njëvjeçare* në këtë njësi janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 4. Shërbimet në Kabinetin e RTG-së

Shërbimet	Numri i shërbimeve
Vizita specialistike radiologjike	5008
Radiografia të ekstremiteteve	10569
Radiografi të mushkërive	2384
Echo	373
Mamografi eksponime	3914
Mamografi lexim	1197
Vizita RAI	2235
Gjithsej	25 680

3. DISPANZERI I SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE

Në Dispanserin e Sëmundjeve të Mushkërive (DSM) **gjatë vitit 2023** janë ofruar gjithsej **7486** shërbime. Pas ekzaminimit të rasteve të dyshuara, janë diagnostikuar **52** raste të reja me TB, **42** me TBC pulmonare dhe **10** me TBC extrapulmonare.

Tabela 5. Shërbimet në Dispanserin Antituberkular

Shërbimet	Numri
Vizita specialistike	3601
Patronazh (edukim shëndetësor)	1533
Përpunim i kontaktit	161
Baciloskopi	673
BK+	41
Laborator (Se)	116
PPD	531
Vizita shtëpiake	361
Inhalime	42
Testi i HIV-it	46
Punktate	23
Gen Expert	126
Matja e peshës	232
Gjithsej	7486

4. SHËRBIMET PREVENTIVE

Në shërbimet preventive, që nënkuptojnë promovimin e shëndetit në komunitet, bëjnë pjesë dy njësi të QKMF – së:

- a) Edukimi shëndetësor dhe
- b) Vaksinimi.

Të dyja këto njësi ofrojnë shërbime nëpër shkolla dhe në komunitet dhe organizojnë punën nëpërmjet ekipeve përkatëse.

4.1. Edukimi shëndetësor

Duke u nisur përherë nga motoja *Më lehtë është të parandalosh, se sa ta shërosh sëmundjen* aktivitetet nga grupi i edukimit dhe promovimit shëndetësor gjatë këtij **viti** kishin për qëllim realizimin e synimit për një popullsi të shëndosh. Nisma e angazhimeve për anëtarët e Grupit të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor ishte e orientuar sipas objektivave të përcaktuara, në drejtim të: 1) Zhvillimit të aktiviteteve promovuese edukative për përparimin e shëndetit të popullatës së Ferizajt dhe 2) Zhvillimit të aktiviteteve promovuese të shëndetit në respektim të Ditëve ndërkombëtare sipas kalendarit për Ditët ndërkombëtare.

20.03.2023 - Ekipet e Sektorit të Stomatologjisë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj, filluan aktivitetet për shënimin e “Ditës Botërore të Shëndetit Oral”. Aktivitetet , përmes një ligjërate nga fusha e stomatologjisë dhe ekspozita me esetë e krijuara nga nxënësit u zhvillua në shkollën fillore të mesme e të ulët “Dituria” në Dardani. Përmes aktiviteteve të tilla, që organizohen çdo vit, Sektori i Stomatologjisë synon të sensibilizoj nxënësit për rëndësinë e shëndetit oral dhe të sanojë gjendjen jo të kënaqshme në këtë segment.

24.03.2023 - Me moton “ Po! Ti japim fund tuberkulozit” , në nder të “ Ditës Botërore kundër Tuberkulozit”- kuadër QKMF-së u zhvilluan aktivitete të ndryshme me qëllim të ngritjes së vetëdijes në mesin e popullatës për pasojat e rënda shëndetësore, sociale dhe ekonomike që ka tuberkulozi, si dhe të shtohen angazhimet për t’i dhënë fund epidemisë globale të tuberkulozit.

Grupi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor në bashkë-koordinim me stafin profesional shëndetësor nga DAT kuadër QKMF-së realizuan aktivitete në disa dimensione. Aktivitetet me rol edukativo- promovues dhe në formë skreningu u zhvilluan përgjatë një jave me të vetmin qëllim që sa më mirë dhe në përfshirje më të gjerë për avokimin për shëndet dhe mirëqenie sa më të mirë dhe shpërndarjen e informatave mbi rëndësinë e sëmundjes dhe të arrijmë sensibilizimin më të gjerë me grupet më vulnerabile, për të përmbushur misionin në luftë kundër tuberkulozit. Këto aktivitete filluan më:

21.03.2023 - Realizimi i testimit me tuberkulinë në vlerësim të identifikimit të rasteve të mundshme me tuberkuloz në klientët e Qendrës Rehabilituese në Shtime, nga stafi profesional kuadër Dispanzerit Antituberkular në QKMF.

23.03.2023 - Një ligjërate informuese me karakter edukativ me nxënësit e shkollës “Jeronim De Rada” nga grupi për EPSH.

24.03.2023 - Vizitë nga nxënësit në hapësirat e DAT në QKMF, në njohje dhe diskutim me pulmologun dhe stafin mbështetës, rreth simptomave, zhvillimit të sëmundjes, diagnostikimit, trajtimit, preventivës dhe shumë pyetjeve të tjera me interes për nxënësit.

24.03.2023 - Manifestimi në shesh nga ekipet e mjekësisë familjare nga QMF e qytetit me qëllim shpërndarjen e materialit edukativ informues rreth sëmundjes së tuberkulozit, në shoqërim nga nxënës të shkollës së mjekësisë dhe anëtarë të Kryqit të Kuq

27.03.2023 - Vlerësimi i reagimit të provës së tuberkulinës në mesin e të testuarve në QR-Shtime.

07.04.2023 - Grupi për Edukim dhe Promovim Shëndetësor për nder të Ditës Botërore të Shëndetit organizoi ligjëratë në Qendrën e Kompetencës. Në këtë aktivitet ishte i pranishëm edhe drejtori i DSHMS, Dr. Kemajl Emini. Ligjëratat zgjoi interesim të madh tek nxënësit.

25.04.2023 - Grupi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor në QKMF në bashkëpunim me Shërbimin e Vaksinit shënuan sot aktivitetin Java Evropiane e Vaksinit.

Në këtë aktivitet përveç menaxhmentit të QKMF-së, shefes së Shërbimit të Vaksinit dhe Koordinatorit të Edukimit, ishte i pranishëm Drejtori i DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini dhe infermierët nga QKMF, QMF 1, QMF 2, QMF 4. Në SHMU “Jeronim De Rada” u mbajt një ligjëratë informuese për vaksinat e fruthit në veçanti dhe të tjerat në vazhdimësi, ndërsa në Gjimnazin “Kuvendi i Arbrit” në një sallë me nxënës të përzgjedhur nga secila klasë, u mbajt një ligjëratë për historikun e vaksinave si dhe u shpërndanë broshura për rëndësinë e vaksinit. Gjithashtu, u zhvillua edhe aktiviteti në Sheshin “Adem Jashari”, ku ishte vendosur tenda dhe infermieret shpërndanë broshura dhe informata për qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe Grupi për Edukim dhe Promovim Shëndetësor zhvilloi aktivitetet e planifikuara për vizitat sistematike të nxënësve në klasën e parë dhe të pestë nga ekipet e mjekësisë familjare, stomatologjisë, fizinatrisë dhe oftalmologjisë. Këto vizita ishin të fokusuar në vlerësimin e rritjes e zhvillimit të nxënësve (matja e peshës dhe gjatësisë), si dhe vlerësimin e statusit nutritiv të tyre, derisa ekipi i stomatologjisë realizoi kontrollin stomatologjik në vlerësimin e shëndetit oral. Njëkohësisht edhe ekipi nga fiziatra vlerësoi posturën dhe gjendjen e shtyllës kurrizore me qëllim identifikimi të hershëm të çrregullimeve në këtë fushë, ndërsa nga specialistja e oftalmologjisë u realizuan vizita për të identifikuar probleme me shikimin.

Pas çdo ekzaminimi ekipet mjekësore ofruan sugjerimet dhe këshillat e nevojshme për nxënësit duke ndihmuar në edukimin e tyre shëndetësor rreth konsumimit të ushqimit dhe mirëmbajtjes së higjienës trupore e orale, dhe në veçanti nxënësit pranuan këshillat e qëndrimit të drejtë trupor. Nxënësit e identifikuar me probleme në sy u referuan për trajtim të mëtutjeshëm.

04.05.2023 - u zhvilluan vizitat sistematike nxënësve të klasave të V-ta dhe të I-ra në SHFMU” Arsim Rexhepi” në Sazli dhe Papaz.

12 dhe 15.05.2023 - u zhvilluan vizitat sistematike të nxënësve të klasave të V-ta dhe të I-ra në SHFMU” Naim Frashëri” në Zaskok.

16.05.2023 - u zhvilluan vizitat sistematike të nxënësve të klasave të I-ra dhe V-ta në SHMU" Ali Hadri" në Mirash.

31.05.2023 - Me temën "Duhani - Pse duhet të flasim për duhanin" në shkollën "Tefik Çanga" në Ferizaj u mbajt ligjëratë nga infermierët e grupit të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor të QKMF-së, Ali Shaqiri -koordinator i EVP-së, Afërdita Muharremi - trajnere e mjekësisë familjare, Selim Bega - kryeinfermier i QKMF-së, me nxënës të kësaj shkolle. Ligjëratat kishte për qëllim sensibilizimin dhe vetëdijesimin e të rinjve në luftën kundër duhanit, pasojat që mund të sjell përdorimi i duhanit, duke theksuar faktet e fundit mbi dëmin mjedisor të ciklit të duhanit, që nga kultivimi, prodhimi dhe shpërndarja e tij, e deri te mbetjet toksike që gjeneron, njëkohësisht, duke potencuar edhe të gjitha komplikimet dhe pasojat shëndetësore në organizëm.

12.09.2023 - Dita Botërore e Zemrës u shënua në ambientet e QKMF-së dhe QMF-ve, me disa aktivitete nga mjekë dhe infermierë, me qëllim të përcimit të mesazheve mbi ruajtjen e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe për një jetë të shëndoshë.

02.10.2023 - Filloi muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit "Tetori rozë", me aktivitete të shumta sensibilizuese kundër kancerit të gjirit, të organizuara nën patronatin e Kryetarit të Komunës, z.Agim Aliu, në mbështetje të DSHMS, QKMF dhe Këshillit Organizativ të shënimit të 150 vjetorit të qytetit të Ferizajt në fushën e shëndetësisë.

06.10.2023 - Për nder të "Tetorit rozë", muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, u mbajtën ligjëratat në katër shkolla të mesme të qytetit të Ferizajt me nxënës të klasave të 12-ta dhe mësimdhënëset e tyre. Gjimnazi shkencor "Kuvendi i Arbërit", Gjimnazi gjuhësor-shoqëror "Dr. Shaban Hashani", Shkolla e mesme ekonomike "Faik Konica" dhe Qendra e Kompetencës ishin shkollat ku u ligjërua mbi "Parandalimin e kancerit të gjirit dhe vetëkontrollin e gjirit".

10.10.2023 - Aktivitetet vazhduan edhe në dy shkolla të mesme të qytetit të Ferizajt me nxënës të klasave të 12-ta dhe mësimdhënëset e tyre, në Shkollën e mesme të mjekësisë "Elena Gjika" dhe në Shkollën e mesme teknike "Pjetër Bogdani" me ligjëratat me temën "Parandalimi i kancerit të gjirit dhe vetëkontrolli i gjirit".

12.10.2023 - Në Teatrin "Adriana" u mbajt ligjëratë për ndërgjegjësimin ndaj kancerit të gjirit ku ligjëruan Dr. Xheladin Reçica - kirurg torakal, Dr. Ilir Kurtishi –onkolog, Dr. Bedri Osmani-kirurg torakal, Dr. Mirsad Ukshini-kirurg torakal si dhe Dr. Drita Demiri specialiste e Mjekësisë Familjare.

20.10.2023 - Java e tretë e tetorit të "Muajit Rozë" grupi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor i QKMF-së ka vazhduar me takime dhe aktivitete të ndryshme, me qëllim të vetëdijesimit të komunitetit lidhur me rëndësinë e parandalimit dhe zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit. Këto takime u mbajtën me gratë e komunitetit në objektet shkollore si në: shkollën "Ganimete Tërbeshti" në Ferizaj, në shkollën e fshatit Komogllavë, në Dardani si dhe në shkollën e fshatit Neredime.

31.10.2023 - Muaji rozë u përmbyll me marshin në sheshin e qytetit.

14.11.2023 - Java e Diabetit, u shënua në të gjitha QMF-të e qytetit të Ferizajt, ekipe të infermierëve u angazhuan në matjen e nivelit të glukozës në gjak për pacientët e rastit dhe ofruan këshilla për pacientët me diabet.

01.12.2023 - Ligjëratë në Gjimnazin "Kuvendi i Arbërit" për nxënësit e klasës XII, për nder të 1 Dhjetorit, Ditës Botërore të HIV-AIDS, ekipi i QKMF-së.

4.2. Shërbimi i vaksinimit

Gjatë **vitit 2023** në Shërbimin e Vaksinimit në të gjitha QMF-të dhe AMF-të, janë dhënë gjithsej **33 838** vaksina, prej tyre **23 694** nëpër qendra, ndërsa **10 144** nëpër shkolla.

Tabela 6. Vaksinimi sipas qendrave

Qendra	Vaksinat nëpër njësi
QKMF	16 349
QMF 1	2439
QMF 2	2297
QMF 3 - Greme	368
QMF 4	968
QMF 5 Komogllavë	20
QMF 8 - Dardani	527
QMF 9 - Softaj	537
AMF - të	189
Totali	23 349

Nga numri i vaksinave të dhëna nëpër qendra **4736** janë vaksina kundër gripit sezonal. Ndërsa numri i pacientëve që janë vaksinuar gjatë vitit 2023 është 23 305.

Tabela 7. Vaksinimi nëpër shkolla

Mosha e nxënësve	Klasa e parë (6-7 vjeç)	Klasa e gjashtë (12-13 vjeç)	Maturantët (18 vjeç)	Totali i vaksinave
OPV R2	1664			1664
DT	1664			1664
MMR	1664			1664
OPV R3		1659		1659
TD		1659		1659
TD			1834	1834
Totali	4992	3318	1834	10144

4.3. Qendra Informuese për Shëndetin e Gruas

Në Qendrën Informuese për Shëndetin e Gruas në QMF 2, gjatë **vitit 2023** janë ofruar gjithsej **177** shërbime, ku përfshihen trajnimet individuale dhe grupore, për gra shtatzëna dhe familjet e tyre.

4.4. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç

Shërbimi i Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë gjatë **vitit 2023**, ka ofruar **4861** vizita që janë tejet të rëndësishme për ruajtjen e shëndetit të nënave dhe fëmijëve, ushqyeshmërinë e shëndetshme të fëmijëve dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme apo identifikimin e hershëm të tyre.

Tabela 8. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç

Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë 0 deri 3 vjeç	Numri i shërbimeve
QKMF	1572
QMF 1	993
QMF 2	1198
QMF 3	127
QMF 4	755
QMF 8 - Dardani	50
QMF 9 - Softaj	166
GJITHSEJ	4861

5. SHËRBIMET EMERGJENTE

Shërbimi emergjent si njësi në kuadër të QKMF-së, gjatë **viti 2023** ka intervenuar në **4128** raste emergjente, mirëpo përveç rasteve emergjente në këtë njësi janë ofruar edhe **18014** shërbime të tjera. Tabelat në vijim përfshijnë në mënyrë të përmblëdhur rezultatet e punës në Shërbimin Emergjent Primar.

Tabela 9. Shërbimet emergjente primare

Shërbimet emergjente	Numri i rasteve
Emergjencat internistike	380
Emergjencat infektive	3
Emergjencat kirurgjike	43
Emergjencat pediatrike	1
Emergjencat gjinekologjike	5
Emergjenca toksikologjike	40
Emergjencat neurologjike	230
Emergjencat psikiatrike	177
Emergjencat geriatrike	680
Dhimbje akute	1117
Trauma në komunikacion	562
Trauma në punë	13
Trauma në familje	54
Trauma me armë zjarri	1
Trauma me armë të ftohta	3
Vetëvrasje me armë	1
Tentim vetëvrasjeje me mjete kimike	7
Verifikim i vdekjes	361
Sëmundje malinje	416
Emergjencat ortopedike	34
GJITHSEJ	4128

Pacientët tek të cilët intervenohet jo gjithherë vazhdojnë trajtimin në QKMF, një numër i tyre dërgohen edhe nëpër institucionet e tjera brenda ose jashtë qytetit, varësisht nga gjendja e tyre shëndetësore dhe mjekimi që duhet t'u ofrohet. Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat lidhur me vazhdimin e mëtejme të trajtimit të tyre.

Tabela 10. Trajtimi i pacientëve pas ndihmës emergjente

Të trajtuar në:	
QKMF	139
Shtëpi	2053
Aksident komunikacioni	562
Të transportuar në:	
Spital – Ferizaj	766
QKUK	34
Polici	184

Tabela në vijim paraqet shërbimet e tjera që ofrohen në objektin e SHEP.

Tabela 11. Shërbimet e tjera në SHEP

Shërbimet e tjera	Numri
Vizita mjekësore	566
EKG	1571
Therje intramuskulare	603
Therje intravenoze	55
Infuzione	14005
Lidhtore	315
Riqna	23
Kateterizime	169
Inhalime	133
Reanimime	163
Matja e glikemisë	411
Totali	18014

6. KUJDESI SHTËPIAK PALIATIV

Në kuadër të kujdesit shtëpiak si njësi që funksionon në katër QMF – të, realizohen **vizitat shtëpiake** paliative me një staf të përgatitur mirë që tregon suksese në përmbushjen e obligimeve të punës, përkundër faktit që kjo punë bëhet nëpër shtëpitë e pacientëve të cilët janë në gjendje shumë të rëndë dhe të palëvizshëm. Gjatë **vitit 2023** janë kryer gjithsej **4710** vizita shtëpiake.

Tabela 12. Shërbimet e Kujdesit Shtëpiak

Kujdesi shtëpiak	Numri i shërbimeve
QKMF	1439
QMF 1	1151
QMF 2	260
QMF 4	1860
GJITHSEJ	4710

7. KUJDESI SHËNDETËSOR ANTENATAL (KAN)

Kujdesi shëndetësor antenatal realizohet në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, ku gjenden dhomat për Kujdesin antenatal (KAN) të cilat udhëhiqen nga infermieret e trajnuara për këtë qëllim, që bashkë me mjekun, përcjellin tek pacientet periudhën e shtatzënisë dhe lehonisë. Raporti i këtij shërbimi për **vitin 2023** është **4392** vizita.

Tabela 13. Shërbimet e Kujdesit Antenatal

Kujdesi Antenatal	Numri i shërbimeve
QKMF	1666
QMF 1	70
QMF 2	788
QMF 4	1865
AMF	3
GJITHSEJ	4392

8. AMBULANCAT E MJEKËSISË FAMILJARE

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare funksionojnë pesë Ambulanca të Mjekësisë Familjare në fshatrat: Mirash, Varosh, Gaçkë, Llojza dhe Talinoc, ndërsa në Greme, Komogllavë, Pleshinë, Neredime, Dardani dhe Softaj funksionojnë QMF 3, QMF 5, QMF 6, QMF 7, QMF 8 dhe QMF 9. Që nga fillimi i këtij viti (më 11 janar) AMF në fshatin Mirosalë është jofunksionale për shkak të dëmtimeve që ka pësuar objekti nga zjarri.

Gjatë **viti 2023** në të gjitha AMF – të nëpër fshatra, numri i përgjithshëm i shërbimeve është **3 714**, prej të cilave **873** janë vizita mjekësore, vetëm në AMF-Varosh dhe **2 841** shërbime infermierike.

9. NJËSIA E FARMACISË

Njësia e farmacisë gjatë **vitit 2023** ka vazhduar punën e saj në distribuimin dhe disperzimin e barnave dhe materialit medicinal. Depoja qendrore pranë QKMF - së furnizohet nga: Ministria e Shëndetësisë - Divizioni i Farmacisë; Operatori ekonomik dhe Donacionet.

a) Furnizim i rregullt nga Depoja Qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë:

Tabela 14. Furnizimi nga Depoja Qendrore në MSH

Nr	Numri i faturës	Vlera	Furnizuesi	Data
1	2/2023	11.3611,582.50	Divizioni i Farmacisë	31/01/2023
2	01/2022	10,727.26	Divizioni i Farmacisë	27/01/2023
3	5/2023	731.45	Divizioni i Farmacisë	21/02/2023
4	4/2023	22,323.94	Divizioni i Farmacisë	16/02/2023
5	3/2023	5,102.40	Divizioni i Farmacisë	13/02/2023
6	08/2023	19,045.60	Divizioni i Farmacisë	14/03/23
7	06/2023	249	Divizioni i Farmacisë	02/03/23
8	26/2023	1,829.09	Divizioni i Farmacisë	16/03/2023
9	7/2023	10,036.96	Divizioni i Farmacisë	03/03/2023
10	10/2023	22,328.10	Divizioni i Farmacisë	19/04/2023
11	67/2023	593.69	Divizioni i Farmacisë	04/04/2023
12	9/2023	10,187.17	Divizioni i Farmacisë	03/04/2023

13	87/2023	194.92	Divizioni i Farmacisë	13/04/2023
14	126/2023	709.52	Divizioni i Farmacisë	24/04/2023
15	11/2023	8864.73	Divizioni i Farmacisë	04/05/2023
16	166/2023	239.72	Divizioni i Farmacisë	22/06/23
17	12/2023	9,091.70	Divizioni i Farmacisë	02/06/23
18	13/2023	21,751.70	Divizioni i Farmacisë	16/06/2023
19	15/2023	1,388.08	Divizioni i Farmacisë	10/07/2023
20	14/2023	10,044.16	Divizioni i Farmacisë	05/07/2023
21	16/2023	21,634.00	Divizioni i Farmacisë	11/07/2023
22	17/2023	7946.44	Divizioni i Farmacisë	04/08/2023
23	11/2023	21326.16	Divizioni i Farmacisë	11/08/2023
24	17/2023	7946.44	Divizioni i Farmacisë	04/08/2023
25	20/2023	21,291.28	Divizioni i Farmacisë	08/09/23
26	19/2023	10,006.77	Divizioni i Farmacisë	04/09/23
27	190/2023	1,305.00	Divizioni i Farmacisë	12/09/2023
28	21/2023	11,282.18	Divizioni i Farmacisë	02/10/2023
29	24/2023	327	Divizioni i Farmacisë	15/11/23

30	23/2023	17,432.40	Divizioni i Farmacisë	09/11/2023
31	22/2023	12,054.12	Divizioni i Farmacisë	07/11/2023
32	25/2023	3572.80	Divizioni i Farmacisë	21/11/2023
33	27/2023	155.79	Divizioni i Farmacisë	08/12/2023
34	28/2023	20,624.52	Divizioni i Farmacisë	13/12/2023
35	26/2023	9874.65	Divizioni i Farmacisë	05/12/2023

b) Furnizimi nga operatori ekonomik

Tabela 15. Furnizimi nga operatori ekonomik

Nr	Numri i faturës	Vlera	Data	Furnizuesi
1	23-210-001-01	32.34	06/ 01/ 2023	Medica
2	66-23	209.1	28/02/2023	MADEKOS
3	65-23	2506.19	28/02/23	MADEKOS
4	64/23	12,922.10	21/12/2022	Donadent
5	186-23	2,089.25	27/ 04/ 2023	MADEKOS
6	187-23	1,313.20	27/04/2023	MADEKOS
7	040423003-4	14.18	04/ 04/ 2023	Messer Medica
8	052923002-4	33.08	29/05/2023	Messer Medica
9	306-23	2140.04	14/ 07/ 2023	MADEKOS
10	082223003-4	28.35	22/08/2023	Messer Medica
11	369-23	670.00	15/ 08/ 2023	MADEKOS
12	403-23	2146.75	07/ 09/ 2023	MADEKOS

13	466-23	1,635.60	04/10/2023	MADEKOS
14	541-23	1350.00	15/11/2023	MADEKOS
15	540-23	2109.50	15/11/2023	MADEKOS
16	652-23	2,991.90	26/12/2023	MADEKOS
17	640-23	1360.00	21/12/2023	MADEKOS
18	112123001-1	5000	21/11/2023	Alfadent
19	100623001-4	23.63	06/10/2023	Messer Medica

Gjatë **viti 2023** niveli i furnizimit me barna nuk ka qenë i njëtrajtshëm por ka ndryshuar nga një periudhë në tjetrën. Gjithashtu, ka pasur ndryshime edhe në plotësimin e kërkesave për terapi të kategorive të caktuara.

Tabela 16. Furnizimi sipas kërkesave për terapi

Periudha	Insulina	Terapi orale	Terapi ampulare dhe infuzione	Antituberkulare
Janar - Mars	I plotë	I pjesërishtë	I pamjaftueshëm	I mirë
Prill - Qershor	I plotë	I pjesërishtë	I pamjaftueshëm	I mirë
Korrik - Shtator	I plotë	I pjesërishtë	I pamjaftueshëm	I mirë
Tetor - Dhjetor	I plotë	I pjesërishtë	I pamjaftueshëm	I mirë

AKTIVITETET - distribuimi dhe disperzimi i barnave dhe materialit mjekësor nëpër pikat furnizuese të paraqitura në tabelën vijuese:

Tabela 17. Distribuími dhe disperzimi i barnave

Barnatorja		AMF -të	Laboratori	Të tjera
QKMF	QMF 6	AMF - Mirosalë	QKMF	- Kujdestaria e natës I-II-III
QMF 1	QMF 7	AMF - Mirash	QMF 1	- Shërbimi Emergjent
QMF 2	QMF 8	AMF - Varosh	QMF 2	- Kabineti i rëntgenit
QMF 4	QMF 9	AMF - Talinoc	QMF 3	- Sektori i Stomatologjisë
QMF 5		AMF - Gaçkë	QMF 4	dhe - DAT-i

II. QENDRA TRAJNUESE E MJEKËSISË FAMILJARE

2.1. Aktivitetet në QTMF

Aktivitetet e zhvilluara në QTMF-Ferizaj për periudhën 01/01.2023 deri më 31.03.2023 janë të lidhura me zbatimin e programit të shkollimit specialistik në Mjekësi Familjare për gjeneratën 2021/2024 ku përshihen:

- Ushtrimet Klinike në QTMF / Ferizaj;
- Ligjëratat qendrore në QZHM / Prishtinë;
- Monitorimi i ushtrimeve klinike në repartet klinike në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt, IKSHF- Ferizaj dhe QSHM - Ferizaj;
- Vlerësimi në mes të modulit dhe në fund të modulit në programin e Mjekësisë Familjare,
- Raportimet e rregullta të implementimit dhe zbatimit dhe vijueshmërisë në MSH në Prishtinë;
- Koordinimi dhe zbatimi në implementimin e programit të Mjekësisë Familjare me institucionet përgjegjëse komunale DSHMS dhe Drejtorin e QKMF-së.

I gjithë ky aktivitet realizohet me stafin e QTMF / Ferizaj ku bëjnë pjesë koordinatori, mentorët klinik dhe trajnerët.

Në gjeneratën 2021/2024 vijojnë specializimin 7 specializantë nga QKMF –Viti, 2 nga QKMF-Kaçanik, 1 specializant nga QKMF / Prishtinë dhe 1 specializant nga QKMF /Ferizaj që është transferuar nga QKMF –Hani Elezit.

2.2. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

Në bazë të planit vjetor për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional për mjekë familjarë dhe të përgjithshëm, gjatë **vitet 2023** janë mbajtur këto aktivitete sipas planit vjetor të dorëzuar në Odën e Mjekëve të Kosovës:

Tabela 18. Ligjëratat dhe trajnimet e mbajtura në kuadër të ZHVP-së

	Aktiviteti	Data
1	Sëmundjet e traktit respirator në KP-punëtori - punëtori	26.01.2023
2	Kollitja si simptomë e sëmundjeve respiratore - ligjëratë	02.02.2023
3	Paraqitja e sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse	15.02.2023
4	Përshkrimi i antibiotikëve ne Kujdesin Primar Ferizaj - audit klinik	20.02.2023
5	Vaksinimi i rregullt i fëmijëve, MMR vaksina - ligjëratë	22.03.2023
6	'Burn out' (djegia profesionale) - trajnim	28-30.03.2023
7	'Burn out' (djegia profesionale) - trajnim	04.04.2023
8	'Burn out' (djegia profesionale) - trajnim	05.04.2023
9	Vlerësimi i riskut të SKV në Kujdesin Parësor - ligjëratë	18.05.2023
10	Trajtimi i DM në Kujdesin Parësor sipas UK nacional - ligjëratë	09.06.2023
11	Identifikimi i problemeve për t'u trajtuar si rishqyrtime kolegjale	10.07. 2023
12	Planifikimi familjar dhe dhuna në baza gjinore	
13	Karcinoma kolorektale	20.10.2023
14	Qasje inovative në menaxhimin e sëmundjeve endokrine	29.11.2023

Këto aktivitete Zyra e ZHVP-së i ka akredituar në Odën e Mjekëve të Kosovës duke iu mundësuar mjekëve t'i realizojnë pikët e nevojshme për licencim dhe rilicencim dhe njëkohësisht të rritet niveli i cilësisë së punës në praktikën e përditshme profesionale.

Sa i përket metodologjisë gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve, QTMF në Ferizaj është përkujdesur që përmes metodave interaktive me pjesëmarrësit e ligjëratave, përveç prezantimit, të identifikohen edhe vështirësitë në vendin e punës për zbatim të dhënave më të reja shkencore.

2.3. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional Infermieror

Aktivitetet për ZhVP për Infermierë janë mbajtur sipas planit të hartuar paraprakisht me qëllim të arritjes së objektivave të zhvillimit profesional drejt ngritjes së cilësisë dhe plotësimit të standardeve për kujdes shëndetësor. Gjatë **vitet 2023** janë mbajtur këto aktivitete sipas planit vjetor të dorëzuar në Odën e Infermierëve të Kosovës:

Tabela 19. Ligjëratat e mbajtura në kuadër të ZHVP-së për Infermierë

Nr.	Aktiviteti	Data
1	Dukuritë devijante në shoqëri (droga,alkooli,duhani, prostitucioni	20.01.2023
2	‘Mjedisi i shtëpisë dhe siguria’	08.02.2023
3	‘Mjedisi i shtëpisë dhe siguria’	20.02.2023
4	‘Mjedisi i shtëpisë dhe siguria’	06.03.2023
5	‘Mjedisi i shtëpisë dhe siguria’	13.03.2023
6	‘Mjedisi i shtëpisë dhe siguria’	20.03.2023
7	Dita ndërkombëtare e TBC “Po! Ti japim fund tuberkulozit”	23.03.2023
8	‘Mjedisi i shtëpisë dhe siguria’	27.03.2023
9	“Kujdesi për higjienën e ambientit”	01.04.2013
10	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Infermierisë	12.05.2023
11	Ndalo duhanin! Duhani vret!	31.05.2023
12	Trajtimi i Plagëve	09.06.2023
13	Komunikimi	09.06.2023
14	Simpoziumi "Me shnet 150 vjet"	15.06.2023
15	Trajtimi i Plagëve	16.06.2023

16	Komunikimi	16.06.2023
17	Trajnim për Ndhmën e Parë	26.06.2023
18	Trajnim për Ndhmën e Parë	27.06.2023
19	Drogat dhe Pasojat	27.06.2023
20	Transfuzioni dhe Grupet e Gjakut	05.07.2023
21	Kontrolli ndaj Inek.Sterilizimi dhe Dezinfektimi	05.07.2023
22	Transfuzioni dhe Grupet e Gjakut	12.07.2023
23	Kontrolli ndaj Inek.Sterilizimi dhe Dezinfektimi	12.07.2023
24	Mjedisi i shtëpisë dhe siguria	24.07.2023
25	Mjedisi i shtëpisë dhe siguria	31.07.2023
26	Dita Botërore e Ndhmës së Shpejtë	8.09.2023
27	Mjedisi i shtëpisë dhe siguria	11.09.2023
28	Dita Botërore e Ndhmës së Farmacisë	25.09.2023
29	Kujdesi infermieror te alergjitë dhe shoku anafilaktik	27.09.2023
30	EKG	27.09.2023
31	Me zemër për Zemër-Dita Botërore e Zemrës	29.09.2023
32	Mjedisi i shtëpisë dhe siguria	16.10.2023
33	Kanceri i gjirit	01-31.10.2023
34	Administrimi i medikamenteve	05.10.2023
35	Mjedisi i shtëpisë dhe siguria	13.11.2023
36	Infarkti akut i miokardit	19.10.2023
37	Kujdesi tek pacientët me angina pectoris	26.10.2023
38	Etika dhe çështjet etike	09.11.2023
39	Roli i infermieres në vizitat për fëmijë	15.11.2023
40	Parandalimi i komplikimeve të shkaktuara nga diabeti	22.11.2023
41	Parandalimi I HIV-AIDS	01.12.203
42	‘Mjedisi i shtëpisë dhe siguria’	04.12.2023

43	Shëndeti Oral	08.12.2023
44	Ushqyerja me gji një sfidë për të gjithë	11.12.2023
45	Tromboza e venave të brendshme	16.12.2023

III. SEKTORI I STOMATOLOGJISË

Sektori i Stomatologjisë në kuadër të QKMF – së në Ferizaj organizon punën në tri shtylla kryesore:

1. Shërbimet stomatologjike primare - shtrihet përveç QKMF – së edhe nëpër QMF-të në qytet dhe disa fshatra
2. Shërbimet stomatologjike sekondare - në QKMF dhe
3. Laboratori dentar - vetëm në QKMF.

Numri i shërbimeve të ofruara në këtë sektor gjatë **vitit 2023** është paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 20. Shërbimet stomatologjike

Llojet e shërbimeve	Me pagesë	Pa pagesë	Totali
Vizita specialistike	325	3487	3812
Vizita stomatologjike	2047	10180	12227
Nxjerrje me anestezion	1217	2528	3745
Nxjerrje pa anestezion	33	2189	2222
Aplikim i barit me anestezion	12	134	146
Drenazhë	339	3020	3359
Aplikim i barit	776	3946	4722
Ekstirpim vital me mbushje	29	125	154
Ekstirpim mortal	121	506	627
Mbushje e kanalit	127	497	624
Amalgam pllombë	350	354	704
Helio pllombë	645	598	1243
Largimi i shtresave të buta	16	55	71
Pastrimi i dhëmbëve	74	143	217
Përpunimi i xhepit paradontal	5	25	30
Incizioni	30	166	196
Alveoliti	6	41	47
Ndalja e gjakderdhjes	3	10	13
Kiretazha	30	145	175
Rindërtimi me vidë	1	1	2

Heqja e urës	1	14	15
Cementimi i urës	3	3	6
Proteza parciale	51	3	54
Proteza totale	137	2	139
Cementimi i kurorës	1	0	1
Reparatura	138	11	149
Korektura e protezës	4	225	229
Ribazimi i protezës	5	9	14
Vendosja e dhëmbit në protezë	92	3	95
Amputimi i rrënjës	0	1	1
Frenektomia	0	1	1
Florizimi	0	1	1
Vulosja e fisurave	0	34	34
Vizita sistematike	0	388	388
Totali	6587	28 643	35 220

Ndërsa, numri i shërbimeve të ofruara gjatë **vitet 2023** në secilën njësi të Sektorit të Stomatologjisë është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 21. Shërbimet stomatologjike sipas qendrave

Qendra	Numri i shërbimeve
QKMF	19322
QMF 1	2563
QMF 2	2684
QMF 3 - Greme	470
QMF 4	4032
QMF 5 - Komogllavë	245
QMF 6 - Pleshinë	200
QMF 7 - Neredime	69
QMF 8 - Dardani	362
QMF 9 - Softaj	219
Kujdestaria e natës	3439
Kujdestaria e të dielave	1615
Gjithsej	35220

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmblëdhur rezultatet e të gjitha shërbimeve mjekësore, infermierike dhe të tjera të ofruara në të gjitha qendrat dhe njësitë gjatë **vitet 2023**:

Tabela 22. Të gjitha shërbimet e ofruara në QKMF gjatë vitit 2023

QKMF - FERIZAJ		RAPORTI I PËRGJITHSHËM JANAR-DHJETOR 2023		
REKAPITULIM I SHËRBIMEVE NË QKMF-FERIZAJ				GJITHSEJ
M J E K Ë S I A F A M I L J A R E	VIZITA MJEKËSORE	Vizita nga MF dhe MP	237436	280 849
		Vizita të përsëritura	13387	
		Vizita specialistike	30026	
	SHËRBIMI EMERGJENT PRIMAR		4128	701 467
	SHËRBIMET INFERMIERIKE DHE TË TJERA	THERRJE I.M.	81821	
		THERRJE I.V.	2768	
		INFUZONE	48096	
		LIDHTORE	25670	
		TRIAZHIME	137018	
		INHALIME	1727	
		VIZITA SHTËPIAKE PALIATIVE	4710	
		FIZIOTERAPI	4452	
		KËSHILLA	129506	
		KATETERIZIM	600	
		LABORATORI	ANALIZA URINE	
			ANALIZA GJAKU	
		KAN	4392	
		ECHO	438	
		EKG	5218	
		MATJA E GLIKEMISË	497	
		VAKSINA	33838	
		RTG	12953	
		MAMOGRAFIA	3914	
		SHËRBIMI PODIATRIK	648	
		PSIKOLOGU	1408	
		PPD	531	

	SHËRBIME ANTITUBERKULARE	3793	
	SHËRBIME PATRONAZHI	1533	
	VIZITA SHTËPIAKE PËR NËNA DHE FËMIJË	4861	
	KËSHILLA PËR GRA SHTATZËNA	177	
	RTG I DHËMBIT	0	
	SHPËRLARJA E VESHIT	484	
	SHËRBIME NË FARMACI	30436	
	OKSIGJENOTERAPIA	85	
	SHPËRLARJA E SYRIT	87	
	DEBRIDMAN I THOIT	80	
	GRUPET VETPËRKRAHËSE PËR DIABETIKË	144	
	CERTEFIKATA MJEKËSORE	987	
	SHËRBIME STOMATOLOGJIKE	35220	35220
	GJITHSEJ SHËRBIME NË QKMF		1 017 536

IV. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Në kuadër të Sektorit të Administratës janë këto shërbime: Shërbimi juridik, Shërbimi i Financave dhe Kontabilitetit, Shërbimi i autoambulancave dhe Servisimit, si dhe Shërbimi i Teknik dhe i Mirëmbajtjes.

4.1. ZYRA PËR SHËRBIME JURIDIKE

Në këtë shërbim aktualisht mbahet dosja personale për 318 punëtorë, të cilët në intervale të ndryshme marrin pushime pa pagesë, pushime të lehonisë, pensionohen etj. prandaj gjatë **viti 2023** lista e punëtorëve ishte si në vijim:

Tabela 23. Ndryshimet në listën e punëtorëve të QKMF-së çdo muaj

	Me 70 % pagesë	Me 50 % pagesë	Pa pagesë	Të larguar nga lista	Të rinj	Në pension	Korrigjime	Numri në listë
Janar	2	-	8	1	12	-	-	319
Shkurt	2	-	7	-	-	-	-	318
Mars	2	-	7	-	-	-	-	318
Prill	1	-	8	-	-	2	-	320
Maj	1	-	9	2	2	-	-	320
Qershor	1	-	7	-	-	-	-	320
Korrik	1	-	7	-	-	-	-	320
Gusht	1	-	6	1	-	1	-	319
Shtator	1	-	6	-	-	-	-	319
Tetor	2	-	10	-	-	4	-	318
Nëntor	4	-	9	6	-	1	8	313
Dhjetor	3	-	9	1	-	0	9	318

Gjatë kësaj periudhe përmes arkivit të këtij shërbimi kanë kaluar **946** shkresa.

Tabela 24. Shkresat e protokolluara në arkiv

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VII I	IX	X	XI	XII	Totali
Kërkesa	19	32	51	41	36	21	24	35	60	48	85	18	470
Vërtetime	55	24	40	23	29	21	12	20	26	49	36	44	379
Raporte	2	1	2	2	1	1	2	2	1	2	2	2	20
Njoftime	20	1	1	1	0	0	2	1	3	3	4	2	38
Vendime	16	18	8	16	15	11	3	7	6	11	17	11	139
Të tjera	21	72	30	25	35	6	14	18	13	30	10	26	300
Totali	133	148	132	108	116	60	57	83	109	143	154	103	1346

4.1.1. Shërbimi teknik dhe i mirëmbajtjes

Përveç obligimeve të përditshme punëtorët e këtij shërbimi kanë kryer edhe punë të tjera, si: rregullimin e pajisjeve të ndryshme, punët e zdrukthtarisë, ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik, mirëmbajtjen e oborrit si në QKMF ashtu edhe në objektet e qendrave të tjera (QMF) brenda qytetit dhe në AMF-të dhe QMF-të nëpër fshatra, objektin e SHEP, QTMF dhe DAT-it. Gjatë **vitit 2023** punëtorët e këtij shërbimi kanë mbikëqyrur sistemin e ngrohjes në të gjitha objektet, kanë ndezur kaldajat me pelet, ato me dru dhe naftë, duke i mirëmbajtur dhe furnizuar me lëndë djegëse në vazhdimësi. Gjithashtu, personeli i shërbimit teknik është marrë edhe me riparimin e defekteve në sistemin e tubave të ujësjellësit, defektet në rrjetin elektrik, etj. Është bërë furnizimi me gaz dhe oksigjen i QMF-ve dhe AMF-ve. Personeli i mirëmbajtjes çdo ditë është marrë me pastrimin e hapësirave të punës në të gjitha objektet, si dhe pastrimin dhe hekurosjen e çarçafëve për shtretërit e pacientëve.

4.1.2. Shërbimi i Autoambulancave dhe Servisimit

Raporti i autoparkut dhe servisimit përbëhet nga:

1. Raporti për qarkullimin e autoambulancave, relacioni i tyre dhe
2. Raporti për harxhimet e derivateve dhe kilometrat e kaluara

- Deklaratë për falje nga Emin Hyseni nga fsh. Bibaj falë ngastrën kadastrale 443-2 ZK Bibaj me sip. 200 m2.
- Deklaratë për falje nga Bedri Isufi etj nga Ferizaj falin ngastrat kadastrale 3712-3 ZK Jezerc me sip. 890 m2, ngastrën kadastrale 3071-10 ZK Jezerc me sip. 473 m2, dhe ngastrën kadastrale 3070-2 ZK Jezerc me sip. 135 m2.
- Deklaratë për falje nga Qerim Ramadani nga fsh. Rahovicë falë ngastrat kadastrale 2329-3 ZK Rahovicë me sip. 358 m2 dhe ngastra kadastrale 528-0 ZK Rahovicë me sip. 542 m2.
- Deklaratë për falje nga Jetmir Grainca nga Ferizaj falë pjesën e ngastrës kadastrale 3399-0 ZK Ferizaj me sip. 784 m2.
- Deklaratë për falje nga Hazir Ahmeti nga Ferizaj falë ngastrën kadastrale 781-1 ZK Nikadin me sip. 410 m2.
- Në Sektorin e Pronës vullnetarisht pronarët e paluajtshmërive në zonën urbane dhe rurale kanë falur prona tyre për rrugë me sipërfaqe totale prej 32,936.00 m² ose (3.29.36. ha).
- Përfaqësime në Gjykatën Themelore në Ferizaj në cilësinë e përfaqësuesit juridik 46
- Përgjigje në padi, me paditë e ushtruar në Gjykatë lidhur me shpronësime - 18
- Ankesa e ushtruar Gjykatës së Apelit kundër Aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Ferizaj - 4
- Punë në terren me Komisionin për Dhënie të Pronave Komunale në Shfrytëzim për të gjitha bizneset që operojnë në ZK. Babush dhe Prelez i Muhaxherëve (Raporti për këto biznese).
- Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive ndaj vendimeve të Inspektoratit Komunal gjatë numri i ankesave të shqyrtuara - 21
- Njoftime për bankë - 13



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Burim Bajrami
Drejt看 i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në kuadër të aktivitetit të saj ka në përbërje katër njësi:

- Njësine e Lavërtarisë,
- Njësine e Blegtorisë,
- Njësine e Zhvillimit Rural,
- Njësine e Pylltarisë.

Të gjitha këto njësi kanë në kuadër të tyre staf të përgatitur profesional dhe aktivitetin e tyre e zhvillojnë konform rregullave dhe ligjeve të parapara në këtë sektor.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë gjatë periudhës raportuese në vazhdimësi ka zbatuar politikat sektoriale sipas:

- Strategjive zhvillimore,
- Planit të punës së drejtorisë të hartuar për vitin 2023,
- Planit Zhvillimor Komunal,
- Vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe sipas kërkesave të qytetarëve.

Aktivitetet e Drejtorisë gjatë kësaj periudhe janë fokusuar kryesisht në realizimin e subvencioneve dhe projekteve si dhe në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave në lëmi të ndryshme të fermerëve.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë gjatë vitit 2023 ka zhvilluar këto aktivitete:

- 1.Furnizimi i fermerëve me serra** - Janë ngritur 139 serra me sipërfaqe 50m² dhe 10 serra me sipërfaqe 300m². Në këtë subvencionim është përfshirë konstruksioni i serrës, folia, transporti, punët rreth vendosjes së serrës dhe sistemi i ujitjes. Interesimi i fermerëve ka qenë shumë i madh për këtë projekt, kanë aplikuar për serra të vogla 593 fermerë ndërsa për 10 serra të mëdha kanë aplikuar 77 fermerë.
- 2. Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra-** Me këtë subvencionim janë ngritur 5 ha me pemishte të arrave, përfitues kanë qenë 10 fermerë me nga 0.50 ha. Subvencionimi ka qenë në sigurimin e fidaneve dhe të sistemit të ujitjes për pemishtet që do të ngriten.

- 3. Furnizimi i fermerëve kultivues të grurit me impure bujqësore** – Me këtë projekt janë përkrahur 361 fermerë me pleh artificial azotik me 27% N, sasia e plehut që janë subvencionuar fermerët ka qenë 150000 kg. Sasia e plehut është shpërndarë te fermerët në mënyrë proporcionale me sipërfaqen e mbjellur të grurit, përfitues kanë qenë fermerët që kishin 3 ha e më tepër sipërfaqe të mbjellur me grurë. Projekti është realizuar tërësisht sipas procedurave të planifikuara.
- 4. Subvencionimi i fermerëve me motokultivatorë** – Me këtë projekt janë përkrahur 70 fermerë kultivues të perimeve me nga një motokultivator 4.4 kë, për shkak të rëndësisë që kanë këto pajisje numri i fermerëve aplikues ka qenë shumë i madh, për këto pajisje kanë aplikuar 314 fermerë.
- 5. Furnizimi i fermerëve me fidane për ngritjen e pemishteve me pemë të imta – dredhëza** - Me këtë projekt janë përkrahur fermerët për ngritjen e 2.50 ha pemishte me dredhëza. Me realizimin e këtij projekti kanë qenë 5 fermerë përfitues për ngritjen e pemishteve me dredhëza me nga 0.50 ha sipërfaqe. Përkrahja ka qenë në: sigurimin e fidaneve të dredhëzave, folinë dhe sistemin e ujitjes për ato sipërfaqe që janë ngritur.
- 6. Organizimi i trajnimeve për fermerët në lëmi të ndryshme** – Gjatë implementimit të këtij projekti janë organizuar trajnime në lëmi të ndryshme të bujqësisë, janë mbajtur trajnime teorike, praktike dhe vizita në terren. Pjesëmarrës në të gjitha këto trajnime kanë qenë rreth 150 fermerë varësisht nga veprimtaria e tyre.
- 7. Furnizimi i fermerëve me spërkatëse** – Me realizimin e këtij projekti janë përkrahur 50 fermerë kultivues të perimeve me nga një spërkatëse me kapacitet prej 45 litrave. Këto pajisje janë shumë efektive dhe ua lehtësojnë punën fermerëve gjatë mbrojtjes së kulturave perimore nga sëmundjet dhe dëmtuesit.
- 8. Rregullimi i dhomave ftohëse për ruajtjen e pemëve dhe perimeve** – është një prej projekteve shumë të rëndësishme që ndikon në zhvillimin e bujqësisë. Me realizimin e këtij projekti janë siguruar - rregulluar 5 dhoma ftohëse me kapacitet prej 80 m³, përfitues kanë qenë 5 fermerë që kanë kapacitete më të mëdha të kultivimit të pemëve dhe perimeve. Projekti është implementuar tërësisht sipas procedurave të planifikuara.

9. Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor – Është një prej projekteve shumë të rëndësishme ngase ndikon në zhvillimin e një bujqësie intensive. Kërkesat e fermerëve për këtë projekt janë shumë të mëdha. Këtë vit kanë aplikuar rreth 319 fermerë prej tyre janë 173 përfitues me këto lloje të pajisjeve:

Nr.	Emërtimi i pajisjes bujqësore	Sasia/copë
1.	Mbjellëse e misrit 4 rendëshe automatike	25
2.	Roto kosa 135	21
3.	Pllugj 3 brazdësh statik	16
4.	Pjatore 32 rendëshe	12
5.	Spërkatëse 400 litra	25
6.	Shpërndarëse plehu 350 litra	15
7.	Grabuja diellore	3
8.	Trina 4 krahëshe	9
9.	Freza 1.6 m	47
	Gjithsej	173

Shpërndarja e pajisjeve do të bëhet në fillim të vitit 2024.

10. Furnizimi i fermerëve me folie dhe sistem të ujitjes – Me këtë projekt përkrahen fermerët kultivues të perimeve me folie të zezë dhe me sistem të ujitjes. Përkrahja do të jetë për 24 fermerë, ku sasia do të jetë varësisht nga sipërfaqet që mbjellin. Shpërndarja e furnizimeve do të bëhet në fillim të vitit 2024.

11. Kompenzimi i dëmeve në bujqësi – Drejtoria e Bujqësisë për vitin 2023 në kuadër të subvencioneve ka ndarë një buxhet për kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe dëmet tjera në ferma. Varësisht nga dëmet e shkaktuara fermerët kanë bërë kërkesat në Drejtorinë e Bujqësisë. Komisioni i formuar nga ekspertët e kësaj drejtorie i ka shqyrtuar ato kërkesa, ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe i është bërë pagesa. Sipas vlerësimit kompenzimi iu është bërë 57 fermerëve.

12. Furnizimi me arka për pemë për pemëtarët e Komunës së Ferizajt – Me këtë subvencionim kryesisht janë përkrahur fermerët që janë kultivues të mollave, fermerët janë përkrahur me 380 arka që nevojiten për ruajtjen dhe transportin e frutave të mollave. Janë përkrahur 9 fermerë dhe sasia është përcaktuar varësisht nga kapaciteti i pemishteve që posedojnë fermerët.

- 13. Rregullimi i rrugëve të arave me zhavorr-** Është një prej projekteve shumë të rëndësishme që u mundëson fermerëve qasje më të lehtë dhe shfrytëzim më racional të tokave bujqësore, njëherit mundëson edhe shfrytëzimin e mekanizimit bujqësor më të avancuar. Në vitin 2023 është arritur të rregullohen rreth 2000 m rrugë të arave, rrugët e shtruara kryesisht përfshijnë fshatrat Pojatë, Rahovicë dhe Muhoc dhe disa të tjera janë në proces të punës drejt përfundimit.
- 14. Ndërtimi i silloseve për ruajtjen e grurit** – Realizimi i këtij projekti është një indikator që ndikon në stimulimin e fermerëve për rritjen e sipërfaqeve të mbjellura me kulturën e grurit, ua mundëson fermerëve ruajtjen e grurit në kushte më të mira, ua mundëson ruajtjen e grurit deri në momentin kur tregu iu ofron çmime më të larta. Është projekt trevjeçar, ofron një kapacitet të deponimit të grurit deri në 8000 tonë. Implementimi ka filluar gjatë vitit 2023 dhe janë kryer të gjitha punët sipas planit të paraparë për këtë vit.
- 15. Hapja e kanaleve për rregullimin e tokave** – Ky projekt është trevjeçar, me këtë projekt deri më tani janë hapur rreth 10000 metra kanale kulluese të tokave bujqësore dhe përmes saj është arritur të mbrohen nga vërshimet dhe përmbytjet qindra hektarë tokë të punuara.
- 16. Rregullimi i Qendrës së Panaireve – Hipodromi** – Është projekt trevjeçar, ku fermerët e kanë mundësinë që pas përfundimit të investimeve në këtë vend të zhvillojnë aktivitete të ndryshme si panaire, gara apo kalërimë kuajsh etj. Është një mundësi shumë e mirë për të gjithë fermerët që janë të interesuar t'i ekspozojnë aktivitetet apo produktet e tyre bujqësore. Realizimi i projektit ka filluar gjatë vitit 2023 dhe janë kryer punët që ishin të planifikuara gjatë këtij viti si: pastrimi i terrenit, punët tokësore (gërmimet, rrafshimi i terrenit, ngjeshja etj).
- 18. Subvencionimi i fermerëve me koshere të bletëve**– Me këtë subvencionim fermerët kultivues të bletëve janë përkrahur me koshere dy katëshe të kombinuara dru dhe plastik. Përfitues janë fermerët të cilët kanë mbi 30 zgjoje të bletëve. Janë shpërndarë 330 koshere tek 133 fermerë varësisht nga numri i zgjojeve të bletëve që posedojnë në bletishten e tyre.
- 19. Furnizimi i fermerëve me centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit** – Për një punë më efektive dhe më të shpejtë për bletarët rol të rëndësishëm ka përdorimi i pajisjeve për bletë e sidomos makinat për nxjerrjen e mjaltit. Me këtë projekt janë furnizuar 25 fermerë me nga një centrifugë elektrike.

20. Ndërtimi i shtëpizave për apiterapi - Trajtimi me apiterapi është një lloj terapie alternative që përdor produkte që shfrytëzohen drejtpërdrejt nga bletët. Me këtë projekt janë përkrahur 3 bletarë mbarështues të bletëve për ndërtimin shtëpizave dhe blerjen e pajisjeve për Apiterapi.

Për menaxhimin e problemit të qenve endacak Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar këto projekte :

21. Projekti i trajtimit të qenve endacak - Duke pasur kërkesa të shumta nga ana e qytetarëve për qentë endacak dhe rrezikun që paraqesin për jetën e qytetarëve e sidomos fëmijëve që shkojnë në shkollë, Drejtoria e Bujqësisë është duke e realizuar projektin për trajtimin e qenve endacak ku përfshihen: kapja e qenve, kontrolli klinik, mjekimi, vaksinimi, dehelmetizimi, kastrimi apo sterilizimi varësisht nga gjinia, vendosja e mikroqipit dhe matrikulit, hospitalizimi dhe eutanazia sipas vlerësimit të ekspertëve. Deri më tani janë trajtuar mbi 200 qen.

22. Rregullimi i katër pikave për vendosjen e ushqimit dhe ujit të pijes (Pikat ushqyese) -

Për uljen e agresivitetit të qenve endacak, Drejtoria e Bujqësisë edhe këtë vit ka realizuar projektin për vendosjen e katër pikave për vendosjen e ushqimit dhe ujit të pijes, duke i bërë gjithsej tetë pika ushqyese për ushqimin e qenve endacak.

23. Fushatë vetëdijësuese, sjellja dhe kujdesi ndaj qenve endacak –Duke e ditur se edhe qentë endacak janë pjesë e tokës, edhe ata kanë emocione, kanë dhimbje, vuajnë nga braktisja, që të mos shprehin agresivitetin e tyre, përmes këtij projekti për mënyrat e sjelljes dhe kujdesit ndaj tyre janë organizuar trajnime, janë shtypur fletushka vetëdijësuese dhe është përgatitur një videospot që po shfaqet nëpër të gjitha televizionet lokale.

24. Furnizimi i fermerëve me makina (printerë) për vulosje të vezëve - Fermerët janë furnizuar me nga një makinë për vulosjen e vezëve të cilët në fermat e tyre kanë mbi 5000 pula vojse. Me këtë projekt janë furnizuar 3 fermerë me nga një makinë të sofistikuar për vulosjen e vezëve.

25. Mbarësimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave - Që ferma të jetë rentabile, përveç ushqimit të mirë, patjetër që duhet të investohet në përzgjedhjen e drejtë të racës së kafshës, me këtë mundësohet kontrolli i sëmundjeve infektive dhe trajtimi i problemit të fertilitetit të ulët. Përmes këtij projekti janë kryer 1274 mbarësime artificiale në lopë dhe mështjerra.

26. Vaksinimi i fondit blegtoral – Në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale kjo masë preventive kundër sëmundjeve infektive (sëmundjeve clostridiale) është bërë tek gjedhet, delet dhe dhitë. Janë vaksinuar 2978 krerë gjedhë dhe bagëti të imëta (dele dhe dhi) 11472 krerë.

27. Rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore- Sëmundjet e thundrrave ndikojnë në shëndetin dhe prodhimtarinë blegtorale ku vjen deri te rënia e prodhimtarisë e njëherit edhe tek humbjet ekonomike në ferma. Me këtë projekt është bërë rregullimi i thundrrave të 1904 krerëve lopë qumështore.

28. Repelimi i gjedheve dhe bagëtive të imëta - Kjo masë preventive është bërë tek fondi blegtoral me qëllim të luftimit kundër sëmundjeve virale, bakteriale dhe parazitare të transmetuara nga insektet e ndryshme.

Janë repeluar nga dy herë fondi i tërësishëm blegtoral në fermat komerciale dhe gjysëmkomerciale si në vijim:

1. Gjedhë (lopë të qumështit, mëshqerra dhe viqa) 5660 krerë,
2. Bagëti të imëta (dele, dhi) 20000 krerë.

- Drejtoria e Bujqësisë ka kryer të gjitha procedurat për realizimin e projekteve të cekura më lartë, ka bërë menaxhimin e projekteve deri në përfundimin e tyre, ka bërë pagesat sipas kontratave të nënshkruara dhe vazhdon monitorimin e mëtutjeshëm.

Përveç projekteve të cekura më lartë në Drejtorinë e Bujqësisë janë kryer edhe këto aktivitete:

- Aplikimi i fermerëve për subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ky aplikim është kryer në zyrat e Drejtorisë së Bujqësisë, ishte një punë shumë voluminoze ku ishte angazhuar i tërë stafi i Drejtorisë së Bujqësisë në kryerjen e këtyre punëve:

- Shpallja e njoftimeve për aplikim për subvencione,
- Caktimi i termineve të fermerëve për aplikim,
- Kontrollimi dhe pranimi i dokumenteve,

- Regjistrimi në Regjistrin e Fermës,
- Digjitalizimi i parcelave në ELPIS,
- Aplikimi online për të gjitha subvencionet në EFR.

Gjatë vitit 2023 për subvencionet nga MBPZHR në Drejtorinë e Bujqësisë kanë aplikuar gjithsej 1213 fermerë për këto subvencione: lopë 1602 krerë, dele 7152 krerë, dhi 380 krerë, pula 107800 copë, bletë 8478 zgjoje, grurë 3881.84 ha, misër 2474.13 ha, elbi 8.3 ha, thekra 25.34 ha, molla 55.27 ha, kumbulla 16.82 ha, aronia 4.93 ha, arra 77.63 ha, vishnje 3 ha, lajthia 40 ha, patate 25.41 ha, kunguj 17.09 ha, qepë 5.87 ha, shalqin 2.68 ha, lakra 5.61 ha, tërshëra 58.62 ha, kunguj të misirit 2.54 ha, dredhëza 10.78 ha, fasule 23.62 ha, domate 0.1 ha, marulla 0.54 ha, specia 1.94 ha, dardha 1.66 ha, kajsia 0.58 ha, bimë mjekësore dhe aromatike 15.85 ha, perime në serra 3.74 ha, qershia 7.37 ha, material fidanor 309720 copë, pjeshka 0.33 ha, hardhia 0.71 ha dhe luledielli 83.46ha. Kanë aplikuar për sasi dhe cilësi të qumështit, viqa për majmëri dhe primin e sigurimit bujqësor 82 fermerë.

Në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë janë bërë:

- Pagesat për të gjitha subvencionet dhe projektet e realizuara,
- Pagesat për të gjitha kategoritë e shërbimeve dhe mallrave,
- Janë bërë raportet mujore dhe gjashtëmujore për faturat e papaguara,
- Planet dhe raportet e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore,
- Janë bërë përgatitjet për korrje-shirje dhe raportet e korrje shirjeve,
- Kemi bërë edhe vlerësimin e dëmeve sipas kërkesave të fermerëve që kompenzohen nga Qeveria e Kosovës,
- Jemi të kyçur në komisionin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,
- Janë pajisur fermerët me vërtetime si prodhues bujqësor për nevoja të tyre personale,
- Të gjitha kërkesat që i janë drejtuar kësaj Drejtorie janë shqyrtuar dhe janë zgjedhur konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Sektori i Pylltarisë

Mbrojtja e pyjeve

Fletëparaqitjet e ngritura (rojet, stafi dhe konfiskimet)

a)Fletëparaqitje Penale

Lëndë 31 me vëllim 100.70 m³ në vlerë 14413.54 €

b)Fletëparaqitje për Kundërvajtje

Lëndë 135 me vëllim 174.12 m³ në vlerë 23926.00 €.

Gjithsej fletëparaqitje:

Fletëparaqitje -165 copë

Vëllimi – 274.02 m³

Vlera –38339.54 €

Konfiskimi i masës drusore

Dru zjarri- 62.20 m³.

Dru teknik–0.0 m³

Masa e druve të konfiskuar është proceduar sipas procedurave të prokurimit dhe UA për shitblerjen e asortimenteve drusore ku janë shitur 86.00 m³ dru zjarri në vlerë prej 4386.00 € të cilat janë të hyra të Komunës, ndërsa nga Inspektorati i Pylltarisë janë konfiskuar 1.60 m³.

Kontrollet pyjore

Janë zhvilluar mbi 75 kontrolle dhe monitorime të pyjeve publike si dhe në kryerjen e shërbimeve në pyje private në rrugët pyjore dhe jopyjore. Shoqëruar nga Policia, janë bërë 15 kontrolle pyjore.

Takimet e mbajtura

Janë mbajtur takime sipas nevojës me roje të pyjeve dhe teknik, ku rojeve iu janë dorëzuar materialet e punës si (ditarët e punës dhe librat e cungjeve, çekanat e dëmeve pyjore).

Poashtu kemi mbajtur takime me Polici, me inspektorë të pylltarisë lidhur me realizimin e planeve menaxhuese për vitin 2023, për regjistrimet e dëmeve pyjore për vitin 2023, për gjueti etj.

Mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe sëmundjet

Gjatë kësaj periudhe në pyjet e Komunës së Ferizajt nuk kemi patur zjarre.

Seancat gjyqësore, pasqyra e aktgjykimeve dhe aktvendime

Gjatë këtij viti janë mbajtur 40 seanca në Gjykatën Themelore –Divizioni Penal në Ferizaj.

Aktgjykimet e pranuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj-Divizioni Penal.

Gjithsej-29 aktgjykime.

Pozitive-17, Të pezulluara-10 dhe negative-2.

Aktvendimet e pranuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj-Divizioni për Kundërvajtje.

Gjithsej-153 aktvendime

Pozitive-113, Të pezulluara-139 dhe negative -1.

Gjatë këtij viti janë përgatitur 192 aktvendime kundërvajtëse për t'u dërguar në Gjykatën për Kundërvajtje për t'u bërë të plotfuqishme për kompensim të dëmit pyjor.

Poashtu edhe 64 aktgjykime të penale janë përgatitur për tu dërguar në Gjykatën Penale për tu bërë të plotfuqishme kompensimin e dëmit pyjor.

Tek përmbaruesi privat kemi bërë propozim për kompenzim të dëmit pyjor për 175 aktgjykime të kundërvajtjes dhe penale të cilat kanë qenë të plotfuqishme.

Nga përmbaruesi privat gjatë kërrij viti kemi pranuar 35 urdhërpagesa të kompensimit të dëmit pyjor në vlerë prej 8322.55 €.

Ndërsa 6 palë në emër të kompensimit të dëmit pyjor drejtpërdrejtë përmes faturave të Komunës kanë paguar 892.65 €.

Shfrytëzimi në pyjet publike, damkimi, realizimi etj.

Gjatë këtij viti sipas planeve menaxhuese të APK-së dhe sipas UA për shitblerjen e masës drusore në pyje publike janë shfrytëzuar në dy ngastra pyjore masa drunore me vëllim prej:

Ngastra pyjore 21-NTPSH “LYPETENI”

Dru teknik-322.49 m³ dhe Dru zjarri-340.750 m³

Ngastra 22-NTP “METI COMERC”

Dru teknik-519.02 m³ dhe dru zjarri-833.39 m³

Furnizimi i ekonomive familjare me dru zjarri

Për furnizim me dru zjarri për ekonomitë familjare për zonat rurale, sipas damkimit nga APK-ja është realizuar kjo masë drusore nëpër Njësi Menaxhuese në këto ngastra:

Njësia Menaxhuese “Zhegoc”

Ngastra 23 janë realizuar- 15.88 m³ dru zjarri pastrim fitosanitar të llojit pishë.

Njësia Menaxhuese “Neredime-Jezerc”

Ngastra 60: Janë realizuar – 36.55 m³ dru zjarri

Ngastra 61: Janë realizuar – 26.92 m³ dru zjarri të llojit ahu.

Ngastra 102: Janë realizuar – 50.36 m³ dru zjarri të llojit ahu

Ngastra 108: Janë realizuar -44.30 m³ dru zjarr të llojit ahu

Ngastra 46: Janë realizuar -173.56 m³ dru zjarri të llojit ahu

Gjithsej shitje me pakicë janë realizuara 347.57 m³ dru zjarri

Shërbimet dhe shfrytëzimi në pyje private

Gjatë këtij viti nga pronarë të pyjeve private kemi pranuar 25 kërkesa për lejimin e shfrytëzimit me dru zjarri.

Poashtu nga pronarët privatë kemi pranuar 11 kërkesa për furnizim me dru zjarri në pronat e tyre (toka bujqësore, kullosa etj).

Nga APK-ja është bërë damkimi i trungjeve në pyje private me vëllim prej: dru teknik -17.41 m³ dhe dru zjarri- 543.57m³.

Janë lëshuar 29 leje për prerje me vëllim: dru teknik-6.83 m³ dhe dru zjarri 578.52 m³.

Janë vulosur dru zjarri-268.71 m³ dhe dru teknik-0.00 m³.

Janë lëshuar 78 fletëpërcjellëse me vëllim prej 203.73 m³.

Regjistrimet e dëmeve pyjore

Gjatë vitit 2023 është bërë regjistrimi i dëmeve pyjore në këto rajone:

Njësia Menaxhuese “Neredime-Jezerc”-Rajonet: Lumi i Madh, Pleshina 2 (regjistrim i jashtëzakonshëm), në Njësinë Menaxhuese “Zhegoc” Zhegoc 1 dhe Zhegoc 2.

Të hyrat nga pagesat e APK-së

-Taksa për shitjen e masës drusore në këmbë.....	43727.15 €
-Taksa nga shitja në cung (prerje sanitare).....	6355.18 €
-Taksa nga pastrimet në pyll.....	2767.74 €
-Taksa nga shërbimet e pyjeve private.....	927.17 €
-Taksa për ritransport në pyje publike-----	4.87 €
Gjithsej të hyra-----	53782.11€



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Arben Halili

Drejt看 i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjcncë

1. HYRJE

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në kuadër të fushë veprimtarisë së vetë ka sektorin e shërbimeve publike dhe sektorin e emergjencave.

Sektori i shërbimeve publike mbulon aktivitete që ndërlidhen me mirëmbajtjen e hapësirave publike si mirëmbajtja e rrugëve me asfalt, me zhavorr, riparimin e trotuareve, pastaj mirëmbajtja e rrugëve me shenja të komunikacionit si ato horizontale dhe vertikale, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara si sheshet, parqet, drunjtë dekorativ, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik si dhe zgjerimin e tij aty ku paraqiten nevojat sipas mundësive buxhetore, pastaj mbarëvajtjen e komunikacionit rrugor dhe atij të mallrave, mirëmbajtjen e infrastrukturës nëntokësore si rrjeti i kanalizimit atmosferik dhe atij fekal, rrjetin e ujësjellësit etj, çdo herë në koordinim edhe me ndërmarrjet publike për detyrat dhe obligimet që ato i kanë ndaj qytetarëve të përcaktuara me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Komuna në territorin e saj organizon mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin, përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore si vërshimet, rrëshqitjet e dheut apo erërat, si dhe fatkeqësi tjera natyrore që mund të ndodhin në Komunën e Ferizajt.

Në të njëjtën kohë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë zhvillon aktivitete për shënimin e datave të rëndësishme mjedisore si dhe dekorimin e qytetit për festat e fund vitit dhe festave tjera zyrtare.

Gjatë vitit 2023 janë pranuar 1706 kërkesa nga zyra pritëse të adresuara nga qytetarët për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, pas shqyrtimeve të gjitha janë shpërndarë tek zyrtarët përkatës të Drejtorisë të cilat pas verifikimeve në terren disa prej tyre janë miratuar disa janë refuzuar e disa janë në proces.

Kërkesa të pranuar	Kërkesa të miratuara	Kërkesa të refuzuara, anuluara	Kërkesa në proces, pezulluara, ceduar
1706	1362	232	112

2.SEKTORI I EMERGJENCAVE

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, stafi i sektorit të emergjencave është munduar që të përmbush këto obligime që dalin nga ligji duke kryer këto detyra në terren që lidhen me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

- Gjatë këtij viti kemi pranuar kërkesa të natyrave të ndryshme, ku të gjitha janë shqyrtuar.
- Mbikëqyrja e kryerjes së punëve në pastrimin e rrugëve të qytetit dhe fshatrave gjatë sezonit dimëror dhe veror ku për këtë qëllim të kontraktuara janë operatorë ekonomik privat dhe publik.
- Menaxhimi-shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si reshjet e shiut, borës, erërave dhe rastet e zjarreve në bashkëpunim me Policinë, zjarrfikësit, kompanitë publike. Vlen të përmenden si pasojë e reshjeve të dendura të shiut, breshrit, erës së fort në muajin Korrik, ka pasur dëme materiale përfshirë ekonomitë familjare, biznese të ndryshme, si dhe dëme në sektorin e bujqësisë.
- Është bërë mirëmbajtja e hapësirave nëpër institucione publike nga N.P.L “Ambienti” në qytet dhe fshatra si: Oborret e zyrave të gjendjes civile, qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancat, parqet, kopshtet e fëmijëve, bibliotekave dhe fushave sportive, hapësirat publike të banesave të vjetra kolektive, prerja dhe largimi i drunjve që paraqesin rrezik, rregullimi i ulëseve dhe shportave të mbeturinave, vendosja (zëvendësimi) i flamujve.
- Është bërë pastrimi, larja, mirëmbajtja e rrugëve, parqeve, shesheve, lapidarëve, mirëmbajtja e hapësirës së Varrezave të Dëshmorëve, krasitja e drunjve dekorativ në hapësirat qytetit të Ferizajt.
- Po ashtu edhe gjatë vitit 2023 kemi vazhduar me operatorin ekonomik për pastrimin e varrezave të qytetit të të gjitha kulteve fetare si ato myslimane, katolike dhe ortodokse.
- Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga AKK-së dhe GIZ-i gjerman për menaxhimin e mbeturinave, trajnimet janë mbajtur brenda dhe jashtë vendit.
- Trajnimi për stafin - punëtorët teknik të shkollave të Ferizajt, për përdorimin e bombolave për fikjen e zjarrit, si masë preventiveve për fikjen e zjarrit, trajnimi është bërë në bashkëpunim me Shoqatën e pensionistëve të TMK-së/ FSK-së dhe simpatizantëve “Elita”, trajnimi është bërë në 47 shkolla fillore dhe të mesme apo 98 pjesëmarrës – punëtorë teknik, trajnimi është bërë gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2023.

2.1 Hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore dhe shtretërve të lumenjve

Me qëllim mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve, kanaleve ujore dhe rregullimi i argjinaturave për të eliminuar vërshimet gjatë reshjeve janë hapur 18.500m¹ gjatësi të kanaleve dhe shtretërve të lumenjve dhe janë eliminuar 95m³ të shkurreve dhe drunjve 45 orë pune e punëtorëve fizik në pastrim të lumenjve nga mbeturinat e ndryshme, vendosja e gypave 8metra f1000, si dhe 3metra f1500.

Me qëllim të eliminimit të vërshimeve është intervenuar në këto fshatra: Talinoc i Muhaxherëve, Salla “Bill Clinton” (lumi “Bifurkacioni”), Neredime, Koshare, Varosh, Fshati i Vjetër, Pleshinë, Zaskok dhe Doganaj.

2.2 Raste zjarri, shiu, vërshime, erë, për të cilat qytetarët kanë bërë kërkesa për dalje në vendngjarje

Në bazë të kërkesave të qytetarëve që i janë shkaktuar dëme nga të reshurat e shiut, si dhe erërat e forta që kanë ndodhur gjatë vitit 2023 janë: tridhjetë e një (31) kërkesa për kompensim të dëmeve në ekonomitë familjare, vlera e dëmeve është: 72,130.00€, tre (3) kërkesa për kompensim të dëmeve në biznese të ndryshme, vlera e dëmeve është: 5,450.00€ si dhe pesë (5) kërkesa për kompensim të dëmeve në sektorin e bujqësisë, vlera e dëmeve është: 77,991.20€. Vlera totale e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut, breshrit, vërshimeve, përmbytjeve, si dhe nga erërat e forta janë: 155,571.20€. Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara është bërë nga Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësive tjera (të gjitha kërkesat për kompensimin e dëmeve, komisioni i cekur më lartë i ka dërguar të Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave - AME). Vendet që më së shumti pësuan dëme si pasojë e reshjeve të dendura të shiut janë: Ferizaj – qytet, fshatrat: Rahovicë, Mirash, Dardani, Zllatar, Slivovë, Neredime, Dremjak, Manastirc, Balaj, Tërrn, Bablak, Cërnillë, Nikadin, Varosh etj.

Duhet potencuar se stafi i emergjencave në kuadër të Drejtorisë, pas pranimi të kërkesave nga qytetarët për dalje në vendngjarje për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri ka verifikuar duke dalë në terren – në vendin e ngjarjes, ku gjatë vitit 2023 kemi pasur 14 raste nga zjarri - rrufeje, duke përfshirë: raste zjarri në ekonomi familjare dhe në biznese të ndryshme, po ashtu kemi pasur 11 raste të kërkesave nga qytetarët për konstatime të gjendjes të krijuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera.

2.3 Njësia e menaxhimit të mbeturinave

Me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të pastër, si dhe largimin e mbeturinave nga hapësirat publike janë zhvilluar një numër i madh i aktiviteteve, të ndryshme në ruajtjen dhe pastrimin e ambientit, aktivitetet janë zhvilluar në zona urbane dhe rurale.

- Identifikimi i deponive ilegale të mbeturinave përfshirë mbeturina prej amvisërisë, mbeturina të ndërtimit/inerte, mbeturina industriale/rrezikshme, mbeturina e vëllimshme dhe mbeturina të përziera. Në lokacionet urbane në qytet dhe fshatra në bashkëpunim me GIZ-in gjerman si dhe eliminimi i tyre është bërë nga kompania publike K.R.M „Pastërtia”, ku gjatë vitit 2023 i kemi larguar – pastruar 208ton mbeturina të amvisërisë dhe 6139m³ mbeturina të ngurta dhe inerte.
- Janë shënuar edhe data me rëndësi mjedisore si Dita e Pranverës, Dita e Tokës dhe Dita e Mjedisit si dhe data tjera me rëndësi ekologjike dhe mjedisore.
- Gjatë vitit 2023, Komuna e Ferizajt ka zhvilluar projekte të rëndësishme duke ndihmuar Kompaninë Rajonale të Menaxhimit të Mbeturinave duke i furnizuar me 160 kontejnerë mbitokësor 1.1 m³ dhe 500 kontejnerë shtëpiak 120L e të cilat janë shpërndarë në qytet dhe fshatra duke mundësuar kështu rritjen dhe zgjerimin e klientëve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.
- Në bashkëpunim me GIZ-in gjerman kemi përfunduar fazën e parë të hartimit për Menaxhimin e Integruar Ndër komunal të Mbeturinave në Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.

3. SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në kuadër të shërbimeve publike janë zhvilluar një numër i madh aktiviteteve të cilat drejtpërdrejt kanë prekur interesat e qytetarëve si në riparimin e kanalizimeve, ujësjellësve, mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr, asfalt dhe mirëmbajtjen e trotuareve.

Duke u nisur edhe nga kërkesat e qytetarëve dhe gjendjes në terren janë realizuar këto punë dhe aktivitete.

Gjatë vitit 2023, kemi pranuar kërkesa të ndryshme kryesisht nga pjesët rurale dhe nga pjesa urbane të cilat kanë të bëjnë më së shumti me riparime të rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe kyçje të reja, si dhe meremetimin-mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr.

Gjatë vitit 2023 kemi kryer shumë raste aty ku ka pas mundësi për de bllokime në bashkëpunim me kompaninë KRU „Bifurkacioni” kemi bërë de bllokimin e rrjeteve, kurse pjesët ku ka qenë nevoja për ndërrimin e gypave, dhe kyçje të reja i kemi kryer si në shënimet në vijim:

3.1 Riparimi i rrjetit të kanalizimit

Gjatë vitit 2023 kemi pranuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave që lidhen me rrjetin e kanalizimeve atmosferike dhe fekale, andaj pas verifikimit të tyre në terren dhe konstatimit se janë jashtë funksionit për të cilin janë të dedikuara kemi ndërmarr masa për të riparuar apo edhe instaluar në gjatësi të caktuara rrjet të kanalizimit fekale në zonat urbane dhe rurale të komunës.

Gjatësia e riparimeve dhe instalimeve të këtij rrjeti të kanalizimeve arrin 4,745m¹.

Gjatësia e riparimeve të rrjetit të ujësjellësit arrin 397m¹.

3.2 Riparimi i rrugëve me asfalt dhe zhavorr, riparimi i trotuareve

Gjithashtu për të përmirësuar infrastrukturën rrugore sektori i shërbimeve publike ka kryer një numër të madh të aktiviteteve duke u nisur nga gjendja në terren dhe kërkesat e qytetareve. Pas daljes në terren dhe verifikimit të gjendjes nga zyrtarët e shërbimeve publike e duke u dhënë prioritet rasteve më emergjente si dhe duke pasur parasysh kufizimet buxhetore janë riparuar mbi 3207.60m² të trotuareve me kubëza, si dhe 57,431m² të rrugëve me zhavorr, riparimi i rrugëve me asfalt 15,927.61 m².

4. NJËSIA E TRAFIKUT DHE TRANSPORTI RRUGOR

Nga përshkrimi i detyrave zyrtare të cilat rrjedhin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, zyrtari i lartë për komunikacion rrugor gjatë periudhës një vjeçare sipas planit të parashikuar, për këtë vit ka realizuar këto punë:

4.1 Transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave

Transporti i udhëtarëve me autobus dhe taksi është duke u zhvilluar në një nivel të kënaqshëm, ku nga dyzetë e pesë fshatra sa ka Komuna e Ferizajt, dyzetë e tri prej këtyre fshatrave janë të përfshira në transportin publik dhe vazhdimisht inspektohet nga inspektori i transportit.

Vlen të potencohet se në këtë fushë kemi filluar edhe ndërtimin e vend-ndaljeve për autobusë dhe pritoreve për udhëtarë në transportin e udhëtarëve urban – periferik, praktikisht janë trajtuar fshatrat Talinoc i Muhaxherëve, Sazli, Softaj, Pojatë, Rahovicë, Mirash dhe Surqinë, gjithashtu do të vazhdohet me fshatrat Komogllavë, Balaj, Neredime, Jezerc, Rakaj etj.

4.2 Trafiku rrugor

Në këtë pikë është paraparë rregullimi teknik i qarkullimit në trafik dhe ngritja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, ku së bashku me njësinë e trafikut të Policisë kemi analizuar disa rrugë të qytetit dhe kemi bërë disa ndërhyrje dhe ndryshime konkrete të cilat janë realizuar me qëllim të lehtësimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurt dhe më të kënaqshëm për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion rrugor, ku vlen të potencohen këto ndërhyrje:

1. Ndërhyrja në udhëkryqin e rrugëve “Epopeja e Jezercit”, “Ismet Ramadani” dhe “Naim Beka”, ku nga një kryqëzim i formës së pa-rregullt është ri-konstruktuar në kryqëzim me rreth-rrotullim.
2. Vendosja e shtyllave statike anti-parking në rrugën urbane “Hamëz Jashari”, “Gjon Serreqi”, “Ramadan Rexhepi” dhe “Zenel Hajdini”, ku pas vendosjes së shtyllave anti-parking është lehtësuar në masë të madhe lëvizja e lirë e këmbësorëve.
3. Janë identifikuar dhe analizuar pika tjera të kryqëzimeve të pa-rregullta në zonën urbane dhe rurale (fshatra), ku në të ardhmen do të ri-konstruktohen dhe do të ri-organizohet qarkullimi në komunikacion.

4.3 Shenjat e trafikut

Në bazë të planifikimeve për këtë vit, kemi realizuar këto projekte në sinjalizimin e rrugëve me shenja horizontale dhe shenja vertikale të trafikut, me qëllim të përmirësimit dhe krijimit të një ambienti më të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor.

4.4 Shenjat vertikale të komunikacionit

Në rrugët e qytetit dhe fshatrave kemi bërë mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave vertikale të rrezikut, urdhrave të prera dhe shenjat e lajmërimit - udhëtreguesit, ku me prioritet i kemi vendosur shenjat para institucioneve arsimore dhe janë përfshirë vendosja e shenjave për kufizimin e shpejtësisë dhe atyre të paralajmërimit të prezencës së fëmijëve në ato segmente rrugore.

4.5 Shenjat horizontale të komunikacionit

Gjatë vitit 2023 kemi shënuar me shenja horizontale këto rrugë urbane dhe rrugët në fshatra:

1. Rruga urbane “Ahmet Kaçiku”,
2. Rruga urbane “Vëllezërit Gërvalla”,
3. Rruga urbane “Ramadan Rexhepi”,
4. Rruga urbane “12 Qershori”,
5. Rruga urbane “Agim Matoshi”,
6. Rruga urbane “Dëshmorët e Kombit”,
7. Rruga urbane “Enver Topalli”,
8. Rruga urbane “Epopeja e Jezercit”,
9. Rruga urbane “Emin Duraku”,
10. Rruga urbane “Ismet Ramadani”,
11. Rruga urbane “Bifurkacioni” dhe Bypass-i
12. Rruga urbane “Gjon Serreqi”,
13. Rruga urbane “Sinan Sahiti”,
14. Rruga urbane “Hamëz Jashari”,
15. Rruga urbane “Shabi Lipovica”,
16. Rruga urbane “Hilmi Ferizi”, praktikisht segmenti i rrugës Ferizaj – Talinoc i Muhaxherëve – Sazli – Softaj – Rahovicë – Mirash,
17. Rrugët në fshatin Muhoc (Saraji, Avdulla Rexha, Ramadan Haziri dhe Hamdi Rexhepi – Idriz Islami”, praktikisht segmenti nga rruga nacionale N2 njëra dalje në kryqëzimin me rreth-rrotullim në rrugën “Driton Islami” kurse dalja tjetër në rrugën nacionale N25-3 Ferizaj-Shtime.
18. Segmenti i rrugës nga fshati Manastirc deri te kryqëzimi me rrugën urbane “Naim Beka”.
19. Kryqëzimi i rrugës urbane “Driton Islami” me rrugën urbane “Bedri Asllani”
20. Sinjalizimi i shtegut të biçikletave në segmentin nga Parku i Lirisë deri në fshatin Balaj.
21. Hyrja në shkollën fillore në fshatin Prelez i Jerlive dhe sinjalizimi i hapësirës për parkingje të personelit të shkollës.

22. Hyrja në shkollën fillore në fshatin Fshati Vjetër dhe sinjalizimi i hapësirës për parkingje të personelit të shkollës.
23. Sinjalizimi i fushës sportive në fshatin Mirosalë,
24. Sinjalizimi i peroneve në Stacionin e Autobusëve,
25. Sinjalizimi i vend-parkingjeve në hapësirat e QKMF-së.

Në këto rrugë janë aplikuar këto shënime horizontale të komunikacionit:

- Vijat gjatësore dhe tërthore,
- Vendkalimet e këmbësorëve,
- Shigjetat orientuese,
- Vend-parkingjet për persona me aftësi të kufizuara,
- Vend-parkingjet për taksi,
- Sipërfaqe të ndryshme orientuese,
- Mbishkrime në rrugë, praktikisht afër institucioneve arsimore.

4.6 Pengesat rrugore për qetësimin e komunikacionit

Në kuadër të kësaj fushe kemi bërë vendosjen e pengesave rrugore për qetësimin e komunikacionit në disa rrugë urbane të qytetit, ku prioritet i kemi dhënë rrugëve në afërsi të shkollave si dhe në ato rrugë ku ka frekuentim më të madh të fëmijëve duke analizuar edhe infrastrukturën përcjellëse (mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për ecje).

4.7. KAMERAT E SIGURISË

Në kuadër të këtij projekti janë realizuar këto punë:

- Shtrirja e fibrës optike në kanalet nëntokësore në rrugët urbane “Driton Islami”, “Ahmet Kaçiku”, pjesa e parë e rrugës “Vëllezërit Gërvalla”, “Rexhep Bislimi”, “Gursel dhe Bajram Sylejmani” dhe rrugë tjera fibra optike ka kaluar në mënyrë ajrore nëpër shtylla elektrike dhe të ndriçimit.
- Janë vendosur kamera të reja të sigurisë dhe janë funksionalizuar kamerat e reja ekzistuese, gjithashtu vazhdon edhe mirëmbajtja e tyre.

5. NJËSIA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar puna e vazhdueshme me intensitet të shtuar në mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik i cili po vjen çdo herë duke u zgjeruar.

Gjatë vitit 2023 janë vendosur 951 trupa ndriçues të rinj LED me një vijë gjatësore prej 32.5 Km

Gjithsej deri më tani vija gjatësore e ndriçimit publik në Komunën e Ferizajt deri në fund të vitit 2023 ka arritur në 760 km.

Përveç punës në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në fund të vitit 2023 kemi bërë dekorimin e qytetit për festat e fund vitit duke i vendosur Bredhin e Vitit të Ri dhe elementet tjera dekorative në sheshin "Adem Jashari" para objektit komunal dhe në bulevardin "Dëshmorët e Kombit".

5.1 Mirëmbajtja dhe rregullimi i konstruksioneve dhe objekteve nga metali, druri dhe plastika

Në kontratën e mësipërme janë kryer punët si në tabelën e mëposhtme:

Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve te murit marka MB30. Përfshirë themelet me dimensione 20x40cm Shkolla - Bilall Shala - Llojza	m'	358
Rregullimi i parqeve duke e përfshirë në këtë pozicion komplet rregullimin e hapësirave duke filluar me gërryerjen e dheut, nivelimin e sipërfaqes e deri ne fazën finale - mbjellja e barit	m ²	5390
Furnizimi dhe vendosja e rrethojës me lartësi 1m dhe 1.5m, hapësira në mes jo me shumë se 10-15mm	m ²	275
Furnizimi dhe montimi i konstruksioneve metalike me dimensione 100x100x2.5mm	m	316
Furnizimi dhe montimi i konstruksioneve metalike me dimensione 60x40x2.5mm	m	1494
Furnizimi dhe montimi i konstruksioneve metalike me dimensione 40x40x2mm	m	1364
Furnizimi dhe montimi i rrjetave metalike për fushat sportive me trashësi 5.5mm	m ²	2774
Hapja e kanalit 50x80m dhe vendosja e kablllos 4x25mm ² Al , duke përfshirë gypin e brinjëzuar Ø63m.	m	135
Furnizimi dhe vendosja e tepihëve sintetik(bari sintetik) për fushat sportive - Fusha ne Cërnillë	m ²	1705

6.NJËSIA E SHËRBIMIT TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT

Në vitin 2023, Shërbimi Zjarrfikës dhe Shpëtimit ka pasur **gjithsej 822 dalje** të ndara në kategori intervenimesh të cilat janë paraqitura në pjesën e dytë të raportit pjesa grafike e intervenimeve.

Si sfida më të mëdha përpos intervenimeve të ndryshme që kemi marrë pjesë nga më të ndryshmet, shërbimi ynë sfidë serioze që ka ndikuar drejtpërdrejt në punën tonë ka qenë **numri i pamjaftueshëm i zjarrfikësve profesional**, që as përafërti nuk i plotësojmë kriteret numerikisht për një shërbim me standarde të parapara me Ligjin Nr. 04/-L-049 dhe Rregulloren NR 16/2012 për numër të banorëve në Komunën tonë.

Po ashtu çështje me prioritete në zhvillim dhe ndikim në Shërbimin Zjarrfikës është aktivizimi i njësisë varëse zjarrfikëse në Rr "Enver Topalli".

Realizimi i përgjithshëm i zjarreve dhe intervenime tjera nga viti 2013-2023

NJËSIA PROFESIONALE E ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT - FERIZAJ

Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
479	403	561	398	541	461	773	556	986	632	822

Nr.	Muajt	Pjesëmarrja e zjarrfikësve	Pjesëmarrja e automjeteve	Objekte Ndërtimore	Zjarre Malore	Zjarre Fushore	Aksidente trafiku	Automjete	Pajisje elektrike	Shërbime	Intervenime teknike	Mbeturina	Bombola gazi	Objekte tjera	Vërshime	Oxhaqe	Ushqim i kafshëve	Stabilimente Elektrike	Të rreishme	Eksplozive	Te lënduar	Te vdekur
1	Janar			7	1	3	0	1	0	1	10	2	0	1	5	5	0	8	0	0		
2	Shkurt			0	4	19	2	2	0	1	2	3	5	0	1	0	13	9	0	0		
3	Mars			9	6	4	1	0	0	0	1	5	6	1	0	1	0	5	0	0		
4	Prill			4	0	1	2	0	0	0	3	9	3	0	2	1	2	4	0	0		
5	Maj			3	0	1	0	1	0	1	3	12	4	0	1	2	1	3	2	0		
6	Qershor			2	0	1	0	1	6	0	7	8	4	0	2	8	0	0	1	0		
7	Korrik			5	1	12	6	4	1	1	22	14	1	4	14	0	1	8	0	0		
8	Gusht			4	2	57	0	3	0	3	9	5	1	1	3	1	3	9	0	0		
9	Shtator			3	3	94	2	2	1	6	14	11	1	0	0	1	0	5	0	0		
10	Tetor			4	0	111	1	1	0	1	6	8	0	0	0	0	1	3	2	0		
11	Nëntor			4	0	1	2	4	2	1	11	2	0	2	1	0	0	5	2	0		
12	Dhjetor			4	0	2	2	2	0	2	6	4	1	2	4	4	1	25	1	0		

Intervenimet mujore të vitit 2023

49

17

306

18

21

10

17

94

83

26

11

33

23

22

84

8

0

Intervenimet e përgjithshme gjatë vitit 2023

8

2

2

12/1/2024

Ferizaj

NJPZSH - FERIZAJ

